Një e arritur e madhe për karrierën e zj. Rama-Hajrizi ishte përfaqësimi i Kosovës në vitin 2014 në Komisionin e Venecias, organ këshilldhënës i Këshillit të Evropës, që përbëhet prej ekspertëve të pavarur në fushën e së drejtës kushtetuese.

Një përvojë dhe mundësi domethënëse që tranoi rrugën e Artës për në krye të Gjykatës Kushtetuese ishte përvoja e saj katërvjeçare si konsulle e parë e përgjithshme e Republikës së Kosovës në New York.

“Pas katër viteve të mrekullueshme në New York, unë isha e përgatitur dhe e gatshme t’i kthehesha profesionit tim. U emërova gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Ngjitja shkallës deri në pozitën e Kryetares së Gjykatës ishte rezultat i përkushtimit të vërtetë, punës së zellshme,

respektit dhe besimit që kam fituar në mesin e kolegëve të mi gjyqtarë gjatë tri viteve si gjyqtarë”, thotë Rama-Hajrizi.

Në një botë ku zëri i femrave është duke u bërë shumë e shumë më i fuqishëm, ku feminizmi nuk është më term i panjohur dhe i keqkuptuar, sfidat janë të mëdha kur gjendeni në majë të shkallës së sundimit të ligjit, siç është zj. Rama-Hajrizi.

“E fshehta prapa çdo suksesi është puna, përkushtimi, profesionalizmi dhe të qenit të përgatitur për të bërë ndryshime të nevojshme përmes bashkëpunimit transparent dhe të hapur me kolegë”, thotë Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Sipas zj. Rama-Hajrizi, praktika në mbarë botën, dhe jo vetëm brenda profesionit ligjor, është se në krahasim me meshkujt, femrat duhet të arrijnë standarde më të larta dhe t’i përkushtohen më shumë punës për të eliminuar çdo paragjykim. Në këtë drejtim, zj. Rama-Hajrizi sigurohet që Gjykata Kushtetuese të jetë një prej pak institucioneve në shtet ku më shumë se gjysma e të punësuarve janë femra.

“Në rastin tim ishte puna dhe përkushtimi im i përditshëm që i bindi kolegët e mi gjyqtarë që të më zgjedhin si kryetare të tyre. Të qenit kolege e gjyqtarëve që kanë dhënë betimin për të zbatuar standardet më të larta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të mbrojtura me Kushtetutën tonë, përfshirë trajtimin e barabartë të individëve, më jep arsye tjetër të krenohem me arritjet e mia”, thotë zj. Rama-Hajrizi.

Ajo gjithnjë i ka inkurajuar dhe inspiruar koleget e saj në gjykatë dhe në universitet. “Unë u kam thënë që asnjëherë të mos ndalojnë së promovuari të drejtat e tyre e as të heqin dorë nga ndjekja e ambicieve, karrierës dhe ëndrrave që ato i kanë”, thotë Rama-Hajrizi. Ajo beson se emancipimi

i femrave është fortesa dhe baza e çdo shoqërie demokratike.

Gjatë rrugës së saj të karrierës së frytshme, zj. Rama-Hajrizi kuptoi se ajo që gjithnjë e formëson rrugën drejt të ardhmes është përvoja. Në rastin e saj, përvoja profesionale dhe arsimore në Amerikë pati ndikim të madh dhe i hapi dyer për një koncept tërësisht të ri të kuptuarit të së drejtës dhe sistemeve juridike të ndryshme.

Pjesë e sfidës është krahasimi, analizimi dhe zbatimi i jo vetëm përvojës por edhe i arsimit në një shtet me sistem juridik krejtësisht të ndryshëm. Sipas zj. Rama-Hajrizi, gjëja më e mirë rreth sistemit juridik është fakti se pavarësisht dallimeve mes strukturave, parimet kryesore mbesin të njëjta.

“Aftësia për t’iu përshtatur ndryshimeve është kyç për të përballuar jetën dhe punën në shtete dhe kontinente të ndryshme”, shpjegon ajo.

Duke pas parasysh se Gjykata Kushtetuese është autoriteti final për interpretimin e Kushtetutës, vendi i punës së zj. Rama-Hajrizi sjell me vete nivel të lartë të përgjegjësisë.

“Detyra e caktuar gjyqtarit të emëruar për mbrojtjen dhe interpretimin e një dokumenti kaq të vlefshëm nuk është vetëm privilegj, por edhe obligim i madh. Kjo kërkon përkushtim të vazhdueshëm dhe punë të zellshme për mbrojtjen dhe interpretimin e dispozitave të tij për çdo parashtrësë të paraqitur para Gjykatës Kushtetuese”, thotë Rama-Hajrizi.

Puna e institucionit të saj është e gjerë dhe e ndërlikuar, por për zj. Rama-Hajrizi jurisprudenca më e mirë e gjykatës “vije prej parashtrësave individuale ku përmes vendimeve të gjykatës ne sigurojmë garantimin e të drejtave dhe lirive të

parapara me Kushtetutën tonë për secilin qytetar, pa dallim.”

Larg syrit të publikut, zj. Rama-Hajrizi është bashkëshorte dhe nënë e dy djemve, Lir dhe Jon, të cilët i japin asaj tërë dashurinë dhe energjinë pozitive shtesë që i nevojitet pas një dite të gjatë.

E pyetur nëse më sfiduese është të jesh nënë apo kryetare e Gjykatës Kushtetuese, zj. Rama-Hajrizi përgjigjet: “Gjetja e mënyrës për të shijuar të dyja nganjëherë është më e vështirë sesa të punosh në rastet më të ndërlikuara në gjykatë. Por kjo është bukuria e të qenit nënë.” Familja Rama-Hajrizi i shfrytëzon ditët e fundjavës për më shumë gjumë, mëngjese me familjen dhe ecje nëpër natyrë.

Asaj i pëlqen futboli, është kuzhinieri shumë pasionante, ku ushqimet e saj të famshme e bashkojnë familjen, çka i shton veçanti kohës së kaluar së bashku.



## Niina Koivisto: 'Për të ecur para, mendo jashtë kornizave!'

Qëndrimi pozitiv, pasioni dhe përcaktimi janë ato që shndrisin përmes uniformës policore të Niina Koivisto, një prej këshilltareve të EULEX-it për Policinë e Kosovës në Komunitet. Ajo u bë pjesë e EULEX-it pasi u ngrit nëpër gradat e Bordit të Policisë Nacionale të Finlandës dhe përfundoi me sukses misionin e saj në EUPOL Afganistan në 2016, dhe porosia e saj për të gjitha femrat që punojnë në fushën e sundimit të ligjit është e qartë: 'Punoni shumë, dhe do të arrini sukses'.

Niina është rritur me dy vëllezër në një familje tradicionale finlandeze në një fshat. "Familja ime më ka dhënë mbështetje të plotë për karrierën që unë kam zgjedhur. Kjo zgjedhje nuk ka qenë e lehtë." Gjyshja e saj tashmë e ndërë ka qenë karakter jashtëzakonisht me ndikim në familjen e saj duke theksuar vazhdimisht rëndësinë e të mësuarit, të punuarit, të barazisë gjinore, dhe që gratë mund t'i bëjnë të gjitha.

Menjëherë pas shkollës së mesme, kur ishte vetëm njëzetvjeçare, ajo e filloi karrierën e saj me ambicie të mëdha në fushën e zbatimit të ligjit. Pasi u diplomua në akademinë policore në moshë të re, dhe pasi kaloi nëpër departamente të ndryshme të policie së Finlandës, ajo i përfundoi me sukses studimet për juridik dhe fitoi diplomë të studimeve Masters për juridik. 'E dija se për t'u dalluar nga të tjerët, më duhej të vijoa rrugë më të gjatë,' thotë ajo.

Sipas Niinas, puna në polici që dominohet nga gjinia mashkullore nuk ka qenë gjithnjë e lehtë. "Si femër, vëmendja tek ti është më e madhe. Por unë gjithmonë kam qenë 100% vetvetja dhe asnjëherë nuk e kam ndryshuar dukjen apo sjelljet e mia për shkak të punës që bëja. Kam qenë e rreptë kur ka qenë nevoja, dhe në veçanti kur jam ballafaquar me gjëra të gabuara apo të paligjshme.

"Sukseset më të mira arrihen kur jeni vetvetja. Në shtetin tim në Finlandë unë kam pasur eprorë shumë të mirë dhe mbështetës, si dhe kam pasur trajtim të drejtë. Përvoja ime në një mjedis ndërkombëtar ka qenë më sfiduese. Unë jam shumë energjike dhe mund të përshtatem me shpejtësi ndaj përgjegjësisë të reja. Unë gjithmonë përpiqem të punojë në mënyrë kreative," thekson Niina.

Qysh kur ishte duke punuar në pozitën e zyrtares policore nëpër rajone dhe njësi të ndryshme të policisë, kur është bërë detektive në Njësinë kundër terrorizmit për Shërbimin e Inteligjencës së Sigurisë së Finlandës, si dhe tani, Niina ende vazhdon të ndjekë suksese akademike paralelisht me karrierën e saj profesionale në polici. Me qëllim që t'i kombinojë përvojat e saj të larmishme gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, aktualisht ajo është kandidatë për doktoratë në Universitetin e Helsinkit.

Ky është vetëm një nga synimet që ia ka caktuar vetes: ajo e thekson rëndësinë e ndjekjes së ambicieve, aftësive dhe përvojave të ndryshme në jetën profesionale, dhe pasja e qasjes së re dhe kreative për të gjitha aspektet e jetës dhe punës së saj.

Pasi i kaloi shtatë vite në grada të larta udhëheqëse në Bordin e Policisë Nacionale të Finlandës, në shtabin e policisë së Finlandës, si dhe si gjyqtare në Gjykatën e së Drejtës për të kuptuar tërë zinxhirin e drejtësisë penale, ambiciet e Niinas e tërhoqën atë në mënyrë të natyrshme tek sfera ndërkombëtare. 'Unë jam shumë falënderuese për mundësinë që më është dhënë, si në EULEX në Ballkan, dhe në Afganistanin e mrekullueshëm, për të punuar, mësuar dhe përshtatur me situata të ndryshme gjeopolitike dhe komunitete shumetnike,' thotë ajo. 'Ky lloj i përvojave dhe i angazhimeve me njerëz është veçanërisht i paçmueshëm kur punon si këshilltare për policinë e komunitetit.'

Roli parësor i Niinas në EULEX përfshin këshillimin e drejtuesve të lartë të Policisë së Kosovës në nivel strategjik në lidhje me zbatimin e praktikave më të mira të BE-së. Me origjinë nga Finlanda, shtet që konsiderohet se ka një nga agjencitë më të mira të zbatimit të ligjit në botë, si dhe në mesin e tretë tek indeksi i sundimit të ligjit, përvoja e saj në nivel strategjik është e pashmangshme për funksionimin efektiv të rolit këshillues të EULEX-it për Policinë e Kosovës.

'Inkorporimi i strategjisë së sigurisë së brendshme të BE-së, së bashku me praktikat më të mira nga Policia e Finlandës si dialogu i fuqishëm mes policisë dhe komunitetit, dallimet mes sigurisë së jashtme dhe të brendshme, si dhe bashkëpunimi i ngushtë mes policisë,

policisë kufitare dhe doganës janë elemente për të cilat unë posaçërisht jam angazhuar këtu në Kosovë,' thotë Niina.

Një pjesë e madhe e punës së saj të përditshme në Shtabin e Policisë së Finlandës përfshin punën me Kryeinspektorin, në nivel të drejtuesit, për këshillimin e Komisionarit të Policisë Nacionale dhe të Zëvendëskomisionarëve të Policisë, si dhe bashkërendimin e strategjive të ndryshme. Këtu përfshihen edhe performanca e policisë dhe planet e veprimit (për shembull, parandalimi i krimeve, hetimet penale, rendi dhe siguria publike, policimi ndërkombëtar, ruajtja e paqes) dhe shndërrimi i tyre në raporte pas aksioneve për Komisionarin e Policisë dhe nivelin ministror rreth performancës dhe rezultateve të policisë. Përpjekja madhore e fundit ishte përfaqësimi i Policisë së Finlandës në përgatitjen e nivelit parlamentar të Aktit të Inteligjencës për Policinë dhe për Shërbimin e Inteligjencës. Angazhimet e Niinas në nivel nacional përfshijnë shumë fusha interesante në përfitim të këshillimit policor në nivel strategjik.

Tani në Kosovë, Niina i vlerëson shumë përvojat dhe raportet e punës që ka krijuar që nga koha kur ka ardhur. "Të punosh me policinë në komunitet dhe të monitorosh, mentorosh dhe këshillosh ka të bëjë me krijimin e besimit dhe respektit, si individ dhe si këshilltar i lartë. Kur ta përfundoj misionin, unë do t'i marr me vete në Finlandë kujtimet e mira nga puna me Policinë e Kosovës dhe rëndësinë e madhe të stafit tonë vendas në EULEX, dhe vërtetë shpresoj që në mesin e Policisë së Kosovës dhe kolegëve tonë unë të mbahem mend si këshilltare policore shumë aktive dhe profesionale," thotë Niina.

Në kohën e saj të lirë në Ballkanin e bukur, përveç leximit dhe studimeve, Niina pëlqen të lëvizë nëpër natyrë duke u marrë me sport, si me alpinizëm apo skijim. "Fundjavat më të mira i kam kaluar në Brezovicë dhe nëpër bjeshkë me qiell të kaltër dhe të kthjellët", thekson ajo.

Niina e thekson rëndësinë e ndërtimit të raporteve dhe të respektit nëpër misione siç është EULEX-i. 'Parimi i pronësisë vendore është diçka që komuniteti ndërkombëtar duhet gjithnjë ta ketë në mendje. EULEX-i është instrumenti përmes së cilit na është mundësuar bashkëpunimi dhe komunikimi me institucionet e Kosovës, kurse raportet që krijohen dhe ruhen janë ato që e përcaktojnë suksesin e Misionit.'



## Tahire Haxholli: “Nuk jeni vetëm, ne jemi këtu për ju”

Dhuna në familje mund të shfaqet në forma të ndryshme, si fizike, seksuale, psikologjike apo ekonomike. Përhapja e kësaj dhune mund të jetë dëmtuese si për viktimat ashtu edhe për personat e prekur, dhe mund të qojë deri në shkatërrimin e familjeve, vetëvrasje, dhe vrasje.

Për shumë prej viktimave të dhunës në familje që vendosin të raportojnë keqtrajtimet, vendi i parë ku drejtohen është policia, ku nisë së zbatuari ekspertiza e Tahire Haxhollit.

Kapitene Tahire Haxholli, udhëheqëse e Njësisë për Hetime rreth Dhunës në Familje, në kuadër të Policisë së Kosovës, është shumë entuziaste në punën e saj të madhe drejt ndryshimit të kulturës së tolerimit që përshkon nëpër rastet e dhunës në familje.

“Për mua familja është gjithçka, unë jam rritur e rrethuar me shumë dashuri, harmoni, dhe inkurajim të vazhdueshëm prej prindërve dhe vëllezërve dhe motrave që unë t’i ndjek ëndrrat e mia,” shpjegon ajo. Ëndrra e saj në fëmijëri ishte e thjeshtë: “Gjithmonë kam dashur t’iu ndihmojë të tjerëve, dhe t’iu them se të gjithë meritojmë të jemi të lumtur, pavarësisht se çka na thonë të tjerët,” vazhdon ajo.

Pas konfliktit në Kosovë, ajo e kishte shumë të qartë se dëshironte të bëhej pjesë e forcës policore të sapoformuar në

Kosovë, dhe të jepte kontributin e saj në shoqëri. Nuk e kishte menduar se një ditë do të arrinte të bëhej kaq e përfshirë si figurë e rëndësishme në luftimin e dhunës familjare në Kosovë.

“Viktimat më shohin si engjëjllin mbrojtës të tyre, si heroinë e tyre,” shpjegon ajo me krenari. “Qysh prej ditës së parë, jam përfshirë në çdo rast. Për mua, familja dhe lumturia janë tejet të rëndësishme, dhe është shumë e vështirë për dikë t’i humb të gjitha ato brenda një dite, andaj unë e trajtoj çdo rast me respekt dhe profesionalizëm të skajshëm,” shton ajo. Janë mirënjohja dhe ndjenja e sigurisë së viktimave të keqtrajtimit ato që e motivojnë, duke ia rikujtuar që asnjëherë të mos heq dorë dhe të arrijë rezultate edhe më të mira.

Kapitene Haxholli është një nga shembujt më të mirë të shumë femrave që i janë bashkuar sektorit të sigurisë. Ajo iu bashkua Policisë së Kosovës menjëherë pas luftës, me ëndrrën që të arrinte profesionalisht dhe t’iu ndihmonte të tjerëve. Gjersa ishte duke punuar si zyrtare policore në njësinë e patrullimit, ajo njëkohësisht vijoi studime në fushën e kriminalistikës, dhe vazhdoi me shkallën masters në studime juridike në fushën e dhunës në familje. Ajo filloi me hapa të vegjël por të sigurt, dhe tani ka pozitë udhëheqëse në forcën policore të Kosovës. “Isha shumë e përkushtuar në punë. Gjatë rrugëtimit tim profesional



jam ballafaquar me shumë situata të vështira, por gjithnjë kam arritur t'i tejkaloj vështirësitë dhe t'i dëshmoj aftësitë e mia menaxheriale," shpjegon ajo.

Rrugëtimi i saj profesional në Policinë e Kosovës filloi në vitin 2000 si pjesëtare e njësisë së patrullimit, ku më pas kaloi në njësinë e policisë në bashkësi, ku qëndroi deri në vitin 2003. Po atë vit ajo u avancua në pozitën e hetueses për rastet e dhunës në familje. Ajo e mori gradën e parë rreshtere në vitin 2004, dhe vetëm pas një viti asaj iu caktua roli i mbikëqyrëses së sektorit për dhunën në familje. Paralelisht punës dhe studimeve, ajo vijoi edhe trajnime profesionale të shumta në mbarë botën. Pas marrjes së gradës kapitene, ajo u avancua në pozitën e shefes së sektorit të dhunës në familje, dhe tani është në rrugën e saj drejt gradës majore.

Dhuna në familje zakonisht ndodhë prapa dyerve të mbyllura, dhe viktimat vuajnë në heshtje. Megjithatë, sipas zj. Haxholli, raportimi i rasteve të dhunës në familje në Kosovë ka shënuar ngritje gjatë viteve të fundit. "Kjo nuk nënkupton rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje, por se viktimat po i njohin më mirë të drejtat e tyre," shpjegon ajo. Statistikat tregojnë që vetëm vitin e kaluar, me mijëra kosovarë raportuan për raste të dhunës në familje, ku 90 për qind e viktimave ishin femra.

"Zakonisht femrat janë viktima, dhe në shumicën e rasteve përfshihen edhe fëmijët. Dhuna raportohet vetëm atëherë kur konsiderohet e patolerueshme," shpjegon Haxholli, duke shtuar, "Kjo nënkupton se ne në të vërtetë nuk e dimë se sa dhunë ushtrohet brenda një familje, meqë ajo raportohet vetëm pas shumë vitesh keqtrajtimi të vazhdueshëm."

Sipas Kapitene Haxholli, parandalimi duhet të jetë hapi më i rëndësishëm drejt trajtimit të dhunës në familje. "Zyrtarët

policorë nga njësia ime shfrytëzojnë çdo rast për të qenë më afër komunitetit. Shumë shpesh ne organizojmë ligjërata nëpër shkolla, mbajmë konferenca, dhe shpërndajmë fletushka me informata rreth dhunës në familje dhe rreth të drejtave të viktimave," shpjegon ajo. Sipas Kapitene Haxholli, shumica e femrave zakonisht nuk i njohin të drejtat e tyre themelore. "Viktimave zakonisht i thuhet prej bashkëshortëve apo ushtruesve të dhunës se ato nuk kanë se ku të shkojnë, se ato nuk e kanë askënd, dhe se ata i kanë njerëzit e tyre në polici," shtjellon Haxholli.

Informimi është element shumë i rëndësishëm në luftën kundër dhunës në familje. Zyrtarët e Policisë së Kosovës që patrullojnë nëpër komunitet janë të gatshëm t'u tregojnë viktimave se ata janë aty për t'iu ndihmuar. "Në thelb ne iu themi viktimave se nuk janë vetëm. Krijimi i besimit është jetik për ne", shpjegon Kapitene Haxholli.

Në Kosovë, ekzistojnë një numër institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të personave që kanë vuajtur nga dhuna në familje. Nga momenti që rasti i dhunës në familje raportohet në polici, në dispozicion janë strehimoret, qendrat për punë sociale, avokatët e viktimave, dhe sistemet dhe procedurat e tjera për të siguruar që çdo person do të ndihmohet për paraqitjen e rastit, për kontroll mjekësor nëse është i nevojshme, për këshillim, strehim, dhe mbështetje përgjatë procedurave gjyqësore.

"Në shumicën e rasteve, Policia e Kosovës përfshihet përgjatë tërë procesit të këtyre rasteve dhe luan rol themelor në përfshirjen e institucioneve të tjera. Edhe neve na nevojitet mbështetje nga institucione të tjera në mënyrë që të na bëhet e mundur arritja e rezultateve më të mira," shpjegon ajo.

Kapitene Haxholli e çmon lartë bashkëpunimin dhe mbështetjen që njësia e saj ka nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore, si UNMIK, KFOR, EULEX, OSCE, dhe të tjera: "I çmoj dhe i vlerësoj lartë të gjitha përpjekjet dhe mbështetjet që na vijnë nga të gjitha këto institucione, ngase porosia e punës sonë fuqizohet më tej. Të gjithë mësojmë nga njëri-tjetri përgjatë rrugës," thotë ajo.

Zj. Tahire nuk njihet vetëm për "kokëfortësinë" që ka në luftën e saj për t'i ndihmuar viktimave të dhunës në familje, por ajo po ashtu është edhe lobuese e njohur për të drejtat e femrave brenda institucionit të saj. Ajo është një nga themelueset e Shoqatës së Femrave në Policinë e Kosovës. "Atë kohë, unë punova shumë ngushtë me organizatën UNIFEM për themelimin e shoqatës brenda Policisë së Kosovës, me qëllim që ne t'i tregojmë vlerat që femrat kanë për policinë, t'i inkurajojmë ato t'i bashkohen forcës policore, dhe të thyejnë qëndrimet me paragjykime dhe stereotipe," vazhdon ajo.

Duke patur një besim të fortë tek shkollimi, në veçanti për investimin në arsimimin e femrave, ajo ka një porosi për të gjitha femrat e reja në Kosovë, dhe ajo është që ato të shkollohen, të kenë vetëbesim, të jenë të qëndrueshme dhe të mos heqin dorë asnjëherë. "Është shumë e rëndësishme që të arsimoheni, arsimi do të ju zhvillojë si person dhe profesionistë, dhe automatikisht do të ju ndihmojë t'i krijoni vetes suaj pozitë të pavarur."



## Nga Kosova në Ramallah - Njoftohuni me Sandra Gudaityte

Kur sfidat e jetës afrojnë, shumë do të jenë të preokupuar me frikë dhe shqetësime. Por krejt çka zyrtarja ligjore në EULEX Sandra Gudaityte ka në mendje është vetëm Trouble. Trouble është macja të cilën e ka adoptuar nga rruga dhe ajo do ta shoqërojë javën që vije nga Kosova në Ramallah, ku Sandra pritet të nisë një hap të ri në karrierë. Frika e vetme që e përcjellë gjersa përgatitet të largohet nga Kosova është se si në fund do ta pranojë para pronarit të shtëpisë se macja Trouble ia ka grisur divanin me kthetrat e saj.

Pas një viti e gjysmë me EULEX-in, Sandra tani nisët për në Zyrën Bashkërenduese të BE-së për Mbështetjen e Policisë Palestineze (EUPOL COPPS) në Ramallah. E entuziazmuar për të ardhmen, ajo kujton kohën e kaluar në Prishtinë, punën në EULEX dhe rrugën që e solli në Kosovë.

Sandra kishte shumë punë në Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit në Pallatin e Drejtësisë në Prishtinë. Si zyrtare ligjore, puna e saj kishte të bënte me shqyrtimin e rasteve dhe apeleve që paraqiteshin para saj, kërkimin e zbrazëtirave apo mospërputhjeve nëpër aktgjykime, hartimin e opinionëve ligjore dhe këshillimin e gjyqtarëve rreth rrugës së duhur që duhej ndjekur. Kjo punë i është përshtatur në mënyrë të përsosur Sandrës, meqë ajo kishte pasion të mësojë rreth sistemeve të reja të drejtësisë penale, nga sistemi në vendin e saj në Lituani, deri tek sistemi penal ndërkombëtar, legjislati i Kosovës, dhe shumë shpejt, edhe legjislati penal palestinez. Ajo pa hezitim tregon se çka i pëlqen më së shumti në lidhje me punën: 'Për mua rastet më interesante janë rastet që ndërlidhen me krimet e luftës dhe rastet e korrupsionit, rastet më të rënda për të cilat EULEX-i ka juridiksion', thotë ajo. Dhe ajo ka

shumë punë për të bërë. Në Gjykatën e Apelit ka shumë raste të temave të llojllojshme, asnjëherë nuk pushon të qenit interesant. 'Të punosh me raste të tilla nganjëherë di të jetë e vështirë, thotë ajo. 'Gjërat që lexojmë janë tejet të ndjeshme, dhe mund të jenë mjaftë shqetësuese. Nganjëherë brengosem në mos bëhem më pak e mëshirshme, e më shumë cinike. Por kjo nuk më ka ndalur dashurinë për punën!'

Megjithatë, kohën në Kosovë Sandra nuk e ka kaluar gjithnjë e ulur në zyrë duke bërë hulumtime apo duke shkruar ankesa. Kurerdhënë Kosovë për herë të parë para tri vite e gjysmë, ajo punonte si Zyrtare e Operacioneve në Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), si Udhëheqëse e Njësisë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP). E angazhuar në lidhje me dëbimet, Sandra gjithnjë ishte nëpër teren: angazhimet e drejtpërdrejta me njerëz dhe të qenit jashtë zyrës për pothuajse çdo ditë ishte përvojë sfiduese, por edhe emocionuese për një zyrtare ligjore. 'Gjatë kohës sa punoja në lidhje me dëbimet në AKP, tërësisht isha jashtë rehatisë sime', thotë ajo. 'Por këtu kam përvetësuar shumë aftësi të cilat nuk kisha mundur t'i përvetësoja gjëkund. Në veçanti, puna me policinë e vendit më ka përmirësuar dukshëm aftësitë për zgjidhjen e konflikteve. Kjo është arsyeja pse gjithçka u shpërblye, mundësia për t'u angazhuar me lloje të ndryshme të njerëzve.'

Kalimi në EULEX iu ka përshtatur shijeve akademike të Sandrës pak më shumë, megjithatë. Ajo e nisi karrierën e saj juridike me një diplomë të studimeve masters nga vendlindja e saj në Lituani. 'Unë i hyra studimeve për të drejtën penale ndërkombëtare pothuajse krejt rastësisht', shpjegon ajo. Në vend se të

punoja si juriste në vendin e saj, ajo ishte e përcaktuar që të kërkonte sfida të reja, të studionte në Belgjikë, Holandë, dhe Korenë e Veriut, për të përfunduar studime profesionale në drejtimin e së drejtës ndërkombëtare. Pas muajsh përkushtimi në punë si praktikante në Gjykatën Ndërkombëtare Penale në Hagë, Sandra ishte e sigurt se ajo donte të ndiqte karrierë ndërkombëtare, dhe pati mundësinë që të punësohej në një pozitë me orar të plotë atje. 'Puna në Gjykatën Ndërkombëtare Penale ishte e arritur shumë e madhe për mua. Një pjesë e imja do të donte të kthehesha prapë atje, por pasi që jetova në Kosovë dhe së shpejti në Ramallah, kam një ndjenjë se Haga mund të jenë paksa e mërzhshme për mua!'

Lëvizja e ardhshme në karrierën e Sandrës do të jetë puna si këshilltare ligjore në kuadër të EUPOL COPPS. Roli i saj do të jetë i orientuar drejt monitorimit dhe këshillimit të policisë dhe gjyqësorit, si dhe fuqizimin e bashkëpunimit mes autoriteteve ligjore izraelite dhe palestineze. 'Përvojat e mia në EULEX dhe AKP me të vërtetë më kanë përgatitur për këtë rol, dhe jam e gatshme që ato t'i marr me vete në Ramallah.'

'Institucionet e vendit të cilave ne iu ndihmojmë këtu çdo ditë janë duke u përmirësuar dhe fuqizuar, ka arsye pse EULEX-i është duke u reduktuar,' komenton ajo. Sandrës i ka pëlqyer puna brenda gjyqësorit të Kosovës, në veçanti mundësia për të parë përmbylljen e rasteve në të cilat ajo ka punuar. Ndjente ndikimin e vërtetë të punës që bënte. Po ashtu ndihej jashtëzakonisht e kënaqur që nga puna e saj si zyrtare ligjore në EULEX jepte rezultate të matshme. 'Unë i kam përmirësuar njohuritë e mia në fushën juridike dhe kam mësuar se si të punoj nën presion, në veçanti nga shqyrtimi i një numri tejet të madh të rasteve në Pallatin e Drejtësisë. Aftësitë që i kam përvetësuar gjatë punës në një mjedis me lëvizje të shpejta siç është EULEX-i janë të paçmueshme.' Kjo është koha e përsosur që ajo të shkojë më tutje në një mision të ri me sfida të reja duke marrë me vete çdo gjë që ka mësuar. 'Për një zyrtare ligjore në veçanti, Ramallahi do të jetë qytet magjepsës për të punuar.'

Një aspekt të karrierës së saj në Kosovë që e kujton me krenari është puna me gjyqtarët

vendorë. Bashkëpunimi me ta ishte pjesë jashtëzakonisht pozitive e punës së saj në Pallatin e Drejtësisë. Sandrës është ndjerë mirë që asnjëherë nuk ka qenë e caktuar për vetëm një gjykatës, por ka pasur mundësinë që të punonte me shumë prej tyre. 'Është me të vërtetë interesante të shohësh se si gjyqtarët e ndryshëm punojnë dhe angazhohen për raste, dhe se si personalitetet dhe metodat e tyre të punës ndikojnë në mënyrën e qasjes ndaj rastit.'

Në veçanti i përmend gjyqtaret femra. 'Kishte shumë gjyqtare vendore me të cilat mu dha mundësia të punoja, gjyqtare me siguri në vete, me njohuri fenomenale të ligjit. Ishte mirë të shihje që suksesi juaj, edhe si gjyqtare femër, bazohet në meritë.'

Kur mendon rreth përvojës së saj si femër me punë në fushën e sundimit të ligjit, Sandra ka mendim pozitiv për përparimin e shënuar drejt barazisë gjinore, në EULEX dhe përgjithësisht në sferën juridike. 'Ndonëse shumë shpesh numri i meshkujve që punojnë si zyrtar ligjor është më i madh, diskriminimi ndaj femrave që hyjnë në këtë sferë është pozitiv, e jo negativ.'

'Unë mendoj se EULEX-i është duke bërë punë të mirë sa i përket ruajtjes së barazisë së perspektivës gjinore në të gjitha angazhimet që i ka. EULEX ka sistem të pikës kontaktuese gjinore shumë të mirë të themeluar i gatshëm të bëjë punë të mirë drejt barazisë gjinore, jo vetëm mes stafit të vet, por edhe në punën që EULEX-i kryen këtu në Kosovë.'

'Kjo nuk nënkupton se nuk ka nevojë për punë të mëtejshme. Unë kam hasur në sfida si femër gjatë punës nëpër mjedise të tjera, por në përgjithësi, nuk kam pasur ndonjë pengesë të patejkalueshme.'

Sandra shpjegon se për shumë prej sukseseve në karrierë u detyrohet prindërve të saj të cilët, sikur ajo, ishin të përcaktuar të arrinin sukses, pavarësisht pengesave. 'Prindërit e mi janë rritur në një kohë kur Lituania ende ishte pjesë e BRSS-së. Në atë kohë, nëse nuk ishe nga ndonjë familje me ndikim, nuk kishe mundësi të arsimoheshe mirë. Në fillim, nëna ime ishte kontabiliste dhe babai polic,' shpjegon ajo. 'Isha pesë vjeçare kur ra muri. Pasi morëm pavarësinë, ata u kthyen

në universitet. Nëna tani është ekonomiste dhe babai i përfundoi studimet në fushën juridike.'

Të dy prindërit e saj e inkurajuan atë që të punonte shumë dhe të kornte sukses. Ata e mbështetën Sandrën për të bërë karrierë në juridik por edhe për të shkuar jashtë vendit për studime të mëtejme. 'Mbështetja e tyre ishte shumë e dobishme, por të jem e sinqertë, nuk më nevojitej shumë inkurajim. Aq sa mbajë mend, gjithnjë kam dashur të bëhem juriste!'

Në përgatitjen e saj për t'u larguar nga Kosova pas tri vite e gjysmë qëndrim, Sandra thotë se më së shumti do t'i mungojë natyra e Kosovës. Këtu, ajo e ka eksploruar dëshirën e saj për ambiente të hapura. 'Për shkak të rrethinës, gjatë kohës sa jetova në Kosovë unë u bëra më e shëndetshme. Që prej se kam ardhur këtu, e kam pasur shumë të vështirë të qëndroja në një vend të vetëm!' thotë ajo. Me ardhjen në Prishtinë nga Holanda, ajo erdhi nga një shtet ku pika më e lartë është rreth dyqind metra. 'Një ditë, kur erdha në fillim, një kolege më tërhoqi zvarrë për ecje nëpër natyrë me të, plotësisht të papërgatitur. Mu desh vetëm një shëtitje dhe kjo shprehi u ngulit në mua. Sigurova pajisjet e nevojshme dhe hyra në sport.'

Në shi apo në diell, Sandrën e gjeni nëpër bjeshkë. Kosova jo vetëm që ia ka kultivuar dashurinë për ecje nëpër natyrë, por edhe dashurinë për fotografi. 'Këtu në Kosovë jemi të rrethuar me shumë vargmale,' thotë ajo. 'Të gjitha me natyrë dhe peizazhe të llojeve të ndryshme për t'i përjetuar, dhe jo vetëm gjatë verës! Më kujtohet kur njëherë pothuajse u bllokova në një stuhi bore në Gërmë, krejt për hir të disa fotografive të mrekullueshme.' Çka është më me rëndësi, Kosova ishte vendi ku ajo e gjeti macen e saj Trouble. 'Ta harroj veten, marrja e maces me vete në Palestinë ka qenë prioriteti im numër një!'

Sandra ka pritje të mëdha jo vetëm për këtë fazë të ardhshme në karrierën e saj, por edhe për jetën e saj të re që do ta krijojë në Ramallah. 'Shpërngulja nga Haga për në Prishtinë ishte aq e lehtë, por mendoj se Ramallah do të jetë diçka krejt ndryshe. U përshtata kaq shumë në Kosovë, por mezi pres të gjej kënaqësi dhe përvoja të reja, dhe të bëj një shtëpi të re për veten time.'



## Hetuesja me dell – njihuni me Cindy Syes

Ashtu siç kishte bërë çdo ditë gjatë njëzet viteve të kaluara, hetuesja Cindy Syes hyri në zyrën e saj në Departamentin e Policisë së Teksasit në qytetin e Dallasit. Por, kësaj radhe, në muajin shkurt 2007, ajo ishte me të vërtetë e hutuar. Kolegët e saj e përshëndetën me brohoritje, përqafime dhe duartrokitje: hetuesja Syes po e kremtonte pensionimin e saj nga shërbimi policor. Sidoqoftë, ajo as që e kishte idenë se së shpejti do të fillonte një karrierë të re me shumë mundësi dhe aventura.

Pas pensionimit të saj nga shërbimi si hetuese, Cindy për një kohë të shkurtë i aplikoi shkathhtësitë e saj prej hetueses në Drejtorinë e shkollave të Virgjinitas në qytetin Norfolk, ku punoi si Koordinator e lartë dhe ishte e ngarkuar që t'i hetojë ankesat e bëra ndaj mësimitdhënësve dhe nxënësve. Për shkak të një urgjence familjare kjo detyrë nuk i zgjati shumë, por në janar 2009, ajo do të nisej për në shërbimin e parë prej gjithsej tre syresh në Afganistan si Këshilltare në Njësitë për Mbrojtje në Familje duke i udhëzuar hetueset femra që caktoheshin për rastet e dhunës në familje. Përgjatë shërbimeve të saj në Afganistan, ajo ishte caktuar në Akademinë Policore për Femra dhe ishte këshilltare e lartë e femrës me gradën më të lartë të gjeneralit, Gjeneral Brigade Sharifa. Më pas ajo do të shkonte atje sërish në vitin 2013 deri në 2014 kur ishte caktuar Këshilltare e Lartë Gjimore e Drejtorit të Departamentit për të Drejta të Njeriut dhe Çështje Gjimore në Shërbimin Korrektues të Afganistanit. Hetuesja Syes ka punuar gjithashtu për Departamentin e Shtetit si Këshilltare e Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Gjimore në Irak prej vitit 2011 deri në 2013.

Pasi kishte qenë në vende të ndryshme të botës, kulmi i karrierës së saj në pozita të ndryshme e kishte bërë hetuesen Syes një kandidatë të përkryer për të punuar në EULEX si Këshilltare në Policinë e Kosovës për Dhunën Seksuale dhe të Bazuar në Gjini. Duke e shfrytëzuar përvojën e saj shumëvjeçare nga vende të ndryshme, detyra e saj është që të organizojë seminare jo vetëm për t'i mësuar Policisë së Kosovës dhe Prokurorëve se si t'i përdorin përcaktorët forenzik të raporte, por po ashtu t'i aftësojë ata që t'i përkrahin më mirë viktimat. "Unë dëshiroj ta përmirësoj mënyrën e komunikimit dhe gjuhën e përdorur në shërbim të viktimave dhe të punoj me kolegët vendas që ta krijojmë një plan mbështetës më gjithëpërfshirës. Ne duhet t'i mbrojmë dhe mbështesim viktimat.", thekson ajo. Qëllimi i Cindyt është që të promovohet vetëdijesimi i opinionit për femrat viktimat duke ofruar informata lidhur me pikat e kontaktit dhe mënyrën se si mund t'i përmirësojë policia shërbimet e saj në këtë fushë.

Cindy Syes punon në EULEX prej muajit mars 2017. Në këtë cilësi, ajo e këshillon Policinë e Kosovës për hetimet në baza gjimore duke biseduar me të gjithë individët, institucionet dhe OJQ-të e nevojshme për t'i mbështetur viktimat pasi të ketë ndodhur ndonjë vepër, si dhe t'i mbrojnë pjesëtarët e shoqërisë që janë në rrezik. Syes thotë, "Unë i vizitoj strehimoret, shkruaj raporte dhe bëj rekomandim për ta mbështetur Policinë e Kosovës dhe për të siguruar që ata ta përcjellin dhe plotësojnë fokusin gjinor të EULEX-it." Ajo vazhdon më tej, "Poashtu, unë punoj me OJQ-të lokale për

t'i përkrahur strehimoret për gra ku ato mund të shkojnë përkohësisht për ta larguar veten e tyre nga situatat e dhunës në familje."

Shumë prej përgjegjësave të saj në EULEX janë të ngjashme me ato të punës së saj të mëhershme si police dhe punës me komunitetet lokale. Ajo luan shumë role dhe bashkërendon me Policinë e Kosovës për të siguruar që ata ta zbatojnë strategjinë e dalë nga mandati, mes tjerash, përkritazi me komunitetin LGBT. "Dëshira ime e flaktë është vënia e drejtësisë lidhur me rastet e dhunës seksuale, gjinore dhe në familje. Përpara vetes kemi një rrugë të gjatë për t'i luftuar këto çështje në botë. Shumëçka është e shkruar nëpër dokumente, por zbatimi i tyre është një gjë krejt tjetër. Ne duhet të vazhdojmë që ta adresojmë dhunën dhe ta ngremë zërin për ata që nuk guxojnë të flasin", bën me dije ajo. "Sikur edhe në vendet tjera ku kam qenë, nëse mund të ndihmoj në aftësitë e Policisë së Kosovës lidhur me hetimin, arrestimet dhe ndjekjen e këtyre veprave, atëherë mund të them se kam arritur të bëj diçka", thotë ajo.

Nga mënyra se si është edukuar hetuesja Syes shihet qartë se si ka arritur ajo deri te EULEX-i. Babai i saj ishte një marins (ushtarak) karriere i SHBA-ve ndërsa nëna e saj punonte si asistente në Universitetin Tregtar A&M të Teksasit në Dallas. Cindy thotë, "Prindërit e mi kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm gjatë tërë jetës sime, duke më mësuar të jem e sinqertë dhe e drejtpërdrejtë e jo të lëshohem në dukuri negative. Disa pjesë të punës janë të vështira, por kur më kujtohen këshillat e prindërve të mi motivohem që t'i ndihmoj të tjerët."

Pasi ka diplomuar në shkollën e lartë Battery Creek në Beaufort, Karolina e Jugut, ajo vijoi në Universitetin Shtetëror të Tenesit, ku diplomoi në vitin 1985. Duke qëndruar fort dhe me vetëbesim, Syes tregon që ishte një atlete gjatë gjithë jetës së saj si dhe për mënyrën se si e ka përfshirë disiplinën e cila e ka mësuar të jetë stabile në jetë, veçanërisht nga mësimet në shkollën e lartë dhe nga ish-trajneri i saj i shtigjeve olimpike, Edward Temple. Mbajtja dhe promovimi i një stili jetësor të shëndetshëm ka qenë gjithmonë gjëja themelore për të. Pas diplomimit në USHT, Cindy kaloi në karrierën e saj si police në Dallas, Teksas.

"E gjitha filloi në formë të një basti/sfide. Një mik i mirë imi më thotë se unë nuk do të mund të bëhesha pjesë e forcës policore sepse isha femër. Unë isha e vendosur që t'ua dëshmoja të kundërtën," thotë Syes. "Në atë kohë trajnimi ishte i vështirë dhe nga femrat pritej që të bënin të njëjtat gjëra si meshkujt pa dallim. "Unë jam krenare që e përfundova dhe u diplomova nga Akademia e Dallasit," thotë ajo.

Detyra e parë e saj ishte patrullimi në Dallas. Më pas kaloi në policimin në komunitet duke punuar në lagjet e banimit me të ardhura më të vogla në Dallas. Pjesë të detyrave të saj ishin puna me familjet nëpërmjet shumë aktiviteteve të ndryshme të orientuara në komunitetin, si dhe luftimin e krimit. "Shumë familje që jetonin në atë zonë nuk kishin mundësi të shpreheshin dhe të dëgjohej zëri i tyre, kurse grupi i policëve më të cilët punoja unë me kënaqësi bëheshim zëri i tyre i munguar. Unë jam krenare për punën të cilën e kemi bërë dhe të cilën po vazhdojmë ta bëjnë kolegët e mi në fushën e policimit në komunitet."

Ajo e kishte të shkruar të ishte e suksesshme pasi ishte në vendin dhe kohën e duhur, si dhe duke i bërë disa arrestime të rëndësishme gjatë karrierës së saj. Një prej këtyre arrestimeve kishte të bënte me shpartallimin e një bande të grabitësve të armatosur të cilët po i grabisnin bankat për muaj të tërë. "Pasi e kishte bërë njëri prej grabitjeve ky grup, automjeti të cilin po e drejtonte udhëheqësi i këtij grupi kaloi përpara meje dhe pas një ndjekje të shkurtë dhe me ndihmën e kolegëve dhe njësisë SWAT i kapëm të gjithë pa ndonjë incident."

Gjashtë muaj që nga ardhja e saj në EULEX, Cindy thotë se deri më tani asaj i ka pëlqyer më së shumti Prishtina. Asaj i pëlqen filladi i verës, vera dhe populli i Kosovës. "Të gjithë janë jashtëzakonisht miqësorë dhe të gatshëm të ndihmojnë. Kosova ka shumë për t'i ofruar qytetarëve të saj dhe ka potencial shumë të madh." Puna e saj e çon atë anekënd Kosovës duke i vizituar të gjitha regjionet në tërë vendin. "Mua më ka pëlqyer secili vend që e kam vizituar, kurse ushqimi këtu është i mahnitshëm. Unë e kisha privilegjin që të ndihmoja me rastin e organizimit të turneut bamirës me biçikleta për

gratë dhe fëmijët duke udhëtuar në një kombibus (jo, jo, jo me biçikletë) i cili organizohet çdo vit nga mbikëqyrësi im Mark Dixon. Bjeshkët dhe zonat nëpër të cilat udhëtuam të linin pa frymë. Më duhet t'i përgëzoj çiklistët sepse bjeshkët ishin mjaft të rrepirëta, por punë që ia vlenë."

Duke qenë fëmijë i një ish marinsi, prindërit e saj u dhuruan vajzave të tyre ndjenjën për ta shijuar jetën, të takojnë njerëz të ri dhe të udhëtojnë. "Ne kemi shkuar me pushime për çdo vit, prandaj duke qëndruar nëpër qytete të ndryshme kisha mundësi të takoj njerëz të mrekullueshëm nga e mbarë bota. Kjo më ka ndihmuar që t'i krijoj bindjet dhe vlerat e mia duke i respektuar kulturat e ndryshme."

Jeta jashtë vendit i ka mundësuar Cindyt që të njihet me shumë vende, njerëz dhe kultura të ndryshme për të cilat të tjerët vetëm kanë mundur të lexojnë apo të ëndërojnë. Njohuritë, informatat dhe përvojat e dorës së parë janë kryesoret për Cindyn: ajo thotë se me libra nuk mund t'i kuptosh të gjithat. Për shembull, derisa ishte në Afganistan, ajo jetonte brenda kampit dhe lëvizjet e vetme të saj ishin nga kampi për në punë. Por, kur u stacionua në Bamiyan, Afganistan, ajo jetoi pranë rrënojave antike të Bamiyanit, ku gjatë luftës ishin shkatërruar statujat e Budës. Ajo e vizitoi Kështjellën e Kuqe dhe liqenin e shenjtë Band-e Amir. Udhëtimet e saj e dërguan atë edhe më larg si në Irak, Afrikë dhe Aman në Jordani, ku vizitoi lumin Jordan dhe qytetin Petra.

Kur jeton jashtë vendit natyrisht që i mungon vendlindja. Largësia nga familja dhe miqtë ndonjëherë bëhet e vështirë, por për Cindin gjërat bëhen më pak të vështira sepse i shfrytëzon Skype-in, Facebook-un dhe format tjera të komunikimit. "Kontakti me më të afërmit është gjithmonë i rëndësishëm, ndërsa nuk kalon ditë pa biseduar me familjen time. Kur jam në shtëpi unë kaloj kohën me nënën time, djalin tim më të ri dhe me miqtë. Shpesh shkoj në Nashville, Tennessee për ta vizituar djalin e madh dhe familjen e tij. Unë kënaqem me dy mbesat e mija dhe në bisedat me miqtë e mi si dhe me shoqet e shoqërisë studentore Delta Sigma Theta. Gjatë kohës së lirë më pëlqen të lexoj, vrapoj, stërvitem dhe të dal me shoqëri."



## Forenzika përmes teknologjisë informative – Zbulimi i krimeve në autostradën digjitale të shekullit XXI

Ndonëse teknikat forenzike përmes teknologjisë informative (TI) mund të mos jenë gjithmonë aq interesante sa paraqiten në televizion – hetuesit forenzikë nuk i ndjekin fizikisht kriminelët as nuk vihen në vijën e parë të frontit – forenzika e TI-së është pjesë e rëndësishme e procesit hetimor. Ekspertët e forenzikës kompjuterike i ndjekin kriminelët në fushën digjitale apo në “tregun kibernetik” diçka që është tejet e rëndësishme në autostradën digjitale të shekullit aktual XXI. Dhe, gjersa hetuesit forenzikë të TI-së shpeshherë ndihen të kënaqur me kontributin e tyre të dhënë për dërgimin e fajtorëve prapa grilave – ka diçka edhe më e mirë, ata mund të ndihmojnë në shfajësimin e të pafajshmëve – duke e mbështetur parimin e përjetshëm që “më mirë dhjetë fajtorë të lihen të lirë sesa të vuajë një i pafajshëm”.

Ju njoftojmë me Shqipe Salihun, eksperte forenzike e TI-së që punon në Divizionin e Hetimeve të Policisë së Kosovës. Ajo e fitoi titullin inxhinierë e kompjuterikës kur ishte vetëm njëzet vjeçare, dhe aktualisht është në përfundim të studimeve për master në fushën e shkencave kompjuterike dhe telekomunikacionit në Universitetin e Prishtinës. “Unë fillova shkollën kur isha shumë e vogël, kurse gjatë shkollës fillore i kalova disa klasë meqë si fëmijë kisha

aftësi të jashtëzakonshme,” rrëfen me modesti Shqipja.

Ajo u lind në Prishtinë, por pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Lipjan, ku si fëmijë gjeni dhe me mbështetjen e familjes ajo, që në moshë shumë e vogël, e dinte se karriera e saj do të lidhej me botën kibernetike.

Para se ta fillonte karrierën në Policinë e Kosovës si eksperte forenzike e TI-së, ajo kishte shumë vite përvojë në fushën e teknologjisë së informacionit. Natyrisht, asaj iu desh të punonte shumë dhe të arsimohej për të arritur aty ku është tani, por si nisi e gjithë kjo? “Krejt rastësisht!”, shpjegon ajo. “Unë përfundova këtu rastësisht, pa ndonjë planifikim. Gjithmonë kam pasur interesim të shtuar për teknologjinë dhe respekt të madh për gratë dhe burrat në uniforma të kaltra. Dhe, pati puthitje të dy interesimeve.”

Pasi hyri “rastësisht” në botën e kibernetikës, ajo i kuptoi mangësitë dhe përparësitë, specifikat dhe rëndësinë e forenzikës digjitale. Aty për aty u dashurua me forenzikën e TI-së, “tani shumica e krimeve ndërlidhen me teknologjinë e informacionit, e cila po zhvillohet me hov të madh. Pothuajse të gjitha krimet, si vrasjet, krimet me drogë, dhunimet, e të tjera, janë në një mënyrë të lidhura me

ndonjë pajisje digjitale. "Është pothuajse e pamundur që telefonat apo kompjuterët të mos përdoren në veprimtari kriminale, dhe aty hyjnë në punë aftësitë e mija si analiste forenzike e TI-së," thotë ajo.

Njësia e forenzikës IT në Drejtorinë e Hetimeve Forenzike të Policisë së Kosovës është e re. Roli kryesor i njësisë është ruajtja, identifikimi, vlerësimi, grumbullimi, shqyrtimi, analizimi dhe paraqitja e provave digjitale në gjykatë. Pjesa më e madhe e punës kryhet brenda në zyra, megjithatë në disa raste të caktuara, hetuesit forenzikë duhet të jenë të pranishëm edhe në teren.

Dita e punës e një hetuesi forenzik profesional është gjithçka tjetër pos një ditë e rëndomtë. "Varësisht se në çfarë rastesh punoj, si për raste të pornografisë me fëmijë, raste të korrupsionit, apo të shantazhit, shkalla e stresit mund të jetë shumë e lartë. Hetimi dhe analizimi i pajisjeve të ndryshme dhe përpjekjet për paraqitjen e provave digjitale të forta që do të mbështetnin dhe ndihmonin hetimet mund të jetë shumë sfiduese", shpjegon ajo.

Në fillim të rrugëtimit të saj në botën e forenzikës së TI-së, ajo asnjëherë nuk e kuptoi rëndësinë e rolit të vet, por një rast për të cilin ajo kishte punuar bëri që ajo ta kuptojë rolin e vet thelbësor në ndarjen e drejtësisë. "Provat që unë dhe kolegët e mi arrijmë t'i nxjerrim nga pajisje të ndryshme janë tejet jetike për secilin rast," tha ajo.

Shqipja është një prej dy hetuesve forenzikë të licencuar të teknologjisë informative (TI) në Kosovë. Me certifikatën e dhënë nga Shoqata Ndërkombëtare e Specialistëve Hetimorë të Kompjuterëve (IACIS), ajo ka të drejtën që të dëshmojë në cilësi të ekspertit forenzik të TI-së në çfarëdo gjykate të botës. "Përjetoj

një ndjenjë të fuqishme të arritjes kur dëshmoj dhe paraqes prova digjitale para gjykatësit, duke e ditur që provat e vogla digjitale mund ta bëjnë apo ta zhbëjnë rastin," shpjegon Shqipja me pasion.

Të punosh si femër në organizata të policisë nganjëherë mund të jetë sfiduese, dhe në rastin e saj, sfida është e dyfishtë. "Të dy profesionet janë disi tradicionalisht të rezervuara për meshkuj," thotë ajo, duke shtuar se "sfidat na ndjekin kudo, por kur i cakton prioritetet dhe e dini se çka doni në karrierë, atëherë duhet të këmbëngulësh me kokëfortësi."

Shqipja e sheh veten si shumë fatlume nga fakti se drejtorja ku ajo punon udhëhiqet nga femra shumë të fuqishme. "Drejtoresha jonë është një nga femrat më të fuqishme dhe profesionale me të cilat kam pasur rastin të punoj," shpjegon ajo. "Ajo na mbështetë në shumë projekte të ndryshme dhe ajo është një nga arsyet e shumta se pse njësia jonë është kaq e suksesshme."

Edhe pse njësia e forenzikës së TI-së është shumë e re, që punon vetëm që nga marsi 2014, deri më tani ajo ka luajtur rol jetik në luftën kundër krimit. "Që nga fillimi, EULEX-i në vazhdimësi ka ofruar mbështetje të jashtëzakonshme për hetimet tona digjitale. Ne i përdorim pajisjet e Misionit dhe shkëmbejmë njohuri profesionale me kolegët tonë nga EULEX-i," thotë Shqipja.

Përveç ndjekjes së kriminelëve në botën kibernetike, Shqipja i pushton edhe majat më të larta të bjeshkëve të Kosovës. "E dua alpinizmin, dhe me këtë merrem për më shumë se dhjetë vite," thotë ajo me entuziazëm. Shqipja është udhëheqëse e shoqatës vendase të alpinizmit "Blinaja" në Lipjan.

"Të merresh me raste shumë të vështira çdo ditë dhe të shohësh gjëra që me dëshirë nuk i kisha parë, mund të jetë shumë stresuese. Të bën që të dyshosh në njerëzinë. I vetmi vend i imi i sigurt, ku edhe frymëzohem për ta vazhduar luftën kundër kriminelëve është natyra," përfundon Shqipja.



## Nga Little Rock-u në Prishtinë – njihuni me Jacqueline Smith

A ju ka rënë të dëgjoni ndonjëherë tregime për heronjtë e padëgjuar? Për policët e paepur që patrollojnë rrugëve, pothuaj të padukshëm në punën e tyre që të na mbajnë neve të sigurt? A i keni parë ato buzëqeshjet e tyre qetësuese që ju bëjnë të mendoni se bota në të cilën jetojmë nuk do të na shembet para këmbëve?

Njihuni me Jacqueline Smith, rreshter policie e pensionuar në SHBA, e cila tani punon në EULEX. Duke qenë nga Little Rock, Arkanzas, rruga jetësore e saj ishte me plot kthesa, njësoj sikur ajo e një biri tjetër të famshëm të këtij vendi, ish-Prezidenti i SHBA-ve Bill Clinton.

Jacqueline u lind në një familje infermierësh dhe që në moshë të re kishte vendosur që ta sfidonte traditën tashmë të krijuar në familje duke u bërë police, përkundër zhgënjimit të madh të nënës së saj. “Në fillim nëna ime nuk ishte e kënaqur që unë po bëhesha police. Ajo brengosej se mos do vritesha në detyrë. Por, shumë shpejtë e kuptoi se përkundër të gjitha vështirësive puna e policit është një detyrë fisnike dhe në fund ajo më përkrahu plotësisht”, thotë Jacqueline.

Jacqueline iu bashkua Sektorit të EULEX-it për Fuqizim para disa muajve. Pozita e saj është Këshilltare që e mbështet Policinë e Kosovës me anë të monitorimit, mentorimit dhe këshillimit për mënyrën se si ta avancojë punën policore në bazë të inteligjencës. Qëllimi i saj nuk është vetëm

t’i ofrojë mbështetje dhe ta ndihmojë Policinë e Kosovës, por po ashtu t’i sjell edhe disa nga përvojat dhe njohuritë e saj ashtu që të mundësohet qëndrueshmëria pas përfundimit të mandatit të tanishëm në qershor të vitit 2018.

“Unë dëshiroj t’i përkrah kolegët e mi në Kosovë ashtu që ata të ecin drejt qasjeve dhe praktikave të reja të cilat do t’i përmirësojnë operacionet e tanishme duke i bërë më të mira”, thotë ajo, duke theksuar se komunikimi dhe bashkëpunimi është pjesë shumë e rëndësishme për t’i përmirësuar edhe më shumë këto praktika.

Jacqueline ka studiuar në Universitetin e Arkanzasit për të drejtën penale me qëllim të hulumtimit dhe ligjërimit në akademinë e Zyrës Federale të Hetimeve (FBI) për trajnime. Mirëpo, në kohën kur kishte aplikuar, pezullimi i punësimeve në FBI e dërgon atë mijëra milje larg me një hap të vetëm. Ajo vendosi që ta pranonte mundësinë e punësimit si police në Atlanta, Gjeorgjia. Atje ajo qëndroi për më shumë se 20 vite duke u ngritur gradave prej zyrtarit policor të angazhuar në komunitet deri sa u bë detektive që ka korrë rezultate në raste si dhuna në familje, çështje të brendshme dhe hetimet me anë shërbimit të zbulimit. Në kulmin e karrierës së saj ajo u pensionua si Rreshter që i mbikëqyrte rreth 30 oficerë patrullues



të cilët merreshin me thirrjet emergjente në numrin 911 duke zgjidhur rastet e veprave të komuniteteve të ndryshme në Atalanta si vjedhjet ordinere, dhunës në familje, plaçkitjet, dhe vrasjet.

Duke qenë police femër nuk ishte gjithmonë e lehtë, thotë Jacqueline, veçmas kur duhej ta dëshmoja autoritetin mbi kolegët meshkuj. "Si mbikëqyrëse dhe si femër, më është dashur ta dëshmoj se unë isha po aq e zonja në zgjidhjen e krimeve, kapjen e kryerësve të veprave dhe shenjëtare precize ashtu që ta fitoja respektin e kolegëve meshkuj. 'Unë ia kam dalë me shumicën prej tyre', na tregon Jacqueline.

Ajo beson se puna policore përbëhet prej dy elementeve të rëndësishme: profesionalizmi dhe kujdesi ndaj qytetarëve. "Ne jemi këtu që t'ju ndihmojmë," është një prej shprehjeve qetësuese të cilat i ka përdorë më së shumti Jacqueline kur është dashur të krijonte lidhjen me afro-amerikanët në Atlanta. Përgjatë 20 viteve të punës së saj në polici; ajo kishte miq në komunitetet lokale; ajo ishte e suksesshme dhe u ndihmoi njerëzve që ta kuptojnë sistemin e drejtësisë penale. "Unë isha mike me disa. Për disa të tjerë isha armike, por mbi të gjitha kam mbajtur nivel të fuqishëm të etikës së punës, integritetit dhe duke e bërë këtë jam zhvilluar si person dhe si profesioniste", thotë ajo.

Në ndërkohë, Jacqueline ndoqi edhe ëndrrat akademike të saj. E pajisur me magjistraturë për administrim biznesi dhe tjetrën për drejtësi penale, ajo vendosi që të vijonte studimet e doktoratës për edukim, dhe kjo e tëra derisa ligjëronte lëndë të drejtësisë penale në një universitet lokal në Gjeorgjia.

Megjithëse ajo ka ardhur në Kosovë vetëm disa muaj më parë, Jacqueline i ka bërë

përshtypje tradita dhe kultura e saj. "Unë gjithmonë kam dashur të vij në Evropë dhe të mësoj për kulturat e ndryshme. Shpresoj që gjatë qëndrimit tim këtu edhe unë do të sjell gjëra pozitive nga vendi im. Unë jam pensionuar para kohe nga policia në mënyrë që të vij këtu", thotë Jacqueline. Por mbi të gjithat, ajo është impresionuar më së shumti nga kosovarët. Asaj i pëlqen shumë kur fëmijët e pyesin për emrat e basketbollistëve që ajo i pëlqen, apo kur provojnë t'i thonë shprehjet e reja në gjuhën angleze. Në anën tjetër, ajo vetë po bën përpjekje që të mësojë sado pak gjuhën shqipe. Fjala më e dashur e saj është 'faleminderit'. Asaj i pëlqen fakti që fqinjët e saj janë të kujdesshëm dhe përkujdesen edhe për të.

Duke besuar fuqishëm se frymëzimi vjen më shumë nga rrugëtimi se sa nga destinacioni i tij, dëshira e Jacqueline është vazhdimi i studimeve akademike të saj dhe të vazhdojë të ndajë me të tjerët njohuritë dhe përvojat e saj. "Më pëlqen trajnimi dhe mësimdhënia, që t'u ndihmoj të tjerëve t'i kuptojnë gjërat. Gëzohem shumë kur i shoh fytyrat e tyre të shkëlqejnë, pasi i kanë kuptuar gjërat", e pranon ajo. "Unë kam mësuar shumë nga studentët e mi. Më pëlqen jeta, shkëmbimi i ideve dhe bashkëbisedimi me gjeneratat e reja. Unë kam besim në rrugën time", thotë ajo në fund.



## Midis drejtësisë dhe muzikës – njihuni me Vjollca Kroci-Gerxhaliu

E lindur dhe rritur në Prizren, një qytet i lashtë ku arti dhe historia përcjellët nëpër gjenerata, ka luajtur një rol të madh që ajo të bëhet kjo që është sot. Njihuni me Vjollca Kroci-Gerxhaliu, e cila punon në EULEX si këshilltare ligjore.

Vjollca është këshilltare ligjore në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme. Atje ajo bashkëpunon ngushtë me gjyqtarët e EULEX-it, të cilëve u ndihmon gjatë gjykimit të rasteve të rënda penale. Ajo mendon se puna në një mjedis gjyqësor shumë-kulturor në kuadër të këtij Misioni, i mundëson asaj që të zhvillohet profesionalisht. “Unë ia kam dalë që ta përshtat dhe harmonizoj përvojën time profesionale të mëparshme për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të këtij Misioni”, sqaron ajo.

Që në moshë të hershme, Vjollca u ballafaqua me dilemën nëse do të ndiqte hapat e muzikës apo të juridikut. Duke qenë se është rritur në një familje avokatësh të njohur kosovarë dhe duke i dëgjuar rrëfimet e tyre, kjo i ndihmoi që të anonte kah juridiku. “Më ka pëlqyer shumë piano, por kur erdhi koha të vendos se çka do studioj, unë zgjodha juridikun”, thotë Vjollca.

Edhe pse është e zënë me punët e drejtësisë, Vjollca vazhdon ta ketë pasion muzikën. “Më pëlqen Shopeni. Qetësohem

kur e dëgjoj muzikën e tij”, thotë ajo.

Karriera profesionale e Vjollcës filloi pas përfundimit të konfliktit në Kosovë. Në vitin 1999, asaj iu dha mundësia dhe e nisi punën e saj në “International Medical Corporation” në departamentin e burimeve njerëzore. Në këtë detyrë, ajo ishte përgjegjëse për kontratat dhe punësimet. Ndërsa kjo nuk ishte një situatë ideale për një juriste, kjo pozitë ia hapi dyert për punë të mëtejme me organizatat ndërkombëtare.

Vjollca është rritur në një familje të ngritur dhe të arsimuar. I ati i saj ishte arsimuar në Kroaci dhe kishte punuar si profesor i mbrojtjes ushtarake në Kolegjin e Dubrovnikut dhe në Shkollën e Lartë në Prizren pasi ishin kthyer në Kosovë. Vdekja e tij në moshë të re i la barrën e rritjes së dy fëmijëve nënës së saj.

“Nëna ime është heroina ime. Në kohën kur ne humbëm babanë tonë ndërsa ajo shokun e saj të jetës, nëna ime ishte shumë e re. Ajo gjithmonë ishte një prind i përkushtuar, duke u bërë nëna dhe babai ynë, duke na rritur për t’u bërë personalitete të forta. Fryma e babait tim në rritjen e vëllait tim dhe timen na ka bërë që të synojmë arritjen e standardeve më të larta të arsimimit dhe kjo ka qenë diçka të cilës nëna ime i ka qëndruar gjithmonë besnike”, thotë Vjollca.

Rëndësia e familjes për Vjollcën është e

dukshme. Kur e pyetëm për të arriturën më të rëndësishme ajo u përgjigj me shpejtësi “tre fëmijët e mi.” Duke i mbështetur me shumë pasion, ajo kënaqet duke dëgjuar se si e kanë kaluar ditën dhe i inkurajon ata në çdo angazhim, si në mësimet ashtu edhe në projekte të ndryshme kreative.

Në vitin 2000 ajo filloi punën në OSBE ku shumë shpejtë e gjeti veten në ambientin shumë-kulturor të saj. Brenda pak muajve, Vjollca u promovua në këshilltare ligjore dhe filloi të punojë në rastet e mbrojtjes penale.

Derisa ishte në OSBE, Vjollca i ka ndihmuar avokatët mbrojtës kosovarë në përgatitjen e lëndëve penale prej fillimit e deri në fazat e fundit të procedurave penale. Këtë e kishte bërë duke e respektuar në tërësi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, që në atë kohë kishin filluar të aplikoheshin në sistemin juridik të Kosovës. “Unë kisha shumë vetëbesim në këtë rol, dhe në vitin 2005 e hapa avokaturën time ku punova për nëntë vite”, thotë Vjollca.

Deri sa nuk e kishte hapur avokaturën e saj ajo s’e kishte kuptuar rëndësinë dhe kënaqësinë e të punuarit në mjediset shumë-kulturore, ku ajo ishte sfiduar dhe stimuluar rregullisht gjatë punës së saj. “Më ka munguar atmosfera e ekipit ligjor shumë-kulturor të cilin e kisha gjetur në OSBE, prandaj në vitin 2014 vendosa të punësohem EULEX.”

Vjollcës i pëlqen shumë ecja dhe kënaqet me aktivitetet në natyrë. Ajo thotë: “Shpesh herë më ngacmojnë në punë sepse unë për çdo ditë eci këmbë prej shtëpisë deri në Pallatin e Drejtësisë dhe anasjelltas.” Prandaj, nuk duhet të befasoheni nëse gjatë fundjavave e takoni duke ecur nëpër male me qenin e saj.

Ajo është shumë krenare që ishte personi i parë që i ka ndihmuar një avokati mbrojtës kosovar që ta përpilojë ankesën e parë për Gjykatën për të Drejta të Njeriut në Strasburg në kohën kur punonte në Qendrën Burimore për Mbrojtje Penale të themeluar nga OSBE-ja. Ajo e kujton që ky ishte një rast i arrestimit arbitrar. “Për mua kjo ishte një gjë e jashtëzakonshme, që të jesh pjesë e një diçka të re dhe të shohësh diçka që zhvillohet për herë të parë në Kosovë,” thotë ajo me krenari.

Ajo beson se sundimi i ligjit në Kosovë është duke u përmirësuar e bashkë me këtë edhe besimi i qytetarëve në institucione. “Kosova ka bërë përpjekje që prej përfundimit të konfliktit. Ne është dashur të fillojmë prej zëros në fushën e sundimit të ligjit. Unë jam e lumtur që punoj në një mision si EULEX-i, i cila vazhdon të kontribuojë shumë në këtë proces”, thotë ajo. “Unë mendoj se mbetet edhe shumë për t’u bërë në fushën e drejtësisë, por ne jemi në rrugë të mbarë për ta arritur këtë. Këtë ia kemi borxh fëmijëve tanë – por edhe vetes”, thotë ajo në fund.



## Drejtësia është mozaik

Gjersa shëtitej nëpër bregdetin e qarkut Kerry në pjesën jugperëndimore të Irlandës, me pamje nga Oqeani Atlantik, dy vite më parë Cathy Houlihan mendoit thellë për hapin e ardhshëm në karrierën e saj. Ajo donte diçka ndryshe, diçka që me shpejtësi do ta zhvillonte atë profesionalisht dhe personalisht. Me 12 vite përvojë në fushën e policisë dhe si detektive që ishte, Cathy aplikoi për një pozitë në EULEX. Pas një kohe të shkurtë ajo u përzgjodh në pozitën e zyrtares për hetime të brendshme në Mision, dhe udhëtoi për në Kosovë duke e lënë pas horizontin e pafund të oqeanit dhe qiellit.

“Pasi që tërë jetën time kisha punuar në Irlandë, doja një sfidë të re – diçka që ishte ndryshe prej hetimeve të krimeve të rënda. Gjithnjë kisha interesim të madh për Ballkanin, në veçanti për Kosovën,” vazhdon ajo, “kjo luajti një rol tepër të rëndësishëm për vendimin tim për të ardhur këtu.”

EULEX-i është misioni më i madh i Politikës së Përbashkët të BE-së për Siguri dhe Mbrotjtje, por edhe mision i vetëm që ka njësi për hetime të brendshme. Kjo njësi, në të cilën Cathy tani punon, është në kuadër të Zyrës së Shefit të Misionit. Roli i saj primar është zhvillimi i hetimeve rreth shkeljeve disiplinore që pretendohen

se janë kryer nga punonjësit e misionit. Cathy siguron që çdo punonjës i ri në mision të informohet plotësisht rreth kodit të sjelljes.

Udhëtimi i saj për në Kosovë është unik. Cathy vjen nga një familje policësh, çka e bën atë detektive të lindur dhe ambicioze – ndoshta për shkak të viteve me pyetjet nga babai i saj, ish-detektiv, dhe motivimit nga axha i saj, i cili është zyrtar policor në Irlandë. Me një përfaqësim të gjinisë femërore prej rreth 25 për qind, Cathy Houlihan ishte e përcaktuar që t’i kontribuonte kësaj force policore.

“Në ekipin tim, meshkujt dhe femrat punojnë krah për krah. Të gjithë ne mbështesim njëri-tjetrin në aktivitetet tona të përditshme. Shefja e policisë në shtetin tim është femër. Kjo është shumë inkurajuese për femrat në këtë forcë”, thotë Cathy.

Pasi u diplomua në fushën e studimeve sociale dhe kujdesit social, Cathy menjëherë u pranua në akademinë policore ku studimet zgjasin dy vite.

Kur flet për përgatitjen profesionale, ajo thotë: “Mua më pëlqen e tërë puna ime, ngase përbëhet prej shumë

aktiviteteve të llojlojshme. Në fillim, si të gjithë zyrtarët policorë në Irlandë, unë patrolloja nëpër rrugë, por më pas u avancova në pozitë të hetueses së krimeve. Unë jam hetuese e krimeve të rënda, ku përfshihen vrasjet, vrasjet pa paramendim, sulmet e rënda, vjedhjet, grabitjet, trafikimi i drogave, sulmet seksuale, dhe të tjera. Unë e dua aksionin dhe jam e pasionuar pas të qenit pjesë e rëndësishme në zinxhirin e drejtësisë.”

Ndryshe nga ajo çfarë mund të mendojnë të tjerët, ajo thotë se vrulli i adrenalinës nuk vjen nga ndjekjet me vetura në shpejtësi të madhe, për shembull, por nga zgjidhja e rastit penal. “Është sikur përfundimi i një mozaiku. Unë i dëgjoj të gjitha anët, pastaj i bashkoj të gjitha përmes marrjeve në pyetje dhe hetimeve,” thotë ajo me entuziazëm. Shpërblimi nga puna e saj është kur të arrihet drejtësia. Në EULEX, hetimet e saj janë ndryshe, meqë në rastet e procedurave disiplinore më shumë ka të bëjë me dokumentacione. Houlihan është e zonja të arrijë barazpeshë të përsosur mes punës dhe jetës personale në EULEX. “Këtu në Kosovë kam qenë me fat që kam bërë miq të mrekullueshëm dhe të përjetshëm, të cilët jam e sigurt se do t’i takoj prapë në të ardhmen e afërt.”

Për herë të parë, Cathyt iu mundësua të udhëtojë gjatë fundjavave dhe të jetojë përtej bregdetit irlandez ku ajo qëndroi para dy viteve. Vendi i saj më i parapëlqyer për eksplorim në Kosovë është Prizreni, qytet i bukur piktoresk me lum që kalon nëpër qendër, mu si Kork Siti (Cork City) në Irlandë ku ajo zakonisht jeton. Ajo thotë se Kosova ka shumë për të ofruar sa i përket pamjeve,

“krejt çka ju duhet është të dini ku të shkoni. Më pëlqen të vizitojë Brezovicën gjatë dimrit meqë Irlanda nuk ka qendra për ski. Edhe ujëvarat e Mirushës janë po ashtu të bukura dhe paqësore”.

Me një grup të miqëve nga EULEX-i, Cathy po ashtu ka bërë disa udhëtime të shkurta jashtë vendit. “Një nga përvojat më mbresëlënëse ishte pamja e shkëmbinjve në formë koni “oxhaqet e zanave” në Kapadokia në Turqi nga një shëtitje me balon në qiell të kaltër dhe të ndritshëm. Ende më kujtohet qetësia që shoqëronte pamjen”, thekson Cathy. Edhe pse i mungon vendi i saj, ajo thotë, “Më kanë ardhur miq dhe familjar për të më vizituar këtu, për të parë, përjetuar dhe mësuar rreth kulturës në Kosovë dhe mënyrës së bukur të të jetuarit këtu.” Ajo po ashtu është edhe zëvendëse e kontingjentit irlandez në Kosovë, kështu që shtëpinë asnjëherë nuk e ka shumë larg.

“Ne jemi një kontingjent i vogël me shtatë pjesëtarë, por jemi shumë të famshëm në Mision. Ndoshta është për shkak të kafesë sonë të shijshme dhe festave të famshme të Paddyt të cilat japin përshtypjen se ne jemi ekip shumë më i madh. Në disa raste edhe e kemi ngjyrosur Misionin me të gjelbër”, thotë ajo.

Cathy nuk është e tëra punë dhe udhëtime. Gjatë kohës sa ishte në Kosovë, ajo ka arritur të marrë edhe një diplomë tjetër, nga fusha e kriminalistikës dhe psikologjisë kriminale, si dhe ka vijuar edhe kurse të tjera për avancim në karrierë. Ndonëse qëndrimi në Kosovë është i shkurtër, kujtimet, miqësitë, dhe zhvillimi

personal do të mbesin përgjithmonë. Kur Cathy do të kthehet në Irlandë, ajo do të vazhdojë të zgjidhë misteret e krimeve të rënda. “Mezi pres të shkoj në bregdet, të takohem me familjarët dhe miqtë, dhe t’i kthehem karrierës sime të pasur si detektive dhe të sjell drejtësi për viktimat,” thotë ajo.



## Drita Hajdari: Të heshtësh është krim

Qofshin ato bjeshkët e Kosovës, fushat e Shqipërisë, apo liqenet e Malit të Zi, zonja Drita Hajdari i eksploron të gjitha. Adhuruese e natyrës, Dritës i pëlqen të ecë nëpër natyrë, dhe këtë e praktikon pothuajse çdo fundjavë. Gjersa flet me vetëpërmbytje rreth aktiviteteve dhe përjetimeve të saj në natyrë, shoqëruar me të qeshur dhe ngrohtësi, askush nuk do të paramendonte se ajo heton dhe ndjek penalisht çështjet më sfiduese dhe problematike të Kosovës. Zonja Drita Hajdari punon si prokurore në Prokurorinë Speciale të Kosovës. Me veshje pedante, me vetëbesim dhe përkushtim të plotë, Drita e nisë udhëtimin e saj të drejtësisë për çdo mëngjes.

Ajo është prokurorja e parë vendase që ka ngritur aktakuzë për krime lufte kundër një politikani të lartë në Kosovë.

“Kam vijuar studimet në fakultetin juridik dhe u bëra prokurore për t’u marrë me krime që pak kush i zgjedhë t’i ndjekë penalisht. Unë merren me raste për të cilat besoj fuqishëm se kanë nevojë të trajtohen. Kësaj shoqërie i nevojitet sundimi i ligjit. Të ngritësh kundër krimeve të rënda në Kosovë dhe të jesh zë i drejtësisë është nder. Kjo më mban të motivuar çdo ditë,” thotë Drita.

Duke iu shmangur bisedave rreth detajeve të punës së saj të përditshme, meqë ajo merret me çështje shumë të ndjeshme, ajo duket shumë ambicioze dhe e përkushtuar gjersa flet rreth drejtësisë.

Rrugëtimi në gjyqësor i zonjës Hajdari filloi që në vitet e tetëdhjeta. Një vit pas diplomimit nga fakulteti juridik në vitin 1983, ajo filloi të punonte fillimisht si gjyqtare.

Zonja Hajdari punoi si gjyqtare deri në vitin 1990, kur edhe filloi kriza në ish-Jugosllavi. Edhe pse ajo asnjëherë nuk e kishte paramenduar se do ta ndryshonte profesionin, ajo vendosi ta braktiste bankën e gjyqtares për t’u bërë avokate. Ajo ishte e përcaktuar që të fliste në emër të atyre që nuk mund të flisnin për veten. Ajo punoi si avokate për disa vite në kohëra dhe kushte shumë të vështira.

Kur e kujton kohën kur punonte si gjyqtare në ish-Jugosllavi, ajo thotë se dallimi kryesor i sistemit gjyqësor aktual dhe atij të asaj kohe është se përgjegjësinë për të dëshmuar krimin në gjykatë tani e ka prokurori. Kur i shpjegon betejat e panumërta që i ka luftuar në gjykatë, me këmbëngulje thekson se suksesi i rasteve nuk varet vetëm prej prokurorit, siç e thonë shumë të tjerë. “Kërkesa për zhvillim të hetimeve, ndërprerja e hetimeve, ngritja e aktakuzës, e të tjera, janë suksese përgjatë procedurës. Këto kërkojnë përpjekje të mëdha nga të gjitha palët, pavarësisht epilogut. Të gjitha këto procese duhet të sigurojnë qasje në drejtësi dhe procedura të drejta, dhe ky është sukses në sundimin e ligjit” thekson Drita.

Menjëherë pas krizës në Kosovë ajo u emërua prokurore, në kohën kur i tërë sistemi

i drejtësisë administrohej prej Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Meqë para konfliktit ajo kishte jetuar në Mitrovicë dhe gjatë krizës i kishte humbur të gjitha, përfshirë shtëpinë dhe të gjitha gjërat, ajo u zhvendos në Prishtinë dhe në vitin 1999 nisi çdo gjë që nga fillimi. Por asgjë nuk e ndali të ndiqte atë që ajo e besonte se ishte e drejtë.

Kushtet e punës për prokurorët dhe gjyqtarët menjëherë pas luftës në Kosovë ishin shumë të vështira. "Punën si prokurore e lash me dhimbje, por ishte e pamundur t'ia dilje me të ardhurat e prokurorit menjëherë pas luftës," kujton Drita.

Megjithatë, ishte e entuziazmuar që prapë të përqafonte rrugëtimin e saj në drejtësi, dhe vazhdoi karrierën me Kombet e Bashkuara, në njësinë e inspektimit gjyqësor. Si pjesë e asaj njësie, ajo ndihmoi në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe për themelimin e Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor të Kosovës.

Ajo punoi me Kombet e Bashkuara deri në vitin 2008, kur iu bashkëngjiti një projekti të USAID-it për sundimin e ligjit, për të punuar vetëm dy vite aty. Në vitin 2010 Drita vendosi t'i kthehej profesionit që e mbante në zemër. "Gjatë gjithë atyre viteve pas luftës, kur e lash punën e prokurorisë dhe fillova të punoja për OKB-në, çdo ditë i thosha vetës se do të kthehesha në prokurori," thotë Drita.

Pas një procesi shumë të gjatë dhe sfidues të ri-emërimit, ajo u caktua si prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Gjatë punës së saj në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, ajo e udhëhoqi betejën kundër korrupsionit dhe u zgjodh si koordinatore nacionale kundër korrupsionit. E trajnuar për të trajtuar krime kaq të rënda, ajo ishte e vetmja që merrej me raste të korrupsionit në Prishtinë për një kohë shumë të gjatë. "Çdo gjë ndodhë në Prishtinë. Të gjitha institucionet janë këtu. Pra ju mund ta paramendonit ngarkesën e punës dhe sfidat

e rasteve me që cilët jam marrë çdo ditë" shpjegon Drita, duke shtuar se pavarësisht stresit dhe vështirësive, ajo merrte kurajë prej rezultateve konkrete.

Që nga viti 2013 kur u emërua si prokurore speciale, ajo gjithnjë ka qenë në kërkim të një sfide të re. Është shtyrje e adrenalinit profesional, shpjegon ajo. Gjatë katër viteve të fundit, çdo ditë ka luftuar krime të rënda. Nga korrupsioni, deri tek terrorizmi dhe krimet e organizuara – Drita nuk njeh kufi. Si luftëtare e vërtetë, ajo asnjëherë nuk ndalon së luftuari për drejtësi. "Mua më shtyjnë sfidat. Ato më motivojnë. Unë zgjohem çdo mëngjes, rikujtoj dhe i premtos vetes se më duhet të jem e qetë, por momentin që hy në gjykatore, të gjitha premtimet dhënë vetes zhduken," thotë Drita.

Ajo e merr çdo rast afër zemrës dhe tërë energjinë e përqëndron aty. Me plot dosje në duar dhe e përcaktuar të arrijë sukses, ajo shndërrohet në zjarr menjëherë pasi hyn në gjykatë.

Përvojat e ndryshme ligjore të Dritës i kanë ndihmuar që ajo të analizojë secilin rast nga perspektiva të ndryshme: "Tani kur punoj në ndonjë rast, kam përparësinë e analizimit si prokurore, si gjyqtare dhe si avokate. Kjo më ndihmon tej mase," thekson ajo.

Përgjatë karrierës së saj, Drita ka patur rast të punojë me shumë gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë ndërkombëtarë. Me vlerësim ndaj kontributit të tyre të skajshëm për sistemin e drejtësisë në Kosovë, ajo fuqishëm beson se tani ka ardhur koha që kosovarët t'i marrin punët përsipër. "Unë mendoj se ne vet duhet të kujdesemi për këtë vend," thotë ajo me vendosmëri.

Pavarësisht të gjitha problemeve me të cilat ballafaqohet Kosova në fushën e sundimit të ligjit, Drita është në favor të bartjes së kompetencave nga ndërkombëtarët tek autoritetet e vendit. Ndërhyrjet, kërcënimet,

deklaratat publike të zyrtarëve rreth proceseve gjyqësore në vazhdim e sipër, metodat e sofistikuar të shantazhit dhe frikësimit janë shumë prej shqetësimeve që Drita i ngritë. Megjithatë, ajo ka besim të madh se me disa investime financiare në paga dhe sigurim shëndetësor, gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës mund të marrin tërë përgjegjësitë përsipër.

Kur kthehet tek vitet e adoleshencës, Dritës i kujtohet se si e tërë familja e saj e quanin avokate. "Tërë jetën kam luftuar për drejtësi dhe barazi. Gjithmonë e kanë ruajtur parimin e drejtësisë. Kam luftuar për idealet e mia dhe gjithnjë kam besuar në rëndësinë e drejtësisë," thotë ajo.

Lufta e saj e vazhdueshme me padrejtësitë dhe pabarazitë është ajo që e mbanë të motivuar. "Nuk mund të heshti rreth gjërave që bëhen gabim. Njerëzit më kritikojnë për mungesë të shkathtësive diplomatike, por kjo unë jam. Kështu jam lindur. Unë e them atë që e besoj dhe luftoj për të. Unë mendoj se të heshtësh është krim, sepse heshtja i ndihmon krimin në një mënyrë shumë mashtruese," thotë ajo.

Natyra e punës së saj kërkon që ajo të mos ekspozohet shumë në publik dhe të ketë rreth të kufizuar të miqve, por ajo është e kënaqur të jetë afër miqve dhe familjes.

Me një barazpeshë mes punës së saj të përditshme dhe jetës private, Drita është shumë e organizuar. Asaj i pëlqen të frekuentojë palestren tri herë në javë. "Palestra më freskon mendjen. I bënë mirë shëndetit mendor," thekson ajo. Përmes largimit të presionit të punës qoftë në palestër apo gjatë ecjeve nëpër natyrë gjatë fundjavave, Drita ka mësuar që ta përqafojë mënyrën e saj të jetesës dhe do të vazhdojë të punojë çdo ditë me shumë zell, për një sundim më të mirë të ligjit në Kosovë.



## Agata Szymanska – Barazia gjinore – jo përse, por si

Hyn në restorantin Baba Ghanoush gjatë ndonjë dite të ftohtë në Prishtinë dhe do të gjesh ngrohtësi, ushqime vegjetariane, dhe shoqëri të zhytur në të qeshura rrëmbyese dhe të përzemërta. Aty do të mund ta gjeni edhe Agata Szymanska – personifikim i të gjitha këtyre cilësive, e cila punon si ushtruese e detyrës së këshilltares për çështje gjinore në EULEX Kosova. Megjithatë, po ta pyesësh për punën e saj në EULEX Kosova, atmosfera gazmore do të shndërrohet në serioze. Agata Szymanska është tejet pasionante për çështjet gjinore dhe e etur të flasë për njohuritë që ka.

Puna që Agata bënë, siguron që aktivitetet e Misionit të përgatiten në përputhje me standardet ndërkombëtare për barazi gjinore. Në pajtim me zotimin e Misionit për përfshirjen e çështjes gjinore në të gjitha aktivitetet e veta, në departamente të ndryshme është i inkorporuar një rrjet vullnetar, i përbërë prej 19 pikëve kontaktuese për çështje gjinore. Qëllimi i këtij rrjeti është zgjerimi i veprimtarisë së këshilltarit gjinor dhe zbatimi i perspektivës gjinore në njësitë përkatëse të Misionit.

Kur Szymanska filloi punën, EULEX-i ishte duke kaluar nëpër zvogëlime të konsiderueshme të numrit të punonjësve. Rrjeti kishte nevojë të fuqizohej në aspektin e anëtarëve të rinj dhe trajnimet e reja. Përmes këtyre trajnimeve,

pikët kontaktuese për çështje gjinore përvetësuan njohuri për kryerje të analizave gjinore në kuadër të mandatit të EULEX-it.

“Një sërë projektsh të pikave kontaktuese për çështje gjinore kanë qenë rreth themelimit të sistemeve për grumbullimin e të dhënave të ndara sipas gjinive. Kjo na mundëson t’i analizojmë ato të dhëna dhe t’iu japim Misionit dhe autoriteteve vendore rekomandime rreth çështjeve gjinore”, thotë ajo.

Për të parë pjesë të tjera të Ballkanit, gjatë fundjavave Szymanska udhëton sa më shumë që mundet. Brenda një periudhe të shkurtë, ajo e ka vizituar Serbinë, Maqedoninë dhe Shqipërinë. Ajo është e interesuar të vizitojë shtete të reja dhe t’i përjetojë tregimet e tyre unike, qoftë edhe vetëm për pak.

Nëse nuk është në ndonjë udhëtim, Agata praktikon joga dhe, kur ka kohë, i pëlqen të gatuajë. Por burimin kryesor të energjisë e gjen nga bisedat interesante me miq. “Disa prej atyre që i takova këtu më janë bërë miq shumë të mirë, nuk kam pritje që këtu në Kosovë të gjejë miq të përjetshëm, por ja se gjeta”, vijon ajo.

Agata ka prejardhje unike. Ajo është vajzë e lindur nga prindër polakë, dhe e shpërngulur në Suedi në një moshë të re. Diplomoi në Universitetin e Malmö në studime për paqe dhe konflikte, dhe



studioi për politikat ndërkombëtare përmes një programi të shkëmbimit në Kore dhe më vonë në Vankuver. Agata zbuloi pasionin për analizimin e ngjarjeve ndërkombëtare nga perspektiva feministe.

“E pashë rëndësinë e perspektivës gjinore në analizimin e konflikteve”, thotë Szymanska. Ajo vazhdoi nivelin masters në Universitetin e Uppsala në fushën e studimeve euroaziatike, ku disa prej kolegëve nganjëherë bënë shaka se ajo nuk mundte pa e përmendur çështjen gjinore nëpër provime. “Ndikimi i konflikteve tek gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, është i ndryshëm, dhe perspektiva gjinore këtu siguron që nevojat e meshkujve dhe të femrave për sa i përket sigurisë trajtohen në mënyrë të përshtatshme”. Megjithatë, “nuk e kisha të qartë mënyrën e zbatimit të aftësive të çështjeve gjinore; edhe kjo është aftësi si gjitha të tjerat dhe merr kohë për t’u përvetësuar”, thotë Szymanska me një të qeshur të rezervuar, edhe pse e dinte shumë mirë se e kishte gjetur mënyrën.

Agata pastaj marshoi përpara dhe për disa vite punoi në Akademinë Folke Bernadotte, agjenci e qeverisë së Suedisë nën Ministrinë e Punëve të Jashtme. Në departamentin ku punonte, detyrat e saj renditeshin prej përgatitjes së trajnimeve për çështje gjinore për udhëheqësit brenda MPJ-së, deri tek lehtësimi i dialogjeve mes agjencive të ndryshme qeveritare. Ajo u ngrit në detyrë dhe u bë zyrtare për trajnime dhe projekte në Akademi, duke e hapur kështu një kapitull të ri me rolin e ushtrueses së detyrës së këshilltares për çështje gjinore në EULEX.

Edhe pse në EULEX qëndroi shkurt, Agata fitoi përshtypje të mëdha si personale ashtu edhe profesionale nga kolegët e saj. “Që kur fillova punën në Mision, unë mësova shumë gjëra të reja; kolegët

më mësoan rreth misionit dhe i ndanë njohuritë e tyre me mua. Mësova shumë, por jeta në Mision po ashtu më dha mundësinë të punojë në mjedis shumë dinamik dhe shumëkulturor me disa prej njerëzve më inteligjentë nga vende të ndryshme të botës.”

Ndryshe prej gjurmëve në borë, gjurmët e Agatas mund të mbeten të pranishme deri në fund të mandatit të Misionit. Një prej kontributeve ka qenë përmirësimi i mekanizmit të raportimit mbi ngacmimet dhe sulmet e bazuara në gjini.

“Ndjehem krenare që e kam mundësuar një diskutim që do t’i përmirësojë mënyrat në të cilat Misioni i trajton këto çështje dhe që punonjësit t’i raportojnë ato rastë”, vazhdon ajo, “megjithatë, zbatimi i mënyrave të reja kërkon punë në teren dhe kohë. Koha nuk ka qenë në anën time”, thekson ajo.

Nuk është diçka e pazakontë që këshilltarët për çështje gjinore të hasin në rezistencë. Megjithatë, Agata thotë se brenda Misionit shumë prej sugjerimeve të saj janë dëgjuar. Shpesh në trajnime asaj i bëhen pyetje rreth ndikimeve nganjëherë negative të kulturës së vendit mbi çështjet gjinore. Përgjigja e saj është e prerë:

“Kultura e vendit asnjëherë nuk duhet të përdoret si arsye për të drejtën morale. Ka vlera të caktuara të cilat nuk janë për t’u diskutuar. Pabarazia gjinore shpeshherë arsyetohet me tradita, fe, apo lloje të caktuara të strukturave sociale. Njëkohësisht do të ishte naive të mendoje se të drejta universale të caktuara, siç është gjinia, mund të zbatohen pa i marrë parasysh zakonet e vendit. Këtu hyjnë strategjitë, avokimet dhe instrumentet e tjera. Të punosh për barazinë gjinore nuk ka të bëjë me pse, por me si”.

Agata shumë shpejt do të largohet

nga Misioni, në pritje të një të ardhme të ndritshme. Rruga që e pret Agata Szymanska pritet t’i sjellë sfida të reja të cilat me buzëqeshje po i përfaqojnë e lumtur.



## Femrat në uniformë të kaltër e bëjnë ndryshimin

Ruajtja e vendit të kimit dhe mbledhja e provave forenzike, qofshin ato gjurmë gishtërinjsh apo gjurmë këpuce, një pjesë floku apo ndonjë fije tjetër, mund të janë vendimtare nëse një kriminel do të shpëtojë apo do të gjykohet për atë vepër. Njihuni me Nënkolonel Florie Hajra, Drejtoreshë e Drejtorisë së Hetimeve Forenzike në Policinë e Kosovës (PK), e cila kujdeset që vendi i kimit dhe hollësitë e imta, të cilat mund të jenë të rëndësishme për hetimin e ndonjë rasti, të analizohen dhe të mblidhen si duhet nga ana e ekipeve, të cilat i menaxhon ajo.

Nënkolonel Florie Hajra e ka filluar karrierën e saj në forcën policore para shtatëmbëdhjetë viteve, kur kishte vendosur ta ndiqte ëndrrën fëmijërore të saj. Ajo thekson se përkundër faktit se situata e përgjithshme në Kosovë ia pamundësoi asaj që të shkonte në akademinë policore, ajo kishte konkurruar për t'u bërë pjesë e Policisë së Kosovës "sapo e kuptoi se ata kishin filluar me rekrutimet".

Floria është lindur dhe rritur në Mitrovicë, ku ka studiuar për Teknologjinë Informatike, edhe pse dëshira e saj për t'u bërë pjesë e policisë nuk u harrua asnjëherë. Dashurinë e saj për policinë e kishte ushqyer edhe më shumë babai i saj, i cili gjithashtu ishte polic. "Të rritesh pranë një babai, i cili e donte dhe e respektonte

me shumë pasion punën e tij, më bëri edhe mua të dashurohem në atë punë," thotë Floria.

Florie Hajra ka diplomuar në gjeneratën e dytë të Akademisë të Policisë së Kosovës. Rrugëtimi i saj profesional shtatëmbëdhjetëvjeçar në policinë e Kosovës ka nisur me patrullat policore në stacionin policor jugu në Mitrovicë, pastaj në Policinë e Komunitetit, më vonë në hetime dhe përfundimisht si Oficere e Forenzikës për Vendin e Kimit në kuadër të njësisë rajonale për hetime në Mitrovicë. "Unë e kam nisur punën në patrullat policore, patrullimet në këmbë dhe me automjete. Në atë kohë asgjë nuk dukej e lehtë, dhe vërtetë nuk ishte e lehtë", sqaron ajo, duke theksuar se femrat police është dashur të punojnë dy herë më shumë për ta dëshmuar veten, "por unë isha dhe vazhdoj të jem krenare që jam në mesin e atyre grave që i kanë thyer tabutë se ky profesion është vetëm për burra", sqaron Nënkolonel Hajra.

Qëndrueshmëria, vendosmëria dhe etika e punës së palodhshme drejt arritjes së qëllimeve, ishin forca shtytëse prapa suksesit të saj, për të arritur deri tek pozita drejtuese në kuadër të Policisë së Kosovës. "Unë kam filluar punën me gradën rreshter kurse tani, që një kohë të gjatë jam nënkolonel dhe Drejtoreshë e Drejtorisë për Hetime Forenzike në PK".

Drejtoria për Hetime Forenzike në Policinë e Kosovës është një zyrë e specializuar, e cila funksionon në kuadër të Divizionit për Hetimin e Krimeve. Detyrat e kësaj njësie janë kërkimi, gjetja, identifikimi, dokumentimi, mbledhja dhe ekspertiza e gjurmëve të krimit të gjetura në vendin e ngjarjes. Po ashtu, Drejtoria e Forenzikës ofron shërbime tekniko-shkencore për Policinë e Kosovës, Institutin e Forenzikës, gjyqësorin dhe organizatat tjera ligjzbatuese të vendit dhe ato ndërkombëtare.

Floria e përshkruan punën e saj në Drejtorinë për Hetime Forenzike me shumë pasion, pasi që ajo konsideron se hetuesit e vendit të krimit e luajnë një rol shumë të rëndësishëm gjatë procesit të verifikimit, si dhe kush e ka kryer ndonjë krim, "puna e njëjësive që unë i drejtoj, është shumë e rëndësishme. Ne mbledhim copëza të vogla për ta ndërtuar rastin dhe kjo është sikur një mozaik, përderisa ne i gjejmë pjesët që mungojnë," thotë ajo.

Drejtoria të cilën ajo e udhëheq është shumë e pavarur. Floria është shumë mirënjohëse për bashkëpunimin dhe ndihmën e madhe të ofruar nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare si UNMIK, KFOR, OSCE, EULEX. "Dëshiroj që personalisht ta falënderoj EULEX-in për mbështetjen e vazhdueshme, qoftë kjo në formën e hetimeve të përbashkëta, ndërtimin e kapaciteteve, e veçanërisht në teknologjinë informative të forenzikës, apo në dhurimin e pajisjeve profesionale për departamentin tonë. Kjo ndihmë ka qenë jashtëzakonisht e rëndësishme për ne."

Nënkolonel Hajra njihet gjithashtu për punën e saj si anëtare e këshillit drejtues të Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës, SHGPK. Angazhimi i saj gjatë viteve të kaluara ka qenë promovimi i fuqizimit të grave që punojnë në Policinë

e Kosovës. "Gratë e kanë dëshmuar vlerën e tyre, nga pozitat administrative deri te ato operacionale." vlerëson ajo. SHGPK-ja është formuar në muajin nëntor 2013 me qëllim të fuqizimit të rolit të grave në Policinë e Kosovës. "Synimi ynë janë femrat e reja në Kosovë dhe ne mbajmë seminare të ndryshme në mbarë regjionin me komunitetet e ndryshme dhe aty përpiqemi të reflektojmë bashkë dhe i inkurajojmë ato që t'i bashkohen forcës policore dhe t'i thyejnë qëndrimet paragjyquese dhe stereotipike, në një rol që zakonisht është konsideruar si karrierë e dominuar nga burrat".

Përfshirja e Nënkoloneles në AGPK kryesisht ka qenë për t'i fuqizuar gratë në Polici dhe që barazinë gjinore ta bëjë pjesë përbërëse të suksesit të saj. "Me gjithë që Policia e Kosovës është e përkushtuar tërësisht për barazi gjinore, kjo forcë në përbërjen e saj ka më pak se 15% femra, prej të cilave 12% janë police që shërbejnë në funksione të ndryshme për zbatimin e ligjit. Po ashtu, nga to vetëm një numër i vogël janë në grada të larta; nëntë police mbajnë grada mbi atë të majorit dhe kjo tregon se ne i kemi arritur disa rezultate, por duhet të bëhet edhe shumë më shumë," sqaron ajo.

Florie Hajra është ajo që kurrë nuk pushon së mësuari. Ajo beson se njeriu gjithmonë mund të mësojë diçka të re dhe pastaj ta përmirësojë punën. Ajo tani është duke i vijuar studimet e magjistraturës për të drejtën ndërkombëtare pranë Universitetit të Prishtinës, ndërsa në kohën e saj të lirë mezi pret ta shijojë adrenalinën, që i sjell paraglajdimi (fluturimi me parashutë), pasi është edhe anëtare e Klubit të Paraglajdimit Trepça në Mitrovicë.



## Avokimi proaktiv për të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut: njihuni me Marianne Fennema

Ofrimi i këshillave juridike për çdo ditë EULEX-it lidhur me çështje të ndryshme, komplekse dhe mjaft të rëndësishme, është pjesë e një dite të zakonit të punës për Marianne Fennema.

Ajo është në krye të Zyrës për të Drejta të Njeriut dhe për Çështje Ligjore, ZDNJÇL, në Misionin Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë. Zyra përbëhet nga 13 pjesëtarë, të cilët ofrojnë njohuri thelbësore që nuk kanë të bëjnë vetëm me mbikëqyrjen, monitorimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut por, po ashtu, edhe me të siguruarit e respektimit të aspektit ligjor gjatë zbatimit të mandatit dhe të aktiviteteve të misionit.

Marianne është nga Holanda. Ajo i ka përfunduar studimet evropiane në Amsterdam dhe ka vazhduar studimet e magjistraturës në të drejtën ndërkombëtare në Angli. Ajo ka fituar titullin e avokates në Londër. Si studente në Universitetin e Amsterdamit, Marianne u bë anëtare themeluese e AEGEE, një organizatë studentore mbarë-evropiane e cila përqendrohet në fuqizimin e të rinjve në Evropë për të marrë rol aktiv në shoqëri. Ajo ka punuar për një periudhë kohore në selinë e kësaj organizate në Paris.

Zyra të cilën e drejton Marianne, është përgjegjëse që ta bëjë interpretimin ligjor të mandatit të misionit për udhëheqësit

e lartë dhe zyrat tjera të misionit, si edhe të sigurojë zbatimin e aspektit ligjor dhe marrjen parasysh të të gjitha ndryshimeve të mandatit të misionit.

Marianne u bë pjesë e misionit tri vjet më parë si pjesë e ZDNJÇL. Por kjo nuk ishte hera e parë që ajo punonte në Kosovë. Më parë ishte këtu duke punuar në Shtyllën e IV të UNMIK-ut dhe në Zyrën Civile Ndërkombëtare.

Kur erdhi në Kosovë në fillim të shtatorit 2004, ajo tashmë kishte pak përvojë në rajon deri sa ishte duke punuar me një kompani amerikane për media e cila shikonte mundësinë për themelimin e stacioneve televizive dhe të radios në Ballkan. Siç thekson Marianne, ajo erdhi në Kosovë dhe "pjesa tjetër dihet".

Marianne filloi karrierën e saj si avokate për të drejtat e korporatës në një avokaturë të madhe në Londër. Pas diplomimit, ajo e braktisi punën private për të punuar në industrinë e mediave. Deri sa i përfaqësonte investitorët amerikanë në media, ajo jetoi në Lubjanë dhe në Pragë. Pastaj u kthye përsëri në Londër, ku u punësua si juriste për Televizionin Walt Disney. "Kur fillova të punojë atje nuk isha në veçanti ndonjë adhuruese e Disney-it, por ishte vështirë të mos hutoheshe pas magjisë së Disney-t.", e pranon ajo.

Megjithatë, kur erdhi koha ta ndërrojë magjinë e Walt Disney për aktivitete më reale, ajo vendosi të kthehet përsëri në Kosovë, ku në cilësinë e saj aktuale si Udhëheqëse e ZDNJÇL, Marianne e këshillon misionin lidhur me gjërat thelbësore të sfidave të sundimit të ligjit dhe të qeverisjes.

ZDNJÇL po ashtu merret me mekanizmin e brendshëm të drejtësisë të misionit. Zyra ofron këshilla për Shefin e Misionit lidhur me çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut, si edhe harton parashtesa për Panelin Shqyrtues për të Drejta të Njeriut, i cili e mbikëqyr përgjegjësinë e jashtme të misionit. Por kjo nuk është e tërë puna e zyrës.

“Zyra jonë i ndihmon gjithë misionit, si divizionit për fuqizim ashtu edhe atij ekzekutiv, lidhur me përmirësimin e gjërave, në mënyrë që veprimet tona të jenë në pajtueshmëri të plotë me të drejtat ndërkombëtare të njeriut. Pajtueshmëria me të drejtat e njeriut duhet të respektohet në të gjitha detyrat tona” sqaron Marianne.

Një angazhim tjetër shumë i rëndësishëm i zyrës është ndihma juridike dhe interpretimi i ligjeve të hartuara nga Qeveria e Kosovës. Misioni, përmes monitoruesve dhe këshilluesve të tij dhe në ndërlidhje me ZDNJÇL, harton, bashkë-harton, këshillon dhe sugjeron ligje dhe ndryshime të ligjeve për legjislaturën e Kosovës. Deri më tani, Misioni ka lehtësuar mbi 150 ligje, udhëzime administrative dhe rregullore. Vëmendje e posaçme po ashtu ju kushtohet ligjeve të cilat kanë të bëjnë me mandatin e misionit.

Marianne ngul këmbë që të gjitha këto detyra nga fusha të ndryshme operative të misionit kërkojnë angazhim të plotë

të gjithë zyrës. Puna në ekip është me rëndësi thelbësore për suksesin e ZDNJÇL. “Shumë punë duhet të delegohet, por natyrisht unë duhet ta këshillojë personelin në veçanti kur është fjala për çështjet e ndryshme. Kështu që, rutina ime ditore ndryshon kryesisht me shkuarjen në mbledhje, përgjigjet në postën elektronike, mbikëqyrjen e gjërave që i përgatit personeli im si edhe shikimin e produkteve për t’u siguruar që japim këshilla të mira” thekson ajo.

Sipas Mariannes, sfida më e madhe për Kosovën është ndryshimi i mentalitetit të njerëzve dhe që kosovarët ta kuptojnë, që nëse secili kontribuon në mënyrën e vet mund të arrihet një mundësi më e mirë për të ardhmen e Kosovës.

Duke ju përmbajtur filozofisë së saj, Marianne është po ashtu duke kontribuar në ndryshimin e Kosovës në cilësinë e saj personale si vullnetare për organizatën bamirëse, Care for Kosovo Kids. Kjo OJQ ofron barëra për pacientët e rinj në repartin e hematologjisë – onkologjisë të Spitalit Universitar në Prishtinë. Kjo organizatë bamirëse është krijuar para dy vjetëve nga një afariste holandeze, të cilën Marianne e ka takuar rastësisht në aeroplan duke u kthyer në Amsterdam. Gruaja mori vesh për gjendjen e vështirë të fëmijëve të Kosovës, të cilët janë pacientë që vuajnë nga kanceri dhe prindërit e të cilëve nuk kishin mundësi t’i paguanin barërat. Përmes një bordi këshillëdhënës me ndikim në Holandë, mblidhen fonde për t’iu ndihmuar fëmijëve që kanë nevojë. Organizata bamirëse është shumë aktive në ofrimin e kujdesit për pacientët dhe e dobishme për mbështetjen e vazhdueshme të fëmijëve të Kosovës që vuajnë nga kanceri.

Në jetën private, Mariannes i pëlqen ta kalojë kohën me vajzën e saj 10 vjeçare Isabelle, e cila e vijon një shkollë ndërkombëtare në Prishtinë. Fundjavave ato kryesisht dalin të ecin në Rugovë dhe në Brod, duke u kënaqur me natyrën e bukur të Kosovës, me njerëzit dhe me traditat lokale. Marianne përfundon me krenari: “Unë jam idhulli i Isabelles. Asaj i pëlqen ajo që bëj unë. Në veçanti kur është fjala për avokimin e të drejtave të njeriut”.



## Nga Parlamenti Evropian në Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit

Alina Matache ka qenë e përfshirë në punën e Bashkimit Evropian që në ditët e para si studente, çka e bënë këtë një prej arsyeve kryesore pse ajo i ndjekë vlerat e BE-së me buzëqeshje, përkushtim, dhe entuziazëm.

Në vazhdimësi të përvojës së saj, gushtin e kaluar Alina vazhdoi tutje duke iu bashkuar Divizionit të Fuqizimit brenda Misionit të BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë.

Pozita e saj si asistente speciale e Udhëheqësit dhe Zëvendësudhëheqësit të Divizionit të Fuqizimit përfshinë kryerjen e një varg detyrash, por në esencë përfshinë Kryerjen e Punëve. Tani.

Menaxhmenti i Divizionit dhe Alina bëjnë bashkërendimin e procesit të udhëheqjes së veprimeve të parapara me Planin për Implementimin e Misionit për Divizionin e Fuqizimit. Veprimet e parapara në PIM kryhen sipas metodologjisë së menaxhimit të projektit, ku në çdo PIM theksohen aktivitetet, rezultatet e pritura, dhe indikatorët e verifikueshëm në mënyrë objektive. Detyra kryesore e Alinas është monitorimi dhe vlerësimi i të dalave nga çdo projekt i njësishëm, analizimi, dhe dhënia e komenteve tek menaxhmenti i Divizionit sa i përket objektivave të përmbushura në kuadër të mandatit të përgjithshëm të Misionit.

Sipas Alinas, puna në Mision kërkon zotësi për bashkëpunim me palë të ndryshme, përfshirë zhvillimin dhe ruajtjen e qasjes për partneritet.

“Gjithmonë përpiqem të buzëqesh, të dëgjoj dhe negocioj, dhe aty ku nevojitet të jem bindëse, posaçërisht kur më duhet të ndërtojë ura mes departamenteve të ndryshme. Për shembull, secila njësi e Divizionit për Fuqizim i ka prioritetet e veta nga fusha të ndryshme që i mbulojnë, siç janë çështjet e policisë, kufirit, drejtësisë, shërbimit korrektues, dhe çështjet e brendshme. Andaj, ndërlidhja e të gjitha këtyre kontributeve është thelbësore për përmbushjen e synimeve të Divizionit të Fuqizimit”, thotë Alina.

Ajo ka studiuar në Itali për shkencë politike, e ka përfunduar programin Erasmus në Francë dhe mori diplomë nga studimet Masters në fushën e studimeve evropiane në Bruksel. “Fakti se jam lindur dhe rritur në Rumani, jam arsimuar në Itali dhe e kam filluar karrierën time evropiane në Bruksel thjeshtë më bënë të ndihem evropiane”, thekson ajo.

Gjatë studimeve në Itali ajo është angazhuar me një numër OJQ-sh, sindikata, dhe parti politike me qëllim mbrojtjen e të drejtave të studentëve të huajë dhe të punëtorëve migrantë. E etur dhe ambicioze edhe gjatë studimeve, ajo

po ashtu ka punuar në vende të ndryshme në mënyrë që t'i mbulojë shpenzimet e veta.

Praktika në Parlamentin Evropian ishte pikë fillimi për karrierën e Alinas. Ajo përvojë ka bërë që ajo të punësohet në Parlamentin Evropian, ku ka punuar me ish-ministrin e mbrojtjes së Rumanisë. Ajo përvojë i ka ndihmuar në thellimin e njohurive në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, në veçanti në lidhje me misionet e Politikës së Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje (PPSM).

“Çdo Mision i PPSM duhet të raportojë rreth aktiviteteve që i zhvillon tek Parlamenti Evropian - Nënkomisioni për siguri dhe mbrojtje. Dhe aty fillova të mësoj rreth Kosovës, përmes kontributit për hartimin e amandamenteve për raportet vjetore”, shpjegon Alina.

Pastaj ajo vendosi që t'i vijoj disa kurse në Kolegjin Evropian për Siguri dhe Mbrojtje (ESDC). “I jam shumë mirënjohëse ekipit të ESDC dhe aftësimit të tyre profesional për Misionet e PPSM, dhe jam edhe më e lumtur që mund ta jap kontributin tim tani kur mund t'i zbatojë njohuritë e mia këtu në Kosovë”.

Alina erdhi në Kosovë për herë të parë pasi që filloi punën në EULEX. Megjithatë, meqë është e familjarizuar me traditat dhe jetesën në Ballkan, ajo është përshtatur shumë lehtë me jetën në Kosovë.

Në fakt, kur ishte duke jetuar në Itali, ajo kishte lidhur miqësi me një familje nga Kosova, andaj dinte shumë gjëra për Kosovën edhe para se të vinte këtu. “Familja ime imigroi në Itali në vitin 1995 dhe atëherë në lagje ishim e vetmja familje rumune me një familje nga Kosova”, kujton ajo.

Që prej se ka ardhur, Alina ka lidhur shumë miqësi. Ajo kalon shumë kohë të lirë me ta, duke udhëtuar dhe zbuluar vende të reja në mbarë Kosovën.

Ajo po ashtu është shumë aktive në sport dhe tani ka filluar rrugëtimin edhe në ‘CrossFit’ të cilin po e pëlqen shumë, pasi që ajo gjithmonë është e gatshme të sprovohet me sfida të reja.



## E pasionuar për sundimin e ligjit

Llogaridhënia, përgjegjësia dhe vendosmëria për të punuar, janë tiparet e jashtëzakonshme të Shkelqesa Ibrahimit, e cila punon për Prokurorinë Speciale të Kosovës si këshilltare për ekipin e prokurorëve ndërkombëtarë dhe vendës të cilët merren me raste të profilit të lartë. Shkelqesa kishte filluar punën në këtë mision shtatë vite më parë, duke ofruar këshilla ligjore për çështjet e ndryshme dhe të ndërlikuara nga e drejta materiale dhe procedurale. Ajo është e angazhuar vazhdimisht në punët e prokurorisë, si në rishikimin e provave, mbledhjen e informacionit paraprak për rastet dhe personat, si dhe ofrimin e këshillave ligjore për çështjet të cilat kërkojnë ekspertizë vendëse mbi juridiksionin.

Angazhimi i saj si staf lokal në një fushë të ndjeshme të punës që kërkon profesionalizëm, vendosmëri dhe integritet nuk është punë e lehtë. Znj. Ibrahimit duke i pasur të gjitha këto aftësi, i kryen detyrat e saja ditore, kurse informacioni i ndjeshëm mbetet gjithmonë vetëm në zyrë.

Kosova është një vend shumë i vogël ku zakonisht njerëzit mund ta njohin njëri-tjetrin ose janë disi të lidhur, mirëpo znj. Ibrahimit kurrë nuk ka hasur në ndonjë sfidë gjatë kryerjes së detyrave të saj. Ajo është shumë e vetëdijshme për natyrën e ndjeshme që ka puna e saj, ndaj edhe është shumë e kujdesshme.

“Puna që bëj unë mbetet në zyrë dhe gjithçka që ka të bëjë me punën time përfundon në momentin kur dal nga zyra ime” thotë Shkelqesa.

E pasionuar për sundimin e ligjit dhe duke besuar se vetëm sundimi i ligjit mund të krijojë një themel të fuqishëm për një shtet funksional, Shkelqesa i është përkushtuar edhe studimeve të saj për shumë vite. Aktualisht ajo është duke vazhduar me zhvillimin e vet profesional dhe është kandidate për doktoratë në fakultetin juridik në Prishtinë. Ajo është e vendosur se avokimi për sundimin e ligjit është elementi më i rëndësishëm i një shoqërie. Në jetën e përditshme, ajo mundohet të përkrahë drejtësinë përmes sjelljes së saj dhe vepron si shembull për ngritjen e besimit të publikut në institucionet e sundimit të ligjit.

Puna e saj ditore si këshilltare ligjore përfshinë punën në raste penale shumë të rëndësishme dhe çështje ligjore jashtëzakonisht të ndërlikuara. Ofrimi i këshillave ligjore për prokurorë është detyrë me përgjegjësi të madhe, mirëpo Shkelqesa është e sigurt dhe e çmon lart bashkëpunimin e saj me prokurorët.

Para se të fillonte punën në EULEX, Shkelqesa kishte punuar si këshilltare ligjore për misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Detyra e saj ishte që



të ofronte këshilla ligjore dhe informacion paraprak për zgjidhjen e kontesteve pronësore. Rastet pronësore ishin dhe vazhdojnë të jenë çështje shumë delikate në shoqërinë e pasluftës në Kosovë. Përmes ndërmjetësimit dhe negociatave ajo e ka ndihmuar Drejtorinë për Çështje Pronësore-Banesore të Kombeve të Bashkuara në zgjidhjen e shumë kontesteve pronësore në Kosovë.

Veç kësaj, puna e saj profesionale ka përfshirë edhe procesin e emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë. Ajo ka ndihmuar në vlerësimin e biografive gjatë procesit të emërimit dhe riemërimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve të ndryshëm. Ky ishte një proces shumë i gjatë dhe sfidues për Kosovën, i cili Shkelqesën e pasuroi me një eksperiencë të fushave të ndryshme, duke përfshirë komunitetet dhe përkatësitë etnike të ndryshme.

Përgjatë karrierës së saj, Shkelqesa ka punuar në fusha të ndryshme të sundimit të ligjit, ndërsa ekspertiza e saj është një aset i vlefshëm për procesin e ndërtimit të institucioneve të drejtësisë në Kosovë.

Me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, Kosova tani i ka institucionet e veta të drejtësisë, të cilat ende janë të brishta, por me ndihmën nga ekspertiza ndërkombëtare, e ardhmja duket të jetë e ndritshme. Shkelqesa thekson se e çmon punën e prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Ata vijnë me përvoja nga juridiksionet e ndryshme, ndërsa përpjekja e tyre për vendosjen e drejtësisë vlerësohet lart.

Ajo është nënë e dy fëmijëve me të cilët kalon shumicën e kohës së lirë. Nuk është e lehtë të jesh një nënë me orar të plotë të punës, thotë Shkelqesa, meqë ajo shumë herë ndjehet fajtoare që nuk ka

mundësi t'u plotësojë nevojat fëmijëve të saj. Megjithatë, ajo thekson se zgjidhja drejt gjetjes së harmonisë mes punës dhe detyrave prindërore është planifikimi dhe fokusimi në planin e bërë.

Ajo preferon që çdo minutë të kohës së lirë ta kalojë me fëmijët e saj. Duke qenë se fëmijët e saj janë duke u rritur, ajo gjen frymëzim që çdo ditë të kontribuojë për sistemin e drejtësisë së vendit të saj dhe kështu të krijojë një të ardhme më të mirë për të gjithë fëmijët e Kosovës sepse sipas saj këta fëmijë e meritojnë më të mirën.



## Silke Sielaff – Nuk keni nevojë të kërkonte leje

Ju prezantojmë Silke Sielaff, zyrtare policore nga Gjermania dhe shefe e Zyrës për Operacione të Përbashkëta në EULEX (ZOP), detyra e së cilës është bashkërendimi, informimi dhe kujdesi për të gjithë punonjësit e EULEX-it kudo qofshin ata nëpër Kosovë. Personaliteti i qasshëm dhe i ngrohtë, i shoqëruar me përkushtim dhe profesionalizëm për punën e saj bëjnë që ajo të jetë pasuri kyçe për këtë mision.

Silke e filloi karrierën në polici në vitin 1995 në Brandenburg të Gjermanisë, pas diplomimit nga fakulteti juridik i Universitetit të Heidelbergut. Punën në polici ajo e kishte dëshiruar që nga një moshë shumë e re. “Të them të vërtetën, ajo ishte ëndërr e fëmijërisë, kur ishte diku dhjetëvjeçare thash se doja të bëhesha police”. Në Gjermani është rast i rrallë që juristët t’i bashkohen policisë, megjithatë Silke arriti që të sigurojë një avancim ‘të shpejtë’ me ndihmën e përgatitjes akademike, dhe menjëherë iu bashkua policisë në nivel të lartë, ku punonte për shërbimet qendrore për policinë shtetërore të Brandenburgut.

Ajo shpjegon se arsyeja e ardhjes në Kosovë ishte që të ndante përvojën e saj të punës në një shtet në tranzicion – pasi që policisë iu bashkua në fillim të viteve të nëntëdhjeta në Gjermaninë Lindore, ajo e di se si punohet në një shoqëri

që është duke kaluar nëpër zhvillime dhe reformime. “Unë kam njohuri rreth procesit, dhe mund të theksoj se njerëzit janë duke kaluar nëpër një fazë tranzitore, kështu që mendova se do të ishte gjë interesante që kjo përvojë të sillej në Kosovë dhe që unë të bëhem pjesë shumë e vogël e ndryshimeve në këtë shtet.”

Ndër përshtypjet e saj të para nga Kosova, përveç komunikacionit rrugor kaotik, ishte se njerëzit në Kosovë janë shumë ndryshe nga gjermanët, janë shumë më të hapur, dhe të gatshëm të flasin me njerëzit nga shtetet e huaja, “edhe nëse nuk e flasin gjuhën, nuk e kanë problem të komunikojnë meqë njerëzit këtu janë shumë të hapur dhe të ngrohtë; ndoshta sepse unë jam gjermane!”

Suksesi i saj më i madh deri më tani ishte funksionalizimi i ZOP si pjesë përbërëse e Misionit EULEX. Në vitin 2014, kjo zyrë ishte departament i sapoformuar me qëllimin që të shërbente si qendër kryesore e informatave për të gjithë punonjësit e EULEX-it. “ZOP është formuar pasi që u kuptua se në mision ishte e nevojshme të ekzistonte vetëm një qendër e informatave.”

ZOP ka tri funksione. Shërben si qendër kryesore e informatave dhe nga aty shpërndahen informatat e nevojshme të klasifikuara apo të ndjeshme dhe

informata nga burime të hapura tek departamentet përkatëse; nga aty monitorohen dhe kontrollohen të gjitha komunikimet me radio mes punonjësve gjatë kryerjes së detyrave të përditshme dhe nëpër operacione ku EULEX-i e zbaton mandatin ekzekutiv; dhe në fund ajo zyrë është përgjegjëse për përcjelljen e lëvizjeve të të gjithë punonjësve të EULEX-it në pjesën veriore të Kosovës si dhe, në rast se ata punonjës kanë nevojë për ndihmë, atëherë kjo zyrë dërgon ndihmë. Kjo zyrë funksionon pandërprerë, me orar 24/7, dhe me 32 punonjësit e saj ajo është në dispozicion kurdo që është e nevojshme.

Silke e shpjegon se si ZOP funksionon si bashkërendues kryesor i të gjitha njërive të EULEX-it gjatë operacioneve apo në rastet kur EULEX-i thirret si reagues i dytë me kërkesë të Policisë së Kosovës, i grumbullon të gjitha këto informata dhe i raporton në Bruksel. ZOP siguron që të gjithë të përfshirët të jenë në dijeni të zhvillimeve. “Ne po ashtu e informojmë KFOR-in, si reagues i tretë, në mënyrë që ata t’i kenë informatat që edhe ne i kemi në rast nevojë për ta”. Silke ka për detyrë që të sigurojë procedura të duhura në mënyrë që punonjësit e zyrës së saj të jenë në gjendje të reagojnë sa më parë që është e mundur në rast të ndonjë emergjence apo operacioni të madh.

Duke qenë femër me karrierë të gjatë në fushën e sundimit të ligjit, Silke shpjegoi se çka duhet të bëjnë femrat e reja që dëshirojnë të ndjekin karrierë të ngjashme. “Pikë së pari, thjeshtë provojeni. Ju do të punoni në një ambient me shumë kolegë meshkuj, por keni besim tek vetvetja, besojuni ndjenjave tuaja, dhe edhe nëse hasni në zhgënjime në karrierë, mos ndaloni, këmbëngulni dhe do të jeni të suksesshme, ju nuk jeni inferiore

kundrejt kolegëve tuaj meshkuj” për këtë arsye Silke beson se është shumë e rëndësishme femrat të jenë të angazhuara në role të larta, meqë ato mund të ofrojnë perspektivë tjetër, mënyrë të re të të menduarit, diçka që ajo personalisht e ka vërtetuar gjatë kohës së saj si zyrtare policore e lartë.

Me rastin e prezantimeve të drejtpërdrejta para femrave të Kosovës, Silke këshillon që femrat këtu duhet të mundohen të largohen nga rolet tradicionale patriarkale, ku barazia gjinore, përpos në vendet e punës, duhet të ekzistojë edhe në familje, “femrat nuk duhet të kufizohen në vetëm një rol, ju mund të jeni nëna me karrierë dhe nuk duhet që për ju të zgjedhë mashkulli i familjes; bëjeni atë që juve ju bën personalisht të lumtur, nuk keni nevojë të kërkonit leje”. Ajo pohon se kur Kosova ta bëjë këtë ndryshim, atëherë do të jetë në rrugë drejt shoqërisë bashkëkohore evropiane.



## Gruaja në uniformë që sjell ndryshime

Njihuni me gruan nismëtare e cila i komandon policët dhe e gëzon respektin e tyre. Kolonele Taibe Canolli është gruaja e parë nga Kosova e cila e mbanë gradën më të lartë në polici. Ajo është inspirim për gjeneratat e kosovareve të reja të cilat përpiqen të arrijnë barazi më të madhe në institucionet e Kosovës për sundimin e ligjit.

Kolonelja Canolli njihet mirë po ashtu për punën e saj si anëtare themeluese e Shoqatës së Grave në Policinë e Kosovës. Puna e saj gjatë dy viteve të fundit ka qenë promovimi i fuqizimit të grave të cilat punojnë në Policinë e Kosovës.

Që në moshë shumë të re ajo kishte ambicie për t'iu bashkuar policisë. "Të jem e sinqertë, gjithmonë kam pasur dëshirë të bëjë karrierë në polici, por për shkak të rrethanave të asaj kohe kjo ishte e pamundur" thotë ajo.

Sipas Canollit, gjendja politike kur ajo ishte e re e bindi atë që ëndrra e saj nuk do të realizohej kurrë. Sidoqoftë, ajo u përqëndrua në fushën e drejtësisë, duke studiuar drejtësinë dhe diplomoi më 1998 pak para luftës. Megjithatë ambicia e saj për të studiuar për diplomën e masterit u pezullua. Prapë se prapë, ëndrra e fëmijërisë u kthye përsëri në rrugën e duhur kur u themelua Policia e Kosovës pas konfliktit në Kosovë.

"Dëshira ime u kthye në punë në këtë fushë, meqë i kisha kualifikimet që do të më bënin person më të gjithanshëm për të kontribuar në sundimin e ligjit. Posa u hapën mundësitë për konkurrim, unë konkurova dhe iu bashkova akademisë policore si gjenerata e tretë e policisë në Kosovë".

Pjesa më interesante e karrierës së saj në polici ishte pozita e saj unike si grua dhe udhëheqëse që nga fillimi.

"Isha femra e parë që e komandoja një stacion të policisë; në veçanti këtë në qendër të Prishtinës i cili konsiderohet si stacioni më i madh i policisë në Kosovë".

Pozita e Kolonelit në Policinë e Kosovës është pozita më e lartë të cilën mund ta arrijë një polic, "Fakti që jam grua dhe Kolonele në polici është ndjenjë unike, është privilegj meqë është pozitë që nuk ju jepet shumë femrave", thotë ajo.

Ajo sqaron që pas suksesit të saj qëndron puna e madhe, ambicia dhe mbështetja nga familja dhe miqtë.

Si grua në një pozitë të tillë, njeriu pyetet si ia del mbanë ajo në jetën personale, duke e pasur parasysh karrierën, të qenit nënë, bashkëshorte dhe Kolonele, duket që është një gjë goxha e vështirë.

"Përpiqem ta ndajë punën nga jeta personale aq sa është e mundur dhe të kalojë sa më shumë kohë që mundem

me djalën tim, me partnerin, por natyrisht që ka ndërhyrje,” vë në pah ajo. Sidoqoftë, ajo thekson që çelës për të manovruar me karrierën dhe familjen e saj është menaxhimi i kujdesshëm i kohës dhe mbështetja e familjes që janë thelbësore për t’ia mundësuar asaj të përqendrohet në punën e saj dhe t’i kryejë detyrat sa më mirë që të jetë e mundur.

Përfshirja e Koloneles në Shoqatën e Grave në Policinë e Kosovës (SHGPK) ka qenë në radhë të parë për t’i fuqizuar gratë në polici dhe për ta bërë ekuilibrin gjinor një pjesë përbërëse të suksesit të saj. “Gratë e kanë treguar vlerën e tyre, nga pozitat administrative deri te ato operacionale.” pohon ajo. SHGPK është formuar në nëntor 2013 me qëllimin që ta bëjë fuqizimin e rolit të gruas në Policinë e Kosovës, “Kemi dashur të sigurohemi që kandidatet i kanë të gjitha cilësitë e duhura profesionale për punë dhe ta rrisim imazhin dhe reputacionin e grave në Polici dhe t’i mënjanojmë qëndrimet paragjyqese dhe stereotipike për një rol që në mënyrë tipike konsiderohet si karrierë në të cilën mbizotërojnë meshkujt”.

Pas vetëm dy viteve, një shoqatë e cila filloi me një numër shumë të vogël të anëtarëve tani ka rreth 600 anëtarë meshkuj dhe femra nga të gjitha përkatësitë etnike me bazë ligjore në politikën e policisë, e cila punon për t’i fuqizuar gratë në forcën policore. “Strategjia jonë Operative bazohet në një dokument, i cili e tregon programin tonë tre-vjeçar të cilin e shfrytëzojmë si bazë për punën dhe zhvillimin tonë të vazhdueshëm, i cili do ta mundësojë përfshirjen më të madhe të grave në këtë institucion. Them me mburrje që pas dy viteve i kemi arritur 90% të objektivave tona fillestare të cilat i kemi caktuar si organizatë”.

SHGPK nuk është përqendruar vetëm në përmirësimin e barazisë gjinore në policinë

e Kosovës por i ka vënë vetes qëllime edhe më të larta, “Mund të them që shoqata jonë është e vetmja e llojit të tillë në Evropën Juglindore, e cila gjë nuk është e mirë vetëm për Kosovën por edhe për sigurinë rajonale sepse modelin dhe ekspertizën tonë mund ta marrin vendet e tjera të rajonit,” sqaron Canolli.

SHGPK ka marrë mbështetje ndërkombëtare, nga OJQ-të ndërkombëtare siç është UN Women, Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave si edhe nga shumë organizata të vendit dhe ndërkombëtare. Deri më tani SHGPK i ka trajnuar mbi 380 gra në programe të ndryshme trajnimi. SHGPK ishte partneri kryesor për zbatimin e projektit të përbashkët ndërminstros “Gratë në uniformë”, i cili kishte synim shtimin e profilit të femrave që janë të angazhuara në kuadër të agjencive për zbatimin e ligjit në sektorin e sigurisë në Kosovë.

“Po ashtu, ne kemi marrë përkrahje dhe kemi bashkëpunim shumë të mirë me Misionin e OSBE-së në Kosovë, Ambasadën Norvegjeze, Ambasadën Amerikane dhe disa zyra tjera të huaja në Kosovë; Platformën e OJQ-ve CIVIKOS, Komisionin Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë të Kosovës, Grupin Parlamentar të Grave në Kuvendin e Kosovës, dhe bashkë me ta ne punojmë që ta çojmë përpara agjendën e grave.”

Puna e tyre ka edhe përmasa rajonale; duke i inspiruar vendet rajonale siç janë Shqipëria dhe Maqedonia që të përpiqen dhe të zbatojnë projekte të ngjashme. Aktualisht, numri i grave që punojnë në pozita të ndryshme në forcën e policisë së Kosovës është rreth 14 për qind. Sipas Koloneles Canolli, planet e saj janë edhe më ambicioze. “Ne kemi për qëllim ta rrisim

numrin e tyre në të ardhmen e afërt. Gratë janë treguar shumë efektive në këtë rol dhe kjo tashmë ka ndihmuar në përmirësimin dhe rritjen e reputacionit dhe të imazhit të Policisë së Kosovës në përgjithësi.

SHGPK ka pasur bashkëpunim të suksesshëm me EULEX-in thotë ajo, “Kemi pasur mbështetje lidhur me krijimin e dokumenteve të nevojshme, zbatime të ndryshme strategjike. Kemi përfituar nga trajnimi dhe këshillat lidhur me veprimet e duhura lidhur me krijimin dhe efikasitetin e Shoqatës”, thekson ajo.

Për këtë arsye, Kolonelja në veçanti i është mirënjohëse EULEX-it. “Dua ta falënderoj EULEX-in personalisht për mbështetjen e tyre, të cilën ia kanë dhënë Policisë së Kosovës dhe shoqërisë sonë. Që nga fillimi i misionit EULEX ne kemi punuar ngushtë së bashku. Partneriteti ynë është i shëndoshë dhe do të vazhdojë”.

Si përfundim, porosia e Koloneles për gratë që punojnë në forcën policore është: “Jini të përkushtuara në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë tuaja, kërkoni të drejtat tuaja, zhvillimin profesional dhe avancimin tuaj. Në përgjithësi, në të ardhmen kjo do të pasqyrohet në fuqizimin e rolit tuaj dhe të imazhit të organizatës”.



## Katrin Gluic – Është në interesin e çdo kujt që të luftohet krimi i organizuar dhe korrupsioni

Kur ishte vajzë e vogël në Kroaci, njerëzit shpesh e pyesnin se çfarë do të bëhet kur të rritej. Fare pa u hamendur, ajo do të përgjigjej: “Unë dua të bëhem police”, dhe kështu ajo e ndoqi ëndrrën e saj të fëmijërisë. Katrin është nga Kroacia, ku edhe kishte diplomuar në Akademinë Policore, duke përfunduar edhe studimet master atje. Aktualisht, ajo është duke i vazhduar studimet post-diplomike në Shkencën e Kriminalistikës, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Zagrebit.

“Gjithmonë është mirë të investosh në dituri. Njeriu është mirë të zgjerojë horizontet e veta për të zotëruar fushat e reja të ekspertizës dhe për të kuptuar se si zhvillohen gjërat. Në mënyrë specifike, një njohuri e hollësishme e ligjit të procedurës penale ndihmon në hetimin e rasteve të ndryshme”, shton ajo.

Kur filloi punën, patrullimi policor ishte një prej detyrave të saja. Prej aty, ajo vazhdoi me hetimet penale në sektorin e policisë. Sa për të përmendur, ajo ishte marrë me raste të vrasjeve, me shkelësit e mitur, dhe raste të dhunës në familje. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ajo ishte angazhuar në aktivitetet për integritet evropian dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, duke përfshirë negociatat për anëtarësim në BE dhe përputhjen me acquis communautaire.

“Kroacia sapo do t’i bashkohej BE-së, dhe kjo ishte faza e detyrave tona të integritet evropian. Përveç kësaj, unë kam qenë edhe pjesëtare e Njësisë për Krim të organizuar, që funksiononte në kuadër të Policisë së Shtetit për Shtypjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e ngarkuar për të hetuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, në nivel të vendit dhe atë ndërkombëtar.

Katrin Gluic tani është hetuese për krime të rënda në Njësinë për Hetimin e Krimin të Organizuar në EULEX. Detyrat kryesore të kësaj njësie janë hetimi i krimin të organizuar dhe nivelit të lartë të korrupsionit. Në këtë ekip, Katrin merret me hetimin e të gjitha aspekteve të krimin të organizuar, duke përfshirë korrupsionin, keqpërdorimin e pozitës zyrtare, drogat e palejueshme, armët, etj.

“Puna në vendin tim është e ngjashme me punën që e bëj këtu në Kosovë. Procedura penale është e ngjashme me atë të Kroacisë, dhe kjo më ndihmon shumë”, thekson ajo.

Aktualisht, rreth 40 hetues nga Njësia për Hetimin e Krimin të Organizuar të cilët punojnë ngushtë me kolegët nga Policia e Kosovës janë të angazhuar në hetimin e krimeve të rënda. Për shumicën e këtyre

rasteve zhvillohen hetime të përbashkëta. Këto hetime përbëhen prej një ekipi i hetuesve nga PK-ja dhe EULEX-i, të cilët shkëmbejnë informacion dhe punojnë bashkë nën udhëheqjen e Prokurorit nga PSRK-ja.

“Është shumë e rëndësishme që ne të udhëhiqemi nga prokurori, veçanërisht kur është fjala për mbledhjen e provave për të mbështetur hetimet penale. Ne bashkë me prokurorët e krijojmë një ekip të mirë, dhe kjo na bën të lumtur dhe krenar veçanërisht kur në media shohim storjet për një aktakuzë ose vendim gjyqësor për një rast të përbashkët”, thotë Katrin.

EULEX-i dhe Policia e Kosovës kanë punuar bashkë në disa raste të arrestimeve të të dyshuarve për krim të organizuar të profilit të lartë për vrasje, korrupsion, trafikim të drogave. Disa prej këtyre rasteve ishin po ashtu edhe të natyrës ndërkombëtare, duke përfshirë disa arrestime të njëkohshme nëpër Evropë. Sipas Katrin, EULEX-i është duke bërë përpjekje të mëdha në punën e vet. “Kur në veçanti bëhet fjalë për hetimet, një mbështetje e pandashme nga institucionet vendëse të sundimit të ligjit është e një rëndësie shumë të lartë”, thotë ajo, duke theksuar se luftimi i krimit të organizuar dhe i korrupsionit është në interes të çdo kujt.

Katrin është e bindur se nga puna e EULEX-it dhe e institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë do të përfitojnë gjeneratat e ardhshme në Kosovë. “Nganjëherë, ka kritika se procesi është shumë i ngadalshëm. Mirëpo, unë besoj se ne po përjetojmë një proces gradual dhe shumë pozitiv ku zyrtarët e EULEX-it po i demonstrojnë praktikat më të mira evropiane. Ata po ndihmojnë

në përshtatjen e institucioneve të Kosovës, fuqizimin dhe trimërimin e gjyqtarëve dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit. Ne shpresojmë se do të lëmë një trashëgimi pozitive e cila do t’u mundësoj institucioneve vendëse që të vazhdojnë përpara me besim dhe transparencë,” përfundon ajo.



## Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë – njihuni me Heidi Lempiö

Të drejtat e njeriut janë element esencial i zhvillimit të sistemit ligjor bashkëkohor. Ato po ashtu kanë qenë temë lidhëse e karrierës së Heidi Lempiö në fushën e drejtësisë.

Avokatja nga Finlanda, Heidi Lempiö, punon si zyrtare ligjore në Zyrën për të drejtat e njeriut dhe çështje ligjore pranë EULEX-it, ku puna e saj ka të bëjë me shqyrtimin e çështjeve të ndryshme ligjore që ndërlidhen me punën e Misionit. Përvoja e Heidit në fushën juridike është e shumëllojshme. Pas diplomimit nga fakulteti juridik i Universitetit të Helsinkit, Heidi mbajti një trajnim katërmëdhjetë mujor për gjykatëse në qytetën Mikkeli në pjesën lindore të Finlandës. Detyra e saj e radhës ishte zëvendësimi i një këshilltari ligjor ushtarak në komandën e ushtrisë së Finlandës. Përvojën në departamentin ligjor të ushtrisë, Heidi e pa si diçka të mrekullueshme: “Departamenti ligjor i komandës së ushtrisë merrej me një varg të gjerë të çështjeve juridike.

Aty përfshihej çdo gjë, nga e drejta mjedisore deri te parimet e së drejtës ndërkombëtare humanitare, kontratat komerciale, rastet disiplinore dhe penale ushtarake, si dhe komentime të projektligjeve dhe mbajtje të trajnimeve ligjore për ushtarët.” Asaj i pëlqeu puna

në ushtri dhe rrjedhimisht ushtroi detyra të ngjashme për Komandën e Forcave Ajrore të Finlandës dhe Selinë e Rojave Kufitare.

Heidit gjithnjë i ka pëlqyer të punojë jashtë vendit, dhe i duket vetja paksa si nomade. Ajo ka jetuar në disa shtete të ndryshme, si në Republikën Dominikane, në Francë, Spanjë, dhe flet rrjedhshëm gjuhën finlandeze, angleze, spanjishte, dhe gjuhën frënge. Por, Heidit nuk i pëlqen të udhëtojë vetëm sa për të parë vende të reja. Për të ka rëndësi që të qëndrojë aq gjatë sa për të njohur vërtetë vendin dhe kulturën e tij.

Në vitin 2011, Heidi u punësua si ndihmëse finlandeze e avokatit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. “Shkuarja në Strasburg për të punuar në gjykatë ishte si një ëndërr e realizuar, meqë unë gjithnjë kam qenë në veçanti e interesuar për të drejtën ndërkombëtare si dhe atë evropiane, dhe posaçërisht për të drejtat e njeriut.” Të drejtat e njeriut kanë luajtur rol të rëndësishëm në karrierën e Heidit që nga fillimi, ku për temën e studimeve të magistraturës, ajo ka shtjelluar Rregulloret e BE-së për azilin në kontekstin e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.



Përqendrimi i Heidit në të drejtat e njeriut rrjedh nga interesimi i saj i kahershëm në çështjet sociale dhe zhvillimin ndërkombëtar. Ajo ka një bindje të fortë për mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve më të dobët të shoqërisë. Gjatë studimeve dhe karrierës së saj në fushën e drejtësisë, këto brenga janë rafinuar në përvojë profesionale për zbatimin e të drejtave të njeriut në praktikë.

Përvoja e Heidit në ushtri dhe në punë që ndërlidhet me të drejtat e njeriut e kanë shpjerë atë në EULEX. Heidi erdhi në Kosovë në shkurt të vitit 2014 pa pasur shumë njohuri rreth vendit, por me një motivim të fuqishëm për të mësuar dhe për t'i kontribuar zhvillimit të sundimit të ligjit në Kosovë.

Puna e shumëllojshme e Heidit në EULEX kryesisht përbëhet prej dhënies së këshillave rreth çështjeve ligjore. "Ne merremi mellojetëndryshmetë çështjeve ligjore që ndërlidhen me mandatin tonë, statusin tonë ligjor, praktikat më të mira evropiane, të drejtat e njeriut, privilegjet dhe imunitetet e punonjësve, kodin e sjelljes, dhe procedurat disiplinore."

Sipas Heidit, një prej kushteve themelore për zhvillimin e një sistemi funksional të sundimit të ligjit është që institucionet shtetërore përgjegjëse t'i respektojnë standardet e të drejtave të njeriut në punën e tyre të përditshme. Ato standarde janë relevante si për cilësinë e ligjeve, ashtu edhe për zbatimin e ligjeve. Kjo anë më praktike e ndarjes së drejtësisë është vendi ku Heidi është e dalluar. "Më duhet të them se më mirë qëndroj me çështjet juridike praktike se sa me konceptet abstrakte, siç është hartimi i ligjeve."

Në lidhje me situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, Heidi është optimiste. Megjithatë, ajo thekson se ende mbeten shumë punë për t'u bërë, në veçanti tek funksionimi themelor i sistemit juridik. Sipas saj, ai sistem juridik që i kryen detyrat e veta me efikasitet dhe paanshmëri është baza themelore e të drejtave të njeriut. Të drejtat e femrave dhe pakicave, është fushë tjetër ku Heidi sheh hapësirë për përmirësim. "Zhvillimi është i ngadalshëm, dhe me siguri se nevojitet një ndërrim gjenerate, por ka hapa pozitiv të vegjël. Për shembull, mund ta përmend përqendrimin e kohëve të fundit që i është dedikuar dhunës seksuale që ka ndodhur gjatë konfliktit, dhe dënimet që mund të rezultojnë."

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për zhvillimin e të drejtave të njeriut është arsimimi. Heidi merr pjesë në aktivitetet monitoruese, mentoruese dhe këshilluese të divizionit të EULEX-it për fuqizim, përmes mentorimit të dy zyrtarëve ligjorë të Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor të Kosovës, dhe mbajtjes së trajnimeve për ta. Përvojat e Heidit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg janë tejet të çmueshme në detyrat e saj mentoruese, meqë ato i ndihmojnë të kuptojë se si duhet të merren parasysh standardet për të drejtat e njeriut në aspektin e punës juridike.

Në përgjithësi, jeta në Kosovë ka qenë interesante për Heidin, dhe ajo ka patur përvoja pozitive si dhe negative. Ajo është ndjerë e mirëpritur nga vendasit, dhe e çmon lart miqësinë e tyre. Në anën negative, Heidi e përmend ndotjen dhe mbeturinat – çka e neveritin atë

si dashamirëse e natyrës. Kur Heidi vendos që të kalojë në sfida të tjera, ajo kryesisht i merr kujtimet e mira me vete. "Kujtimet e njerëzve të dashur që i kam takuar, peizazhet e bukura që i kam parë, ushqimet e shijshme që i kam shijuar, por edhe pamjet qesharake, si ato të lopëve gjersa kullotnin afër selisë së EULEX-it, veturat e parkuara në rreth-rrotullime, apo shitësit e perimeve që e bllokojnë rrugën me një mal me lakra – këto pamje janë aq unike dhe karakteristike dhe kujtime të këndshme nga Kosova!"



## Punojmë së bashku për të arritur rezultate – Njihuni me Barbora Kacikova

Një pjesë e konsiderueshme e punës së EULEX-it ka të bëjë me lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet njerëzve që merren me zbatimin e ligjit dhe që kanë prejardhje të ndryshme kombëtare dhe kulturore. Barbora Kacikova, një police sllovaqe, tashmë ka fituar shumë përvojë në këtë fushë përkundër moshës së re.

Barbora vjen nga një qytet i vogël në veriperëndim të Sllovakisë. Pas përfundimit të studimeve të magjistraturës në fushën e hetimeve, ajo iu bashkua policisë sllovaqe për të punuar si police për inteligjencë kriminale. Më vonë iu kthye fushës akademike dhe në fund përfundoi studimet e doktoratës në zbatimin e ligjit. Në një fazë më të vonshme, ajo filloi të punojë në selinë e policisë kufitare në Sllovaki.

Barbora gjithmonë është përpjekur të punojë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, në veçanti ndërmjet shteteve anëtare të BE-së. Vendimi për të specializuar në policimin kufitar ishte zgjedhje e kuptueshme për të. “Nëse punoni në policinë kufitare është absolutisht e domosdoshme që të bashkëpunoni sepse në BE jemi të lirë të lëvizim pa pasur nevojë të kalojmë nëpër kontrolle kufitare në kufijtë e brendshëm; ne i zbatojmë kontrollet kufitare vetëm në

kufijtë e jashtëm Schengen. Ne të gjithë i respektojmë standardet e njëjta dhe i plotësojmë disa kushte të përbashkëta.” Katër vjet radhazi Barbora punoi me Agjencinë Frontex (Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian) dhe e kuptoi plotësisht bashkërendimin ndërkombëtar që nevojitet për ruajtjen e menaxhimit kufitar në zonën Schengen. “Unë kam bashkëpunuar me shumë kolegë nga mbarë Evropa dhe vërtetë jam kënaqur gjatë asaj kohe,” e kujton Barbora përvojën që e ka përgatitur atë për rolin e saj në EULEX.

Barbora arriti në Kosovë më 2013 për t’u bërë pjesë e njësisë së EULEX-it për Monitorim, Mentorim dhe Këshillim (MMK). Roli i saj në MMK ishte me Policinë Kufitare të Kosovës dhe me Doganën në katër pikë kalimet e përbashkëta lindore me Serbinë. Të punuarit në kufij i ofroi asaj një ndjenjë të realitetit lidhur me atë që ndodhte në terren. Barbora sqaron se është detyrë e zyrtarëve të MMK-së në kufi që të veprojnë së bashku me të gjitha palët përkatëse, përfshirë policinë serbe dhe zyrtarët doganorë. Kjo ua mundëson atyre ta kenë një pasqyrë të qartë të gjendjes në nivel operacional. “Ju e lehtësoni bashkëpunimin ndërmjet

palëve përgjegjëse dhe i këshilloni homologët vendas në përputhje me rrethanat. Duhet të jeni proaktiv dhe të keni shkathtësi shumë të mira për bisedime.” Pa kompetenca ekzekutive, detyra e Barboras dallon nga detyra e saj e mëparshme meqë puna e saj në kufijtë e Kosovës para së gjithash përqendrohet në lehtësimin e bashkëpunimit. “Ky është misioni im i parë. Unë e konsideroj mandatin e misionit si një mozaik. Puna e secilit përbën një pjesë të tij; nevojitet bashkëpunim maksimal për ta realizuar misionin. Prandaj është shumë me rëndësi të jesh bashkëpunues.”

Në rrafshin personal, Barbora e pranon që e posedon anën aventuriere. Dëshira për ta përjetuar botën nga dora e parë duket të jetë motivi shtytës prapa shumë prej përpjekjeve të saj. Për shembull, të bërit police dhe përfundimisht të punuarit për misionin në Kosovë. Barbora gjithmonë ka qenë e interesuar për Ballkanin dhe në veçanti marrëdhëniet ndërmjet vendeve të Ballkanit pas konfliktit. “Kam dashur ta shoh dhe ndjejë realitetin e Kosovës, si është jeta e zakonshme dhe si janë prekur njerëzit nga situata politike. Përveç kësaj, kam dashur të di si ndikon një situatë e tillë në zbatimin e ligjit dhe në menaxhimin e kufirit kur të dy palët e shikojnë pikë kalimin e njëjtë në mënyra të ndryshme— për njërin anë është kufi ndërsa për tjetrën është kufi administrativ. Ishte mundësi e shkëlqyeshme ta përjetoj punën në fushën e menaxhimit të kufirit përtej kufijve të jashtëm Schengen ku fillojnë tregimet e emigrantëve. Përcjellja e lajmeve ose leximi i analizave të rrezikut të bëra nga policia kufitare gjithmonë ua ofron një këndvështrim të caktuar por më mirë kuptohen gjërat duke qenë vetë aty.”

Më 2014, kur numri i pjesëtarëve të njësisë së Barboras u zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme, ajo u gradua në pozitën e udhëheqëses së ekipit. Pozita e re i solli Barboras sfida të reja dhe e mësoi shumë për punën me njerëz të ndryshëm në një mjedis shumë kulturor. “Më duket sfiduese por po ashtu edhe interesante të punoj me një spektër aq të gjerë të njerëzve. Duhet kohë për ta kuptuar njëri tjetrin, por jam e lumtur që kam mundësinë të jem udhëheqëse e ekipit këtu. Po ta kryeja këtë detyrë në shtëpi, do të ishin vetëm bashkëvendësit e mi.”

Të qenit femër e re poashtu i ka shkaktuar Barboras më shumë sfida si udhëheqëse e ekipit. “Ishte një hap i madh që të kaloj në pozitë udhëheqëse meqë jam njëra nga pjesëtarët më të rinj në moshë të njësisë sonë. Natyrisht unë i respektoj kolegët më të vjetër, jo vetëm për shkak të moshës së tyre, por edhe për shkak të viteve të tyre të përvojës. Duhet t’i respektoj ata, por edhe ata duhet të më respektojnë mua. Nuk mundeni gjithmonë t’i kënaqni të gjithë, por jam përpjekur që gjithmonë të jem sa më e drejtë që është e mundur dhe t’i bëjë njerëzit të ndihen rehat dhe të motivuar në punë.” Sipas Barboras, në këtë aspekt vendosmëria është vendimtare për një udhëheqës. “Duhet ta keni mentalitetin e duhur. Keni përgjegjësi të caktuara. Moshë dhe gjinia juaj nuk kanë rëndësi, duhet të jeni i vendosur dhe pastaj çdo gjë ecë.”

Përkundër faktit që puna e saj përbëhet kryesisht prej detyrave menaxhuese, Barbora herë pas here punon në terren meqë ajo është ende anëtare aktive e njësisë lëvizëse për terren. Kjo ia mundëson Barboras t’i bazojë vendimet e saj ekzekutive në përvojën nga dora e parë. Njëra prej temave në të cilat

ajo përqendrohet është përfshirja e aspektit gjinor dhe ajo kujdeset që aktivitetet e Monitorimit, Mentorimit dhe Këshillimit (MMK) të njësisë së saj ta marrin gjithmonë parasysh perspektivën gjinore. Sipas mendimit të Barboras është poashtu e rëndësishme që të udhëheqet me shembull. “Është mirë që kemi numër të mjaftueshëm të femrave në njësinë tonë, në veçanti në nivel operativ. Është shumë me rëndësi që ta na shohë edhe popullsia vendase dhe jo vetëm policët. Disa vendas më kanë thënë që kur i kanë parë femrat që punojnë në pozitat tona e kanë kuptuar që femrat mund të punojnë në pozita të rëndësishme në polici. Ne po dëshmojmë që kjo është e mundur.”

Përveç risive në detyrat e saj të punës, ardhja në Kosovë ishte poashtu një ndryshim i madh personal për Barboran. Ishte hera e parë që po jetonte në një vend të huaj. “Ishte një përvojë e paharrueshme jetësore e cila ka ndikuar si në jetën time profesionale ashtu edhe në atë private.” Në fillim, Barbora mendonte se të jetuarit jashtë vendit ishte sfidë, meqë çdo gjë ishte e re dhe ndryshe nga jeta që kishte pasur deri tani. Ishte poashtu vështirë për miqtë dhe familjen e saj ta kuptonin jetën në Kosovë – ata ishin të brengosur në fillim. Por përkundër këtyre vështirësive fillestare, Barbora është përshtatur mirë në fund. “Jam mësuar me këtë. Tani Kosova është si shtëpia ime e dytë.”



## Puna e policit e lidhur ngushtë me komunitetin – Njiheni Maria van der Hart

Shoqërimi dhe të qenit pjesë e komunitetit janë tipare thelbësore të punës si police për Maria van der Hart. Puna në EULEX i ka ofruar asaj mundësi të mirë për ta zbatuar këtë parim në praktikë.

Maria, një kapitene në policinë e Holandës, ka më shumë se 30 vite përvojë në fushën e zbatimit të ligjit. Gjatë karrierës së saj të gjatë, ajo ka përjetuar aspekte të ndryshme të punës si police, duke filluar nga patrullimi në komunitet e deri te hetimi i krimit të organizuar ndërkombëtar. Përveç punës aktuale, në tri vitet e fundit, Maria është duke punuar edhe në hetimet e aspektit financiar të aktivitetit kriminal. Së fundmi, në bashkëpunim me departamentin e drejtësisë në Holandë, ajo e ka themeluar një ekip i cili ka në fokus përcjelljen e gjurmëve të parave të fituara nga aktiviteti kriminal me qëllim të zhvillimit sa më efektiv të hetimeve penale dhe mbledhjes së provave kundër personave të akuzuar.

Pas një periudhe kohore si udhëheqëse e ekipit për hetime ndërkombëtare në njësinë e krimit të organizuar, Maria mendoi se ishte koha për sfida të reja. “Unë gjithmonë kam dashur të shkoj në ndonjë mision, mirëpo për këtë duhet të përgatitesh duke pasur parasysh jetën personale dhe punën. Duhet të jetë një moment kur i thua vetes: Tani do të shkoj!”

Maria ka një përvojë të gjatë në Ballkan; ajo ka kaluar pushimet këtu që kur ishte trembëdhjetë vjeçare. Ajo po ashtu e ka vizituar Bosnjën gjatë misioneve të saja të punës, gjë që edhe ia rriti interesimin për të qenë pjesë e një misioni në Ballkan. Vizita e parë e Marias në Kosovë ishte kur ajo e filloi punën si këshilltare mobile e policisë së EULEX-it, në sektorin për fuqizim, në tetor 2014. Ajo fillimisht punoi në Gjilan për nëntë muaj e pastaj vazhdoi punën në Prishtinë.

Si këshilltare mobile, Maria bashkëpunon me homologët e saj në Policinë e Kosovës për tema të ndryshme. Përvoja e saj është dëshmuar pozitive. “Policia e Kosovës është një organizatë profesionale dhe si çdo organizatë tjetër ajo vjen duke u rritur nëpër vite. E njëjta është edhe në vendin tim.” Marias i pëlqen Kosova shumë. “Njerëzit këtu janë shumë të hapur dhe miqësor.” Ajo i çmon mundësitë e panumërta që Kosova i ofron për argëtim gjatë kohës së lirë si, bjeshkataria dhe mundësitë për të parë vendin dhe për të eksploruar kulturën kosovare.

Që nga fillimi, Maria në punën e saj është fokusuar edhe në çështjet gjinore. Ajo shumë shpejt u njoh me Asociacionin e Grave në Policinë e Kosovës. Maria ka punuar ngushtë me anëtarët e asociacionit dhe ka pasur mirëkuptim për çështjet e tyre duke i kujtuar vështirësitë

me të cilat janë ballafaquar gratë në organizatën e policisë kur ishte në Holandë. “Është me rëndësi që të ketë më shumë gra në pozita vendimmarrëse në Policinë e Kosovës. Ky është edhe fokusi im gjatë punës që e kam me to.”

Maria është pikë kontaktuese për çështje gjinore në njësinë e saj, që do të thotë se ajo është personi përgjegjës për përfshirjen e aspektit gjinor. Maria thekson se si përfshirja e aspektit gjinor nuk ka të bëjë vetëm me të drejtat e grave por me barazinë në përgjithësi. “Për të pasur një organizatë të mirë dhe të shëndetshme policore nevojiten edhe burrat edhe gratë. E njëjta vlen edhe për moshën. Ju duhet të keni një kombinim të njerëzve. Këtë e mësoni kur të keni përfunduar trajnimin për udhëheqësi. Do të keni njerëz të ndryshëm dhe karaktere të ndryshme. Ju duhet të keni edhe njerëz të cilët janë paksa kritik dhe jo që gjithmonë dinë të thonë ‘po’ për gjithçka.” Lidhur me çështjet gjinore, Maria ka punuar në fushën e dhunës në familje. Së bashku me Nicole Brassil, një eksperte për çështje gjinore, ajo e ka përpiluar dhe shkruar një raport të hollësishëm për dhunën në familje i cili e bën vlerësimin e gjendjes aktuale dhe jep rekomandime për institucionet ligjore në Kosovë. Maria veçanërisht e ka theksuar bashkëpunimin efikas me Policinë e Kosovës dhe gjyqësorin në formulimin e rekomandimeve të cilat janë nxjerrë në raport. EULEX-i poashtu e ka mbajtur një punëtori dy ditore “Përgjigja e policisë dhe e prokurorëve ndaj rasteve të dhunës në familje në Kosovë” në të cilën Maria dhe Nicole e kanë paraqitur raportin e tyre. Punëtorinë e kishte hapur shefi i Misionit, z. Gabriele Meucci, ndërsa i pranishëm ishte edhe Zëvendësministri i Drejtësisë, z. Lirak Çelaj, i cili e përshëndeti këtë projekt dhe e theksoi

rëndësinë që ka. Për Marian, janë mu këto raste të cilat e bëjnë atë që ta dojë punën e saj. “Kjo është diçka që unë dua të arrij: Të bëj hapa të vegjël për të ndihmuar në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe krimeve tjera të ngjashme.”

Marias duket se i pëlqen puna me njerëz. Ajo shpesh e thekson se sa i rëndësishëm është për të shoqërimi dhe komunikimi. “Është e rëndësishme të flasësh me njerëzit dhe të jesh pjesë e bashkësisë, të flasësh për problemet e tyre, dhe të zbulosh gjërat që i motivojnë ata.” Kjo duket qartazi në punën e saj si police. “Në fund, të gjithë e duan të njëjtën gjë – të kenë një bashkësi. Ju doni ta mbronin dhe t’i shërbenin bashkësisë suaj. Kjo nuk është një punë me orar të rregullt prej orës nëntë deri në pesë.”

Një shembull i punës në komunitet për të cilin Maria flet me ëndje është pjesëmarrja e saj në punën e organizuar nga një OJQ me seli në Pejë e quajtur “Hands of Mercy”. Ajo me entuziazëm e përshkruan punën e “Hands of Mercy” dhe se si kjo OJQ e mbështetë edukimin dhe shkollimin e fëmijëve dhe si përkujdeset për personat që kanë nevojë për ndihmë. E frymëzuar nga puna e tyre, Maria dhe komuniteti i holandezëve i kanë mbështetur projektet e ndryshme të “Hands of Mercy”. Bie fjala, ata kanë dhënë si donacion çanta shkollore për fëmijët që kanë nevojë për ndihmë. Mundësia për të marrë pjesë në këto projekte të rëndësishme sociale është arsyeja kryesore që Marias i jep kënaqësi të punojë në Kosovë.

Në misionin e EULEX, Maria çmon më së shumti mbështetjen që ka nga kolegët që janë prej shteteve dhe profesioneve të ndryshme. “Njeriu duhet të ketë fat për të pasur një ekip si ky. Të gjithë i ndihmojnë njëri tjetrit. Është një punë vërtetë ekipore. Gjëja më e mirë është të punosh

në një ekip me pjesëtarë të etnive të ndryshme dhe ku mësojnë prej njëri tjetrit, por edhe t’i gjenden njëri tjetrit kur është e nevojshme.” Poashtu, është edhe aspekti i punës ekipore i cili i ka mësuar Marias mësimet më të vlefshme gjatë qëndrimit në Kosovë. “Kam mësuar se mund të punoj në çfarëdo vendi. Ju mund të arrini hapa të vegjël nëse jeni të hapur dhe nëse keni vullnet që me të vërtetë të komunikoni me njerëzit dhe homologët tuaj. Ju duhet të keni respekt dhe besim për të arritur qëllimet e synuara. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me ju, sepse kontributi i të gjithëve formon një tërësi.”



## Grua revolucionare - Njihuni me Valdete Dakën

Vendosmëria, profesionalizmi, sinqeriteti, zelli, guximi dhe puna e madhe janë virtyte që e bëjnë të mirë një gjyqtar. Valdete Daka i ka të gjitha këto, madje edhe më shumë se kaq.

Ajo është personalitet i shquar në Kosovë, jo vetëm që është në mesin e grave nismëtare, e cila ka marrë rolin e gjyqtare në sistemin e drejtësisë së Kosovës, por poashtu edhe për arsye se është njëra prej femrave të para që udhëheq një agjenci të pavarur në Kosovë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Disa ndoshta e njohin atë edhe si anëtare të dikurshme të Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës dhe si trajnuese të rregullt të Institutit Gjyqësor të Kosovës në fushën penale dhe në atë të drejtave të njeriut. Ajo po ashtu i trajnon kandidatët për t'u bërë gjyqtarë dhe kjo ndodhë pasi që ata ta kenë përfunduar me sukses provimin e jurisprudencës. Gjyqtarja Daka është po ashtu anëtare e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe ish-anëtare e Komisionit të Pavarur për Zgjedhjen dhe Emërimin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve.

Grua në të pesëdhjetat, energjike dhe e shoqërueshme, e cila ka bartur shumë funksione të rëndësishme, ka qenë gjithmonë e vendosur ta marrë një rol në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Kjo

vendosmëri dhe dashuria për ligj është ushqyer nga i ati i saj, i cili ishte profesor i njohur i drejtësisë në Kosovë. "Meqë jam rritur në një familje të pasionuar pas ligjit dhe isha dëshmitare e këtij pasioni për drejtësinë çdo ditë, ishte e natyrshme ta zgjidhja ligjin si profesion timin," sqaron Daka, e cila ka diplomuar në drejtësi në Universitetin e Prishtinës.

Prigëtimi i saj filloi kur u emërua gjyqtare në Gjykatën Komunale në Prizren në fushën e të drejtës penale, kur ishte vetëm njëzet e pesë vjeçare. "Të qenit në mesin e grave të para gjyqtare në fushën penale ishte shumë shpërblyese por njëkohësisht ishte shumë e vështirë," sqaron Daka.

Ndarja e drejtësisë si gjyqtare penale në shumicën e rasteve nënkupton që duhet të përballeni me kriminelë të profilit të lartë, që kryejnë krime të rënda, por kjo nuk e ndali Dakën që të shquhet në rolin e saj në moshë shumë të re. "Si gjyqtare penale, në shumicën e rasteve i privoni kriminelët nga liria dhe ka pasur raste kur më është kërcënuar jeta mua dhe familjes time dhe është dashur të jetojmë nën mbrojtjen e policisë," sqaron gjyqtarja Daka.

Megjithatë, pasioni për ndarje të drejtësisë, përkushtimi dhe puna e madhe, ishin forca e saj shtytëse që gjithmonë të përpiqet t'i arrijë majat në profesionin e drejtësisë. "Gjithmonë kam dashur të jem pjesë e

zhvillimit të drejtësisë në Kosovë dhe besoj që kam luajtur rol të rëndësishëm në krijimin e shtetit dhe të institucioneve të drejtësisë. Kjo më bën të ndihem shumë krenarë,” thotë Daka.

Në një profesion ku mbizotërojnë meshkujt, gratë duhet të jenë shumë të vendosura për të luftuar për pozitat vendimmarrëse. “Pozita e grave është përmirësuar shumë prej kohës kur jam emëruar për herë të parë si gjyqtare penale në Prizren, por ende mbetet shumë për t’u bërë,” thotë ajo. Sipas saj, gratë janë më të fuqishme, më të guximshme dhe më pak të prira për të rënë nën ndikim dhe prandaj duhet të trajtohen si të tilla.

Sipas Valdetes, përkundër sfidave të shumta, sistemi i drejtësisë në Kosovë aktualisht është shumë më i mirë se ka qenë më parë. “Janë arritur reforma dhe ndryshime të rëndësishme në ligje, është bërë shumë. Prapë se prapë, duhet të bëhet edhe më shumë. Domethënë, gjenerata e re e profesionistëve duhet të jetë shumë e vendosur,” thotë Valdetja.

Ajo ka një porosi për gjeneratën e re, e cila ngadalë po e zëvendëson gjeneratën e vjetër në sistemin e drejtësisë, që të jetë më e vendosur dhe më e përqendruar: “Kurrë mos u dorëzoni, kërkoni më tepër dhe ofroni më të mirën për t’u dalluar në profesionet tuaja.”

Gjatë karrierës së saj të pasur profesionale, ajo ka punuar përkrah profesionistëve të drejtësisë nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare që punojnë në Kosovë. “Kam marrë pjesë në panele të ndryshme, në grupe të ndryshme punuese dhe në trajnime. Bashkëpunimi me profesionistët ndërkombëtarë të drejtësisë ka qenë gjithmonë shumë i mirë dhe ka qenë mundësi e shkëlqyeshme për të mësuar nga njëri tjetri” sqaron Daka.

Planet e Dakës për të ardhmen janë që të vazhdojë të punojë në sistemin e drejtësisë të Kosovës për të mirë të qytetarëve të Kosovës.

Ajo thotë që po t’i duhej të zgjidhte ndërmjet pozitave që i ka momentalisht, drejtësia do të ishte fusha të cilën do ta zgjidhte çdo herë.

Si profesioniste dhe gjyqtare, Daka e simbolizon gruan e cila ka tejkalluar pengesa të mëdha dhe e ka trasuar rrugën që edhe gratë tjerat të bëjnë karrierë në fushën e drejtësisë.



## Ri-gjetja e Kosovës – njihuni me Njomza Miftarin

Njomza Miftarit i pëlqejnë sfidat. Për këtë arsye, puna si menaxhere e zyrës së kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it i përshtatet shumë.

Puna në mjedis shumë-kulturor siç është EULEX-i është shumë e natyrshme për Njomza Miftarin e lindur në Kosovë. Kur ishte tetë vjeçe Njomza u shpërngul në Toronto, Kanadë, në njërin prej qyteteve më të shumëllojshme në botë. Rritja në Toronton e përbërë nga shumë kultura e mësoiatëqëtëmosi marrparasyshdallimet kulturore dhe etnike duke kontribuar në masë të madhe në këndvështrimin e saj ndaj botës. Megjithatë, ishte trashëgimia e saj kosovare që në fund do ta diktonte rrugën e saj të ardhme drejt EULEX-it.

Pas diplomimit në Loyalist College në Belleville Ontario, Njomza filloi të punojë si analiste për lirim nga dogana në sektorin privat. Megjithatë, kjo nuk mjaftonte për Njomzën e cila kishte dëshirë të madhe të ndikojë në ndryshime. Gjatë kësaj kohe, filloi të interesohet më shumë që të mësojë për vendlindjen e saj, kështu që ajo aplikoi dhe u pranua për të studiuar për politikën publike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në Institutin për Teknologji të Rochester-it i lidhur me Universitetin Amerikan të Kosovës. “Erdha në Kosovë më 2010 për shumë arsye, doja ta ri-hulumtoja kulturën time dhe natyrisht vendin tim të lindjes. Ekziston një proverb shqiptar “Çdo njeri

ndërton fatin e vet” që do të thotë se secili e ndërton fatin e vet. Unë doja që pjesë e fatit tim të ishte kultura e pasur dhe mikpritja të cilën e ofron Kosova.”

Motiv shtytës për kthimin e Njomzës ishte edhe marrja e një roli aktiv në rindërtimin e vendlindjes së saj të sapolindur. “Qëllimi im ishte të mësoj më shumë për Kosovën dhe për rajonin, në veçanti gjatë kësaj kohe të rëndësishme të periudhës pas pavarësisë së Kosovës. Ndërsa të punoj këtu është me rëndësi për mua që të kontribuojë në zhvillimin e Kosovës madje edhe nëse nënkupton kontribut të vogël.” Siç i sheh gjërat ajo, Kosova ka përparuar shumë prej kohës së fëmijërisë së saj por ende mbetet shumë për t’u bërë: “Si fëmijë më kujtohet pak gjendja konkrete në Kosovë. Megjithatë, gjatë asaj kohe njerëzit kanë vuajtur shumë – ata nuk kanë mundur t’i realizojnë të drejtat e tyre thelbësore të njeriut. Tani njerëzit kanë liri por ende ka nevojë që të ketë zbatim më të madh dhe më efektiv të sundimit të ligjit dhe të drejtave të tyre në praktikë.”

Pas diplomimit dhe përfundimit të praktikës së shkurtë në Institutin Kosovar për Kërkim të Politikave dhe Zhvillim (KIPRED) Njomza filloi të punojë për EULEX-in. Detyra e saj e parë si procesmbajtëse ishte plot tension por ishte po ashtu shumë e vlefshme meqë ia ofroi asaj një pasqyrë të mirë të punës ligjore dhe të



sistemit ligjor vendas. Detyrat e saj si procesmbajtëse në gjykatë e përgatitën Njomzën të përparoi në pozitën e saj aktuale si menaxhere e zyrës së kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it. Në punën e saj aktuale Njomza kujdeset për funksionimin e duhur të zyrës dhe ajo ka shumë detyra. Menaxhimi i zyrës ka shumë përgjegjësi dhe herë pas here është shumë sfidues. Megjithatë, sfidat janë diçka që Njomza i kërkon në mënyrë aktive. "Përvoja ime me këtë mision ka qenë shumë dinamike. Mjedisi i misionit është krejt ndryshe nga sektori privat por kjo është një përparësi sepse jam gjithnjë e sfiduar dhe jashtë zonës sime të rehatisë. Në të njëjtën kohë po mësoj dhe po zhvillohem. Për mua, është magjepsëse t'i shohë ekspertët me përgatitje të ndryshme që punojnë së bashku me qëllim që t'i kontribuojnë drejtësisë së Kosovës. Është situatë ku të gjithë fitojnë meqë i këmbëjnë përvojat dhe po ashtu mësojnë nga njëri tjetri në shumë mënyra të ndryshme."

Sa i përket të ardhmes së sistemit juridik të Kosovës, Njomza mbetet optimiste. "Ka përparim substancial në sundimin e ligjit, megjithatë ka poashtu edhe shumë sfida me të cilat përballë sistemi i drejtësisë i Kosovës. Në lidhje me përparimin, gjatë 16 vjetëve të kaluara janë krijuar institucione që më parë nuk kanë ekzistuar. Me fjalë të tjera, sistemi është dashtë të nisë nga zeroja. Përparimi mund të shihet nga aspekte të ndryshme, duke filluar nga infrastruktura ligjore siç është aprovimi i ligjeve që janë në pajtueshmëri me standardet e të drejtave të njeriut, krijimi i kapaciteteve dhe i kushteve të punës."

Njomza shpreson shumë që të rinjtë e Kosovës do ta zhvillojnë sistemin juridik. Ajo punon me ta shpesh, në veçanti kur organizon simulime të gjykimeve për studentët e drejtësisë. Gjyqtarët e EULEX-

it i udhëheqin këto gjykime të cilat ofrojnë aftësim esencial praktik për studentët e drejtësisë arsimimi i të cilëve është më shumë teorik. Njomzës i pëlqejnë këto raste meqë është shumë shpërblyese t'i shohësh studentët nga mbarë Kosova të cilët përpiqen për qëllimin e njëjtë të përmirësimit të sistemit juridik në Kosovë. "Ende mbetet shumë hapësirë për përmirësim të mëtejshëm drejt gjyqësorit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm i cili iu shërben interesave më të mirë të njerëzve. Kosova ka një numër të madh të të rinjve që e mundëson një përshtatje më të lehtë ndaj praktikave dhe globalizimit."

Një aspekt specifik të cilin Njomza posaçërisht ka mësuar ta dojë është natyra e saj. Njomza ka pasion ecjen dhe në kohën e saj të lirë ajo shpesh kënaqet duke udhëtuar nëpër fshatra. Vendi i saj i parapëlqyer është Ujëvara e Mirushës që është një vend i mrekullueshëm për të ecur dhe për të notuar në ujëvarë. Ecja i ofron Njomzës pushim të merituar pas jetës së saj të ngarkuar në punë dhe po ashtu i jep asaj rast të ketë kontakt me format autentike të kulturës vendase. Njerëzit në fshat gjithmonë e mirëpresin Njomzën me duar të hapura dhe e befasojnë atë me mikpritjen e tyre. Është e qartë që Njomza është person i afërt. Kur e pyesin ku e ndjen veten më së shumti si në shtëpi, ajo përgjigjet që e ndjen veten si në shtëpi në vendin ku është familja e saj, e cila aktualisht gjendet në shumë vende.



## Njihuni me Lina Andeer

Të drejtat e grave janë më të rëndësishmet për të dhe ajo nuk mund ta kalojë një qen endacak në rrugë pa i ofruar ndihmë. Ajo është nga Suedia dhe është këshilltare e EULEX-it për çështje gjinore.

Udhëtimi i Linës me EULEX-in filloi disi simbolikisht më 9 mars, një ditë pas ditës ndërkombëtare të gruas – një ditë që ajo e konsideron veçanërisht të rëndësishme. Si këshilltare e sapoemëruar për çështje gjinore detyra e saj është t'i japë udhëheqjes së EULEX-it këshilla lidhur me çështjet gjinore përmes veprimeve të misionit, si brenda ashtu edhe jashtë. Roli i Linës është të sigurojë që çdo pjesëtar i ri i stafit të EULEX-it të njohet lidhur me kuptimin e perspektivës gjinore gjatë trajnimit fillestar të EULEX-it. Ajo po ashtu angazhohet për çështjet gjinore përmes bashkërendimit të personave kontaktues për çështje gjinore dhe ofrimit të mbështetjes për ta.

Lina ka kryer magjistraturën në shkencë politike duke u përqendruar në studimet e zhvillimit dhe të demokratizimit në Universitetin e Uppsala në Suedi. Deri sa ishte në studime, asaj i lindi interesimi në veçanti lidhur me të drejtat e njeriut dhe çështjet gjinore, një rrugë karriere të cilën vendosi ta ndjekë.

Pas studimeve, Lina ka punuar disa vite në një organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e cila i mbështeste organizatat vendase të shoqërisë civile në

luftën e tyre për të drejtat e njeriut dhe çështjet gjinore në shumë vende përreth botës. "Ne kemi punuar për t'ua mundësuar komuniteteve në vende të ndryshme të Indisë, Amerikës Latine dhe Afrikës qasjen në burime siç është toka, uji dhe burimet e tjera produktive. Ne jemi përqendruar posaçërisht në të drejtat e pakicave dhe të komuniteteve indigjene dhe natyrisht në të drejtat e grave, meqë shpesh ato janë më së shumti të prekura," kujton Lina. Lina gjithmonë e ka pranuar sfidën e të punuarit në një mjedis pas konfliktit. Fakti që ish-Jugosllavia gjendet aq afër Evropës Qendrore dhe Perëndimore, por për të cilën njerëzit dinë shumë pak, e ka inkurajuar atë ta pranojë mundësinë që të vijë në Kosovë. Ajo donte ta ndihmonte forcimin e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor dhe t'i mbështeste organizatat e grave, të cilat përballëshin me një mori problemesh.

Puna e saj si këshilltare gjinore në EULEX nuk është përvoja e saj e parë e punës në Kosovë. Lina ka punuar për Fondacionin Suedez 'Kvinnan till Kvinna' (Gratë për Gratë) katër vjet për t'i mbështetur gratë në vendet e prekura nga konflikti, për ta rritur fuqinë dhe ndikimin e grave. "Kam mësuar shumë duke punuar nga afër me gratë aktiviste në Kosovë dhe kam pasur mundësi të shohë që ato luajnë një rol të rëndësishëm në ndryshimin e qëndrimeve në shoqëri" thotë Lina.

Deri sa ishte në Kosovë, ajo kishte po ashtu rast të udhëtonte përreth rajonit dhe ta vlerësonte statusin e grave në Ballkan. Për fat të keq, pikërisht deri sa po thellohej në problemet e grave, asaj ju desh të kthehej në Suedi meqë përfundoi kontrata e saj me Fondacionin Suedez. Megjithatë, pasi që u dashurua në Kosovën, ajo ishte e vendosur të kthehej përsëri. "Natyrisht që ka shumë sfida, por ekziston po ashtu edhe një mjedis shumë pozitiv i punës ku keni rast të shihni ndryshime dhe përparim të vërtetë," shton Lina. Përvoja e saj e mëparshme në Kosovë ishte me rëndësi thelbësore për vendimin e saj që ta ndjekë pozitën e këshilltares ligjore në EULEX. Qëllimi i saj ishte që ta sillte ekspertizën që e kishte fituar tashmë duke punuar së bashku me gratë e Kosovës lidhur me çështjet siç është qasja e grave në drejtësi.

"Doja t'i ngrija çështjet gjinore brenda Misionit dhe të punojë në bashkëpunim të ngushtë me aktorët e tjerë, përfshirë shoqërinë civile vendase. Ne jemi këtu për popullsinë vendase. Meqë gratë përballen me shumë pengesa me të cilat burrat nuk përballen, ne duhet të jemi në dijeni lidhur me to. Nëse nuk i identifikojmë dhe nuk i njohim ato pengesa, ne nuk do të mbërrijmë tek gratë dhe prandaj do ta humbim gjysmën e popullsisë."

Linë i duket thelbësore që, kur është fjala për planifikimin e operacioneve të misionit, të merren parasysh çështjet gjinore. Për të është me rëndësi thelbësore të pranohet sa e rëndësishme është pjesëmarrja e grave kur është fjala për institucionet e sundimit të ligjit por gjithashtu në përgjithësi në pozitat vendimmarrëse. "Ekzistojnë disa shembuj të mirë të grave që kanë përparuar në pozita më të larta në Kosovë tani dhe e di që shumë gra janë aktive – nga aktivitetet e nivelit lokal deri te gratë në biznes dhe në politikë. Shpresoj që kjo tendencë do të vazhdojë. Megjithatë,

në të njëjtën kohë segmente të caktuara të shoqërisë ende jetojnë sipas traditave patriarkale në lidhje me rolin e burrave dhe të grave, e cila ndikon negativisht në lirinë dhe mundësitë e grave. Fatkeqësisht, dhuna kundër grave ende është shumë e përhapur dhe përkundër faktit që ligjërisht njihet si krim, shoqëria e pranon atë gjerësisht. Sipas mendimit të Linës duhet të ketë më shumë vetëdijësim lidhur me të drejtat e grave dhe dhunën kundër tyre në mbarë Kosovën. "E di që shumë aktorë, përfshirë organizatat e grave, janë duke i trajtuar këto çështje, madje duke i përfshirë edhe meshkujt në luftën kundër dhunës seksuale. Meshkujt duhet të flasin publikisht dhe t'i denoncojnë këto akte të dhunës, përndryshe do të jetë e vështirë të ndryshohet ajo," thekson Lina.

Lina thekson që prej kohës kur ka qenë këtu Kosova ka ndryshuar. Ajo i përmend barbarizmat e ushtruara ndaj grave të cilat janë dhunuar dhe abuzuar seksualisht gjatë luftës së vitit 1998-99. "Kur pata ardhur në Kosovë ishte pothuajse e pamundur të flasësh për këtë pasi që është temë shumë e ndjeshme. Të mbijetuarat i kishin përjetuar këto krime të luftës dhe ishin stigmatizuar në shoqëri. E di që organizatat e grave e ngrinin këtë si çështjen më të rëndësishme kur ishte fjala për drejtësinë tranzitore. "Marsin e kaluar, me një amendament ligjor u zgjerua përkufizimi i viktimave civile të luftës për t'i përfshirë po ashtu edhe viktimat e dhunimit dhe format e tjera të dhunës seksuale. Si rezultat, një person që ka përjetuar dhunë seksuale gjatë konfliktit tani ka të drejtë të ligjshme të marrë pension dhe përfitime. "Aktualisht janë duke punuar në hartimin e udhëzimit administrativ në mënyrë që të fillojë zbatimimi i ligjit. Ky është një rezultat shumë i mirë të cilin kam pasur rast ta vërej. Është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të shumë akterëve, përfshirë akterët ndërkombëtarë,

atyre vendas dhe jo më pak të organizatave të grave të cilat vazhdimisht e kanë ngritur këtë çështje vite me radhë. "Për ta bërë realitet këtë ndryshim, shumë akterë u bënë bashkë dhe i bashkërenduan përpjekjet e tyre për ta thyer tabunë dhe për t'ua ofruar të mbijetuarve njohjen që e meritojnë. Edhe EULEX-i ka kontribuar në këtë proces, në veçanti për t'i filluar hetimet lidhur me rastet e dhunës seksuale si krime të luftës."

Për Linën, si shtetase suedeze, gjendja lidhur me pabarazinë gjinore në Kosovë është krejt ndryshe prej asaj që ajo është mësuar dhe shpesh është frustruese. Meqë rolet gjinore janë çimentuar gjenerata me radhë, duhet kohë për të bërë ndryshime. Megjithatë, duke i ditur mundësitë ekzistuese, ajo e përqafton rolin e saj për të kontribuar në këtë ndryshim.

Jeta e Linës në Kosovë nuk ka të bëjë vetëm me luftën për të drejtat e grave dhe vetëdijësimin. Ajo i adhuron bukuritë natyrore të Kosovës. "Është vërtetë një pasuri dhe është potencial i madh për eko-turizëm po ashtu." Vetë Lina është shembull i përsosur meqë i kalon ditët e lira duke ecur në Malet e Sharrit dhe duke shkuar në ngjarje kulturore dhe në festivale. Lina po ashtu është përfshirë në disa nisma vullnetare për shpëtimin e qenve endacakë të cilat tashmë kanë pasur sukses. "Ishte një këlysh i cili ka shkuar prej lagjes sime në Kosovë deri në Holandë," kujton ajo dhe buzëqeshë.

Kontrata e Linës me EULEX-in do të përfundojë vitin që vjen por mund të vazhdohet. Lina ende nuk e din nëse do të qëndrojë në Kosovë, do të kthehet në Suedi apo do të shkojë diku tjetër. Kudo që e gjen veten, Lina do të mbetet e vendosur të luftojë për të drejtat e grave dhe çështjet gjinore.



## Violeta Demaj: Kosova fati i saj

E lindur dhe e rritur në Vjenë, Violeta Demaj kurrë nuk i ka harruar rrënjët e saj shqiptare. Në fund kjo e solli prapë në Kosovë, në vendlindjen e babait të saj.

Situata politike në ish-Jugosllavi e detyroi të atin e Violetës që të emigrojë nga Kosova në fund të viteve të gjashtëdhjeta. Si fëmijë ajo e vizitoi Kosovën herë pas here por nuk ka mundur ta marrë me mend që një ditë do të jetonte në Ballkan. Deri sa ishte duke u rritur, vizitat e saj u bënë më sporadike dhe më të rralla për shkak të tensioneve dhe të konfliktit por lidhja e saj e ngushtë me Kosovën mbahej gjallë meqë i ati i saj insistonte në edukimin dygjuhësh. "Prej kur kam ardhur këtu tetë vjet më parë shqipja ime është përmirësuar vazhdimisht" thekson Violeta.

Gjatë studimeve për drejtësi në Vjenë, Violeta filloi të interesohet për fushën e të drejtave të njeriut. Që nga atëherë ajo ka vendosur që karrierën e saj profesionale t'ia kushtojë kësaj çështjeje, duke e plotësuar kualifikimin e saj akademik me përvojë praktike. "Jam angazhuar në OJQ të ndryshme të vendosura në Vjenë. Me Amnesty International e kam monitoruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në disa vende. Derisa isha duke punuar për 'Helping Hands', ju kam ndihmuar azilkërkuesve," thotë ajo.

Deri sa merrej me azilkërkuesit në Austri, Violeta punoi me emigruesit kosovarë të

cilëve ju ishte refuzuar kërkesa për azil por të cilët nuk mund të riatdhesoheshin për shkak të ligjit austriak. Kjo ishte hera e parë kur ajo u njoh me Kosovën.

Ai ishte vetëm fillimi i njohjes së problemeve të Kosovës më në thellësi. Violeta vazhdoi me studimet e saj të doktoratës në Institutin për të Drejtat e Njeriut Ludwig Boltzmann në Vjenë. Nuk ishte rastësi që punimi i saj i diplomës ishte i përqendruar në statusin juridik të Kosovës në kuadër të rendit kushtetues të Jugosllavisë, në veçanti duke i pasur parasysh mospajtimet ndërmjet teorisë dhe zbatimit praktik.

Ajo sqaron që duke u bazuar në analizën e saj, ajo paraqiti rekomandime lidhur me atë se çka duhet të përfshijë statusi i Kosovës duke e pasur parasysh këndvështrimin e vullnetit dhe aspiratat e popullsisë vendase. Në ndërkohë situata politike ndryshoi dhe Kosova shpalli pavarësinë e saj më 2008. Për rrjedhojë ndryshoi edhe punimi i diplomës i Violetës për doktoratë. Kishte një moment kur Violeta mendonte që punimi i saj i diplomës nuk do të përfundonte kurrë si pasojë e realitetit që ndryshonte vazhdimisht. Megjithatë, ajo vazhdoi të punonte në të dhe ia doli ta përfundojë dhe ta publikojë atë.

Në mars të vitit 2007 ajo u kthye në Kosovë të punoj në Misionin e OSBE-së në Kosovë si zyrtare për të drejta të njeriut/dimension njerëzor. "Unë i kam monitoruar

institucionet publike në nivel komunal lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zbatimin e standardeve përkatëse nga ana e zyrtarëve komunalë," sqaron Violeta. "Kontrata ime e parë ishte për një vjet por pas muajit të parë desha të kthehem në shtëpi menjëherë, ishte shumë ndryshe prej asaj që kisha pritur," qeshë ajo. "Unë isha në Prishtinë disa herë më parë për projekte të ndryshme, por çdo herë qëndroja vetëm një ose dy javë dhe kthehesha përsëri në Austri. Kështu që kur erdha këtu në mision me gjithë ato procedura, me radio dore, me raporte që duhet të plotësoheshin, e zbulova që nuk më pëlqente!" shton ajo.

Pas disa muajve në Kosovë, ajo përfundoi disa momente dobësie dhe mendoi të kërkonte nga autoritetet që e kishin dërguar këtu që ta kthejnë përsëri në Vjenë. Violeta punonte në Gjakovë ku shpesh kishte ndërprerje të rrymës. "Shumë shpesh ndodhte që kur kthehesha në shtëpi nga puna dhe filloja ta përgatis ushqimin ndalej rryma në mes të zierjes së ushqimit. Nuk kishte ndonjë orar të caktuar kur njerëzit mund të prisnin se do të ndalej rryma; ndërprerja mund të ndodhte në çdo kohë të ditës. Ishte shumë më ndryshe se në Austri dhe ishte shumë vështirë për mua që të mësohesha me këto kushte të reja," arsyeton ajo.

Pastaj filloi të mendojë që qytetarët e Kosovës përballëshin me të gjitha këto vështirësi dhe vendosi që edhe ajo duhet ta bënte këtë. "U turpërova që doja t'i shkruaja zyrës time për t'ju thënë që nuk mund të qëndroja këtu për shkak të ndërprerjes së rrymës. Kështu që vendosa të kaloja nëpër gjithë këtë dhe ta shfrytëzoja qëndrimin këtu sa më mirë." përfundon Violeta. Në fund ajo kaloi 7 vjet në Kosovë duke mbajtur pozita të ndryshme dhe duke punuar në komuna të ndryshme e cila gjë u dëshmuar të jetë një përvojë e këndshme. Violeta vizitoi shumë vende që përndryshe nuk do të mund t'i zbulonte kurrë.

Pasi u kthye në Vjenë ajo vendosi të aplikojë për një pozitë në EULEX dhe ia doli mbanë. Kështu që ajo u kthye në Kosovë dhe filloi të punojë me Zyrën e EULEX-it për të Drejta të Njeriut dhe Çështje Ligjore ku trajtoi çështje të ndryshme ligjore/të drejtave të njeriut. "Detyra ime kryesore ishte përpilimi i përgjigjeve në pyetjet drejtuar Panelit Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut (PSHDNJ) i cili është një organ i pavarur që merret me ankesat e personave që pohojnë se kanë qenë viktimë e shkeljeve të drejtave të njeriut nga EULEX Kosova gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. "Disa prej këtyre rasteve kishin të bënin me të drejtat pronësore dhe me uzurpimin e paligjshëm të objekteve apo të patundshmërive të ndryshme." thekson Violeta, duke shtuar që zyra e saj e këshillonte shefin e Misionit EULEX lidhur me çështje të ndryshme, deri sa poashtu organizonte trajnime për të drejtat e njeriut si pjesë e seancave të udhëzimit për të sapoardhurit dhe për pjesëtarët e forcave policore.

Violetës i dukeshin interesante posaçërisht ankesat për çështje pronësore kështu që e shfrytëzoi rastin që të aplikojë për pozitën e shefes së Zyrës të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës, KKPK. Punësimi në këtë pozitë ishte një mundësi e madhe për Violetën që të njoftohej me hollësitë e KKPK dhe të procedurës së tij lidhur me numrin e madh të ankesave, e cila ishte diçka që i mungonte në përvojën e saj profesionale. Ishte po ashtu rasti i fundit për të parë si funksiononte Zyra e KKPK meqë mandatit të saj po i vinte fundi. Pasi që filloi ta kryente punën e saj të re Violeta zbuloi që do të kishte rast të punonte me ankesat më të komplikuar dhe më komplekse për të cilat duhet të vendosej në fund të programit të kthimit të cilin e udhëhiqte Agjencia Pronësore e Kosovës dhe Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës.

Deri sa punonte në Zyrën e KKPK, Violeta nuk e kryente vetëm punën e 'shefit të zyrës', siç është kryerja e obligimit të raportimit apo menaxhimi i stafit, ajo në të vërtetë merrte pjesë në vendosjen për çështjet ligjore që paraqiteshin në ankesat që shqyrtoheshin dhe pastaj përgatiste vendimet për Komisionin. Meqë i pëlqen kontakti i drejtpërdrejt me njerëz, ajo merrte pjesë në seancat dëgjimore, të cilat mbaheshin herë pas here nga KKPK lidhur me disa raste komplekse. Ishte përvojë unike të ishte vëzhguese e disa situatave të jashtëzakonshme të cilat ndodhnin nganjëherë gjatë disa seancave dëgjimore. Nganjëherë njerëzit, të cilët ishin fqinj para luftës, pajtoheshin me njëri tjetrin dhe nuk mund të vëreje kurrfarë ndjenje armiqësore ndërmjet tyre. Kjo tregonte sa e rëndësishme ishte t'ua jepje njerëzve rastin që t'i shprehnin ndjenjat e tyre. "Pas secilës ankesë duket se ka shumë më shumë se vetëm dokumente, domethënë tregime personale të individëve të veçantë," thotë Violeta.

Violeta e din që është me fat që e flet gjuhën shqipe. "Nuk më nevojitet përkthyes. Duke qenë ndërkombëtare, por që e njeh gjuhën shqipe, kam mundur të vij në këtë vend dhe në kulturën e tij pa problem," shton ajo. Për të është përparësi e madhe t'i shoh reagimet e drejtpërdrejta në fjalët e saj ashtu që ato 'të mos humbin në përkthim'. Mandati i KKPK ka përfunduar me gjykimin e të gjitha 42,000 ankesave dhe Zyra e KKPK nuk do të ekzistojë më prej datës 31 mars. Por ky nuk është fundi i aventurës së Violetës me Kosovën. Ajo do të kthehet përsëri të punojë me Zyrën e EULEX-it për të Drejta të Njeriut dhe Çështje Ligjore. Ajo mezi pret ta fillojë detyrën e saj të re me entuziazëm të madh.



## Përshëndetje nga Kosova – njoftohuni me Viktorinë, zyrtare ligjore në PSRK

Victoria May u nis prej Somerset për në Kosovë pothuajse 18 muaj më parë dhe deri më tani nuk e ka ndërmend të kthehet në Mbretërinë e Bashkuar. Meqë është zyrtare ligjore në Prokurorinë Speciale ajo për çdo ditë merret me raste të rëndësishme penale, duke ju ofruar prokurorëve të EULEX-it mbështetje dhe ndihmë thelbësore.

Victoria dëgjoi për Ballkanin për herë të parë më 1993. Dy vajza boshnjake u regjistruan në shkollën e saj në një fshat të vogël në Somerset. Vajzat ishin 13 vjeçare, nga Sarajeve dhe kishin marrë azil në Mbretërinë e Bashkuar. "Prej kur jam takuar me ato vajzat në shkollën time gjithmonë kam pasur dëshirë të vijë në Bosnjë. Kur u punësova në këtë vend pune në Kosovë, unë ju shkrova atyre dhe ju thashë që po shkoj në Ballkan", kujton ajo. Por Victoria ka përparuar shumë para se më në fund të vinte në Prishtinë në qershor 2013. Ajo gjithmonë dëshironte ta shfrytëzonte përvojën e saj profesionale në punë në disa vende në zhvillim dhe ishte motivim për të që të fillojë ta kërkojë një punë ndërkombëtare.

Në vitin 2003 ajo ende ishte duke punuar në Londër për autoritetet e të ardhurave. "Ishte një rol goxha i ngjashëm me atë që bëj këtu, por në fushën e të drejtës civile", sqaron ajo. Ishte vetëm punë e përkohshme kështu që ajo aplikoi në Ernst

and Young, një kompani shumë-nacionale e cila ofron këshillime lidhur me taksat. Për shkak të përvojës së saj të mëparshme, atë e pranuan në punë dhe katër vitet e ardhshme Victoria punoi si këshilltare për taksat. Por pavarësisht nga thënia e Benjamin Franklin që "Në këtë botë asgjë nuk është e sigurt, përveç vdekjes dhe taksave", Victoria vendosi ta ndryshojë sigurinë e zyrës së taksave dhe të kalojë në marrjen me të drejtën penale.

Ajo filloi të punojë për Ministrinë e Drejtësisë si këshilltare ligjore. "Ishte punë e shkëlqyeshme", kujton ajo. Gjykata Themelore është gjykatë e shkallës së parë ku paraqitet për herë të parë secili që akuzohet për vepra penale. Roli i Victorias në gjykatë ishte të ulj në bankë para gjyqtarëve porotë, të cilët nuk ishin juristë, dhe t'i këshillojë ata lidhur me ligjin dhe kompetencat e tyre dhe mënyrën si të merren me dikë që e pranon fajësinë, t'iu ndihmojë atyre gjatë çështjeve që kishin të bënin me vendimet për kthim mbrapa dhe kohëzgjatjen e dënimeve me burg dhe po ashtu t'i këshillojë ata për dënimet e tjera nëse të akuzuarit ishin shpallur fajtorë. "Ishte punë interesante, por unë doja që përvojën nga vendi im ta zbatoj jashtë", thotë Victoria. Më në fund dëshira e saj u bë realitet.

Në Kosovë ajo punon si zyrtare ligjore në PSRK (Prokuroria Speciale e Kosovës) dhe

së bashku me prokurorët ajo merret me krimet e luftës, krimin e organizuar dhe krimin financiar. "Rastet janë vërtetë të rëndësishme. Unë punoj në rastet e njohura në Kosovë siç është rasti i shpërthimit të bombës në bulevardin Bill Clinton dhe rasti i orëve Rolex, thekson ajo.

Roli i Victorias është t'ju ndihmojë prokurorëve në menaxhimin e shkresave të lëndës dhe t'i mbështes ata në gjykatë, si edhe t'i menaxhojë hetuesit dhe policinë kur del së bashku me ta në bastisjet e shtëpive për t'u siguruar që ata e respektojnë ligjin. "Është magjepsëse, çdo ditë është ndryshe, sfiduese. Vërtetë më pëlqen puna. Për çdo ditë zgjohem duke menduar: Çka do të ndodhë sot? ", thotë Victoria.

Pjesa më sfiduese e punës së saj është kur duhet ta kryejë punën në gjykatë. Ajo zbulon që ka dallime të mëdha lidhur me zbatimin e ligjit në Kosovë dhe në MB. "Në Kosovë të gjitha veprat penale janë të përfshira në një kod. Kodi i procedurës rregullon mënyrën si duhet t'i bëjmë të gjitha punët, por është shumë i komplikuar dhe nuk është shumë fleksibil. Gjërat bëhen në tjetër mënyrë këtu. Në anën tjetër, ne kemi shumë afate të ngushta kohore, e cila është në të vërtetë shumë mirë – e stimulon adrenalinën tuaj".

Për Victorian pjesa më mbresëlënëse e punës së saj është vetë hetimi, por asaj i duken shumë interesant edhe këshillimi me ekspertët, përgatitja për gjykime, përpilimi i aplikacioneve për përgjim, shkuarja së bashku me dëshmitarët në vendin ku gjoja ka ndodhur krimi. Në mesin e shumë sfidave me të cilat përballet një zyrtar ligjor i EULEX-it, sigurisht janë afatet e shkurta kohore të kodit të procedurës penale. Nganjëherë mund të jetë garë e vërtetë, sidomos në

rastet kur avokati mbrojtës ankohet për vendimet për kthim mbrapa. "Duhet të përgjigjemi dhe ta kryejmë përkthimin brenda 24 orëve. Kur e kam marrë për herë të parë këtë draft, kam qenë në panik të plotë dhe kam menduar që nuk do të mund ta përfundojë me kohë dhe as nuk mund të përkthehet me kohë! Përkthyesit duhet të punojnë gjatë natës por fatmirësisht gjithmonë e kryejmë punën me kohë".

Victorias i pëlqen të punojë me Policinë e Kosovës. Asaj i kujtohet një tregim kur ishte duke punuar në një rast i cili përfshinte një gjyqtar vendas. Në të njëjtën kohë kryheshin shtatë bastisje të shtëpive dhe të zyrave dhe roli i Victorias ishte t'i mbikëqyrë bastisjet e shtëpive. Ajo ishte duke punuar me Policinë e Kosovës dhe ishte përvojë mbresëlënëse për të. Arsyeja e ardhjes së saj në Kosovë ishte të punojë me profesionistët vendas.

Victorias vërtetë i pëlqen qëndrimi i saj në Kosovë, të shoqërohet me miqtë e saj vendas, ta ftojë në shtëpitë e tyre për lftar apo për festimin e Krishtlindjes Ortodokse. Ajo po ashtu ka vizituar të gjitha vendet e Ballkanit dhe ky ishte objektivi i saj kryesor turistik gjatë qëndrimit këtu. Qytetet që i kanë pëlqyer më së shumti janë Beogradi dhe Sarajeva, por ajo e ndjen Kosovën si shtëpi të sajën dhe e merr malli për Prishtinë kur nuk gjendet këtu për një kohë më të gjatë. Ajo që i mungon Victorias megjithatë janë gjërat si ushqimi i duhur aziatik, domethënë japonez . Po ashtu është ngopur me stilin e vozitjes së kosovarëve dhe shprehinë e tyre për t'u parkuar në trotuare, por përveç këtyre pak gjërave, asaj i pëlqen vendi dhe i pëlqen të jetë këtu.

Ajo ka filluar të mësojë pak serbisht dhe shqip dhe mund të zhvillojë biseda elementare në të dy gjuhët. "Mendoj që

është gjithmonë e rëndësishme t'i dish disa fjalë thelbësore në një gjuhë të huaj. Është dashur të di më shumë, shumë më shumë. Mendoj që nëse vini në një mision të këtillë, duhet të bëheni pjesë e kulturës." Pas punës ajo merr pjesë në ushtrime tri herë në javë sepse ushqimi i Ballkanit është i shijshëm dhe nëse dëshironi të mbeteni të shëndetshëm është e domosdoshme të merreni me sport. Victorias po ashtu i pëlqen vera. Ajo i ka bërë disa turne të verës në Kosovë dhe në vendet fqinje, por më e mira që e ka parë dhe e ka eksploruar ishte punishtja e verës Stone Castle.

Thuhet se nëse jeni vegjetarian dhe gurman në Kosovë nuk është lehtë, por Victoria është mjaft e drejtpërdrejtë. "Zakonisht mërzitem pak nga lloji i njëjtë i ushqimit meqë ekzistojnë disa opsione por nuk janë shumë të llojlojshme", sqaron ajo. " Nëse vazhdoj të ha vetëm pica do të shndërrohem në picë. Kur isha në MB gatuaja shumë, por këtu nuk ia vlen meqë më pëlqen të shoqërohem dhe të ushqehesh jashtë është gjithmonë opsion i mirë".

Asaj i pëlqen që kohën e lirë ta kalojë duke shkuar në Grykën e Rugovës. " Unë e quaj atë pjesa ime e vogël e parajsës, thotë ajo. Kam ecur deri tek liqeni dhe mali me gurë të kuq disa herë. Mendoj që atje është shumë bukur".

Për fat të keq përvojës së saj në mision po i vjen fundi dhe 31 marsi do të jetë dita e fundit e Victorias në EULEX. Por nuk do të thotë që ajo do të largohet nga Prishtina. "Nuk do të largohem nga Kosova pas marsit. Zgjidhja ime e parë është të vazhdoj të punojë në Ballkan. Vërtetë nuk dua të kthehem në MB përveç nëse duhet patjetër – këtu ka shumë gjëra për t'u eksploruar".



## Nga Marina Mbretërore në Kosovë – përvoja e Kerry Moyes

Kerry Moyes ka bërë përparim të madh gjatë shërbimit në Marinën Mbretërore të Mbretërisë së Bashkuar në Belgjikë dhe në Gjibraltar. Interesimi i saj për të drejtën ndërkombëtare e ka inspiruar atë që të vijë në Kosovë. Gjatë një viti e gjysmë të kaluar ajo ka punuar si zyrtare ligjore në Gjykatën Supreme të Kosovës. Por kjo nuk është e tëra: udhëtimi i saj do të vazhdojë meqë ajo do ta lëshoj misionin në fund të muajit mars.

Kjo mund të jetë befasi për ju, por Kerry Moyes nuk është marrë me drejtësi gjatë pjesës më të madhe të karrierës së saj profesionale. Ajo ka filluar në Marinën Mbretërore si zyrtare për komunikim në degën e luftimit, ku është marrë me komunikimet elektronike. Kerry ka shërbyer në Marinën Mbretërore 20 vjet radhazi, por ajo e dinte që do të dëshironte ta linte shërbimin në një periudhë të caktuar kohore të jetës së saj.

“Kam menduar shumë lidhur me atë që do të doja të bëja dhe e kam shqyrtuar një numër të profesioneve. Por në fund kam vendosur që drejtësia do të ishte fusha në të cilën do të isha më së shumti e interesuar. Kështu që vendosa ta aftësojë veten që të merrem me të.” thotë Kerry dhe shton që “Ishte vendim i mirë, i duhur për mua. Nuk mund ta marr me mend që të bëjë diçka tjetër.”

Kerry filloi ta studionte drejtësinë me korrespondencë gjatë kohës që ende ishte në Marinë. Kur e la shërbimin, ajo u regjistrua në Kolegjin e Drejtësisë si studente e rregullt për një periudhë një vjeçare për ta përfunduar kursin e praktikës juridike. Pas kësaj, ajo iu bashkua shërbimit të gjykatave si juriste praktikante.

“Gjatë dy viteve të para punoi si juriste me kontratë të trajnimit. Përveç punës suaj të përditshme, duhet po ashtu t’i kaloni disa provime dhe t’i kryeni disa detyra specifike për ta vërtetuar që e keni kryer konsolidimin praktik të asaj që keni mësuar”, thekson ajo dhe shton: “Në Mbretërinë e Bashkuar juristët janë të ndarë në dy kategori: “barristers” (avokatë) dhe “solicitors” (avokatë pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë). Unë jam e kualifikuar për kategorinë e dytë.”

Të dy kategoritë e avokatëve duhet ta kryejnë fakultetin e drejtësisë, por puna e tyre është e ndryshme dhe prandaj trajnimi profesional është ndryshe. Në përgjithësi, kategoria e parë është e vetëpunësuar në ‘Oda’ dhe e kalon pjesën më të madhe të kohës së tyre duke kryer mbrojtje në gjykatë. Në anën tjetër, kategoria e dytë punon në një varg të gjerë të fushave juridike dhe zakonisht janë të punësuar në firma.



Para se të vijë në Kosovë, ajo ka punuar 7 vjet në shërbimin e gjykatave në Angli si këshilltare ligjore në gjykatën e shkallës së parë e cila është gjykatë themelore në Mbretërinë e Bashkuar. Herë pas here, ajo ka punuar në gjykatat familjare, por pjesën më të madhe të kohës ajo ka qenë e përfshirë në gjykatat penale.

Kur ishte ende në Marinë, ajo u emërua në NATO për 3 vjet dhe filloi të punonte në Selinë Supreme në Mons, Belgjikë. Detyra e saj u përputh me konfliktet e viteve 1991-94 që e shoqëruan shpërbërjen e ish-Jugosllavisë. Puna e saj ishte mbrojtja e sigurisë së komunikimit dhe për disa muaj ajo ishte e përfshirë në mbështetjen e operacioneve të NATO-s të cilat kryheshin në atë kohë. Ajo ka qenë e interesuar për Ballkanin që atëherë.

“Po ashtu isha e interesuar që të punojë jashtë vendit dhe qëndrimi në Kosovë i kombinon të gjitha gjërat për të cilat isha e interesuar: Ballkanin, të drejtën ndërkombëtar dhe akoma të praktikuarit e të drejtës penale”, thekson ajo.

Në Kosovë Kerry punon në Gjykatën Supreme si njëra prej tre zyrtarëve ligjorë. Përgjegjësia e saj është t’i mbështesë gjyqtarët e EULEX-it dhe ata vendas gjatë gjykimit të lëndëve. Ato janë lëndët që përcillen në Gjykatën Supreme nga gjykatat më të ulëta dhe herë pas here sillen drejtpërdrejt nga personat e dënuar. “Unë i marr dosjet e lëndëve, i shqyrtoj ato dhe ofroj hulumtime për çështje të ndryshme ligjore kurdo që nevojitet. E përgatis një përmbledhje të lëndës për gjyqtarët, ua sigurojë të gjitha dokumentet që ju nevojiten dhe nëse ka seancë apo dëgjim i kryej organizimet për to. Përndryshe, do të jetë shqyrtim ndërmjet gjyqtarëve në të cilin marr pjesë poashtu. Unë zakonisht i përpiloj

po ashtu vendimet dhe aktgjykimet, si edhe dokumentet e tjera për aprovimin e gjyqtarëve” i sqaron Kerry detyrat e saj kryesore në EULEX.

Në Kosovë janë tri shkallë të sistemit gjyqësor. Shkalla e parë janë gjykatat themelore dhe aty vendoset lidhur me rastet. Në gjykata themelore mbahen poashtu gjykimet si edhe dëgjimet që çojnë tek gjykimet. Pas shqiptimit të dënimit në shkallën e parë, mund të ushtrohet ankesë në gjykatën e apelit. Pastaj vjen shkalla më e lartë, e cila është Gjykata Supreme. Edhe pse këtu në Kosovë ka edhe Gjykatë Kushtetuese, sa i përket marrje së formës së prerë të aktgjykimit, Gjykata Supreme konsiderohet të jetë shkalla e fundit.

Sfida kryesore profesionale me të cilën ajo duhet të ballafaqohet në Gjykatën Supreme është ngarkesa e punës që duhet të procedohet brenda një afati të caktuar kohor. Kerry vëren që në mënyrë që kjo detyrë të ketë sukses, nevojitet shumë kohë dhe përpjekje nga një numër i njerëzve.

“Më pëlqen të punoj shumë ngushtë me gjyqtarët ndërkombëtarë si edhe me ata vendas si edhe me kolegët e mi, zyrtarët e tjerë ligjorë. Kjo është diçka që nuk e kam përjetuar më parë. Nuk kam pasur rast të punojë në raste të mëdha dhe komplekse të cilat marrin kohë”, thotë Kerry duke theksuar që kjo është njëra prej përparësive më të mëdha të qëndrimit të saj këtu në Kosovë me EULEX-in.

Kur nuk është duke iu ndihmuar gjyqtarëve të EULEX-it dhe atyre vendas, Kerry është e lumtur kur mund të udhëtojë përrthe në disa vende në fshatrat e afërta apo kur ka rast ta njohë kulturën vendase dhe kosovarët.

Megjithatë, sfida më e madhe personale për të është të jetuarit larg nga familja e saj në Mbretërinë e Bashkuar si edhe idetë lidhur me nivelin deri te i cili ajo dhe kolegët e saj mund t’i përmirësojnë gjërat. “Mendoj që shumë njerëz kanë pritje joreale lidhur me atë se sa mund të ndikojnë në ndryshim, kur vërtetë krejt çka mund të bësh është kontributi yt personal i vogël. Por çdo copëz është megjithatë e rëndësishme, sepse çdo copëz e vogël mundet gradualisht të kontribuojë që përmirësimi të lëvizë përpara drejt ndryshimit përfundimtar pozitiv”. Sfidë tjetër për Kerryn është: “Nuk ka Starbucks në lagje, diçka nga e cila jam e varur”, e pranon ajo duke qeshur.

Pas punës, kur ka pak kohë për vete, ajo përpiqet të shkojë në palestër së paku dy herë në javë, por do të donte të kishte mundësi të shkonte më shpesh. Përndryshe, ajo është duke studiuar nga distanca për magjistraturë në të drejtat e njeriut dhe të drejtën humanitare në Universitetin Aberystwyth, Uells.

Vetëm së fundi ka kuptuar që duhet ta lëshojë Kosovën në fund të muajit mars. “Do të më mungojë Kosova”, thotë Kerry, “Koha ka kaluar shumë shpejt dhe më kanë mbetur edhe shumë gjëra të cilat ende nuk i kam bërë këtu. Do të më mungoj mjedisi kozmopolit i kësaj përzierjeje të shumë njerëzve të ndryshëm dhe kthimi në Mbretërinë e Bashkuar përsëri do të jetë mjaft i çuditshëm”.

Asaj do t’i mungojnë po ashtu edhe Malet e Sharrit dhe Liqeni i Batllavës, meqë këto janë vendet e saj të parapëlqyera në Kosovë. Por kthimi i saj në shtëpi e ka edhe anën pozitive – ajo do të ribashkohet me familjen e saj përsëri.



## Drejt barazisë së vërtetë gjinore!

Eksperte në fushën e të drejtave të njeriut dhe çështjeve gjinore me diplomë nga Fakulteti Juridik i Prishtinës, Violeta Rexha për dekada me radhë dhe pa u lodhur ka bërë fushata për promovimin dhe avancimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. E motivuar nga një interesim i fuqishëm për frymëzimin e ndryshimeve të vërteta institucionale, Violeta është duke punuar si këshilltare për çështje gjinore në Misionin e BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë.

Detyra kryesore e Violetës është dhënia e këshillave strategjike për përfshirjen e çështjeve gjinore në tërë aktivitetet e Misionit, duke filluar me dhënien e kontributit për dokumentet e Misionit, pjesëmarrjen nëpër komisione të shumta drejtuese dhe nëpër grupe punuese të përqendruara në promovimin e barazisë gjinore, deri tek hartimi i raporteve ndërkombëtare rreth çështjeve gjinore në Kosovë dhe ofrimin e këshillave për menaxhmentin e misionit mbi temat që ndërlidhen me të drejtat gjinore dhe të femrave, në veçanti në kontekstin e çështjeve të sundimit të ligjit dhe të drejtësisë në tranzicion.

“Unë gjithashtu u ofroj ndihmë edhe institucioneve të Kosovës për zbatimin e dokumenteve ndërkombëtare dhe vendase që kanë të bëjnë me çështjet gjinore, barazinë gjinore dhe të drejtat e femrave,” shpjegon Violeta.

Violeta ka një përvojë profesionale të larmishme. Ajo ka punuar në zyrën e Avokatit të Popullit në Kosovë për tetë vite. “Isha shumë me fat që kam punuar për zyrën e Avokatit të Popullit që nga themelimi i saj. Komuniteti ndërkombëtar ka investuar angazhime të mëdha për ngritjen e qëndrueshmërisë dhe të pavarësisë së asaj zyre në mënyrë që ajo të mund t’i mbrojë siç duhet të drejtat e njeriut të qytetarëve të Kosovës”, thekson Violeta.

Gjatë kohës sa ka punuar për Avokatin e Popullit, Violeta e ka pasur rastin që të njihet drejtpërsëdrejti me problemet e përditshme të qytetarëve të Kosovës. “Pata mundësi që të takoja femra që ishin viktime të dhunës fizike kryesisht nga partnerët e tyre. Disa prej tyre ishin dëbuar nga shtëpitë, të ndara dhe të ndaluara nga kontaktimi i fëmijëve të tyre. Besoj se pas një vëzhgimi të afërt të këtyre rasteve, njeriu fiton motivim dhe frymëzim për t’i ndryshuar gjërat. Unë gjithashtu besoj se mund të ndryshoj diçka në punën që e bëj”, thotë ajo.

“Ne jetojmë në një shtet të ri ku sundimi i ligjit ende është i dobët dhe ku qytetarët kanë vështirësi t’i adresojnë problemet e veta dhe të kenë qasje të duhur në drejtësi”, thekson ajo.

Fuqizimi i femrave!

Sipas Violetës, trajtimi i çështjeve gjinore në përgjithësi në Ballkan mund të jetë paksa sfidues. Ajo është mësuar tanimë të dëgjojë komente nganjëherë frymëzuese dhe nganjëherë neveritëse për punën e saj.

Lidhur me mundësitë e barabarta për femrat në Kosovë, Violeta e pranon se ende mbetet punë për t'u bërë. "Familja është burimi themelor i fuqizimit të femrave, jo vetëm si mënyrë e krijimit të mundësive të konsiderueshme në arsim, por edhe në jetën profesionale," thekson Violeta.

Çështja e barazisë gjinore shpeshherë është temë e debateve, gjë që është e mirë për shkak se kontribuon për ngritjen e vetëdijesimit mbi këtë çështje. Vetëdijesimi shpeshherë bie ndesh me normat tradicionale të shoqërisë, ku çështja gjinore ka karakter stereotipi. Në shtetet e Ballkanit ende është i pranishëm hezitimi për t'ua besuar femrave rolet udhëheqëse, pavarësisht aftësive të tyre. "Është e qartë se barazia gjinore është vlerë e pranuar ndërkombëtarisht. Mungesa e barazisë dhe pabarazia e pushtetit mes burrave dhe grave ndikon në zhvillimin ekonomik dhe kështu në demokracinë e gjithmbarshme në shoqëri", thotë Violeta. Ndonëse ka angazhime për përmirësimin e gjendjes aktuale, përkushtimi institucional nuk është i mjaftueshëm. "Të gjitha sferat e shoqërisë duhet të angazhohen për të arritur përparim domethënës në fushën e të drejtave të femrave të Kosovës", thotë Violeta.

Motivimi i vërtetë për Violetën është guximi i grave dhe i vajzave të reja për t'i sfiduar pabarazitë dhe rolet e tyre gjinore të përkufizuara nga shoqëria. "Vajzat dhe gratë gjithnjë e më tepër po i sfidojnë rolet e tyre tradicionale. Ato janë

të gatshme që ta ndryshojnë shoqërinë. Këtu e gjej frymëzimin për të bërë çdo gjë që mundem për këtë kauzë", cekë Violeta. Ndoshta, një pjesë e motivimit vjen edhe nga brendësia e Violetës e cila është e ndjeshme dhe e prekur nga padrejtësitë. "Po të mos kisha qenë eksperte për çështje gjinore, patjetër se do të isha duke punuar në sistemin e drejtësisë, si gjyqtare apo prokurore," thotë ajo.

Për momentin, synimi kryesor i Violetës është që të ndihmojë fuqizimin e femrave të Kosovës dhe përmirësimin e qasjes së tyre në drejtësi.

Violeta i inkurajon femrat ambicioze të Kosovës që vazhdimisht ta kërkojnë vendin e tyre të merituar në shoqëri. Përmes përkushtimit të saj, punës së palodhshme dhe zotimit, ajo është e sigurtë se është duke dhënë kontribut për mbrojtjen e të drejtave të femrave në Kosovë. Kauzë kjo që ia vlen!



## Lili Oprea – Përvojë me dhunti

Një punëtore me përvojë, e përkushtuar ndaj sundimit të ligjit, me vendosmëri për të hulumtuar vende të reja dhe për të kontribuar për sundimin e ligjit jashtë vendit, arriti në Kosovë së fundi. Njihuni me Lili Oprea, prokurore e EULEX-it e cila punon në Task Forcën e Prokurorisë në Mitrovicë.

Ajo ka qenë prokurore në Gjykatën e Lartë të Drejtësisë dhe në Drejtorinë për Krim të Organizuar në Rumani, ku e ka kryer punën e juristes për më shumë se njëmbëdhjetë vjet. Ajo ka punuar po ashtu si këshilltare diplomatike në Republikën e Moldavisë dhe si Udhëheqëse e Misionit të Rumanisë në Kolumbi. Megjithatë, duke qenë e etur për ta përjetuar zbatimin e sundimit të ligjit jashtë vendit, ajo u bë pjesë e Misionit EULEX në Kosovë në qershor 2013.

Task Forca e Prokurorisë në Mitrovicë, TFM, është një njësi e prokurorisë e cila funksionon nën mandatin ekzekutiv të Misionit EULEX. TFM u themelua në nëntor 2010 për t'i përqendruar përpjekjet në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimit të madh në veri të Kosovës.

“Unë i hetoj, ndjek penalisht dhe përfaqësoj rastet në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Në çdo kohë unë mund të jem duke u marrë me tri deri në pesë raste”, thotë Lili, duke shtuar se një përbërës thelbësor i punës në mjedis

ndërkombëtar është të respektohen mendimet e ndryshme të kolegëve dhe të gjendet një bazë e përbashkët për bashkëpunim dhe mirëkuptim më të mirë. Sa i përket Lili Oprea, përfaqësimi në gjykatë ku trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarë ndërkombëtarë, të cilët vijnë nga vende dhe tradita të ndryshme që i kuptojnë dispozitat e ligjit në mënyra të ndryshme, mund të jetë shumë sfidues.

“Duhet të jeni shumë bindëse dhe e përgatitur mirë në mënyrë që t'i bindni ata lidhur me atë që mundoheni ta vërtetoni në ndjekjen tuaj”, thekson ajo. “Poashtu duhet të jeni shumë fleksibil në mënyrë që edhe avokati mbrojtës të ju kuptojë”, thotë ajo.

TFM e prokurorisë kryesisht përqendrohet në veprat penale të kryera në jug dhe në veri të lumit Ibër. Ajo punon së bashku me ekipet e përziera të prokurorëve të Kosovës, të Policisë së Kosovës dhe të Policisë së EULEX-it. Përkundër sfidave, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me qasjen e vështirë në vendet e krimit, mungesën e dëshmitarëve të duhur që janë të gatshëm të paraqiten dhe të dëshmojnë, ekipi i TFM është duke arritur rezultate të mira.

Pas ndryshimeve të bëra në Ligjin për Juridiksionin prokurorët e kësaj zyre janë përqendruar në përfundimin e rasteve në proces, ndërsa nuk marrin raste të reja

dhe po fillojnë ta zbatojnë mandatin e ri duke e bërë mentorimin, monitorimin dhe këshillimin e homologëve të tyre gjatë kryerjes së përgjegjësive të tyre lidhur me forcimin e sundimit të ligjit në veri të Kosovës. Natyra e rasteve me të cilat merren prokurorët e TFM ndryshon; nga veprat e rënda penale tek krimi i organizuar, mashtrimi dhe krimet financiare.

Puna në mjedise të ndryshme shumë kulturore dhe shumë etnike i ka ndihmuar Lilit që të përshtatet shpejtë në pozitën e saj të re në Kosovë, duke e bërë atë më fleksibile dhe më të informuar për ndryshimet dhe mënyrat komplekse të menduarit dhe të punuarit. Sipas saj, ky është çelësi drejt të mirëkuptimit me homologët vendas dhe ndërkombëtarë derisa merren me rastet në ekipet e përziera të prokurorëve.

Deri më tani ajo ka nxënë mësimet të vlefshme në Kosovë, kryesisht lidhur me mënyrën e respektimit të mendimit të të tjerëve, duke e pasur parasysh që të mos i lëndojë ata, kur ta marrë vendimin përfundimtar. Lili është poashtu e sigurtë që mund të arrihen rezultate të mira gjatë punës në ekip ku secili e jep kontributin e tij.

Ajo thekson që në Rumani nuk ka zyrtarë ligjorë që i ndihmojnë prokurorët. "Punoni vetëm dhe ju duhet ta merrni vendimin vetë dhe jo ta ndani me të tjerët këshillën dhe mendimin juridik", thotë Lili, duke shtuar që ajo ka mësuar shumë lidhur me sundimin e ligjit duke punuar në një mjedis ndërkombëtar.

Sipas Lilit, çelësi për prokurorin e mirë janë objektiviteti dhe mirëkuptimi fleksibil. Njeriu duhet ta bëjë vlerësimin e secilit rast dhe ta kuptojë që e vërteta është

gjithmonë diku në mes; kurrë nuk duhet t'i shmanget gjykimit të kriminelit të vërtetë, ndërsa nuk duhet t'i gjykojë të pafajshmit. Puna e prokurorit i ka baticat dhe zbaticat e veta. Nganjëherë mund të jetë e tensionuar por sipas saj këmbëngulja çon tek rezultatet në fund.

Ajo dëshiron të mendojë që duke e kryer punën e saj ka dhënë kontribut në sistemin e pavarur gjyqësor në Kosovë, të lirë nga çfarëdo ndërhyrjeje, i cili gëzon mbështetjen e plotë të qytetarëve - qëllim të cilin EULEX-i e ka përcaktuar që nga fillimi. Megjithatë, është një çështje e rëndësishme për të cilën duhet menduar. Para se të shkojë nga EULEX-i, ajo dëshiron të shohë më shumë zonja të paepura të cilat ushtrojnë sundimin e ligjit në Kosovë ku si gjetiu në Evropën Lindore gratë janë ende të diskriminuara. "Edhe unë vetë kam përjetuar diskriminim të tillë në gjykatë. Rishtazi më është dashtë të theksojë gjatë gjykimit që nuk jam femër por jam prokurore", përfundon Lili.



## Njihuni me Furtunën – eksploruese këmbëngulëse!

Praktikimi dhe studimi i të drejtës penale për dikë do të ishte një punë stresuese dhe e rrezikshme. Jo shumë njerëz do të mund ta përballonin këtë presion. Sidoqoftë, ata që i duan sfidat punojnë shumë për t'i kryer detyrat e tyre me sukses. Furtuna Sheremeti i përket këtij grupi.

Momentalisht ajo është duke i skalitur shkaktësitë e saj ligjore në Universitetin e Oksfordit, ku po i kryen studimet Master në fushën e Kriminologjisë dhe Shkencave Penale. Ajo, po ashtu, është nënkryetare e organizimeve në Graduate Common Room të Green Templeton në kolegjin e saj.

Sheremeti, qysh herët, ka shprehur interesim për fushën e juridikut, duke e filluar karrierën e saj ligjore si aktiviste për të drejta të njeriut në kuadër të Iniciativës Rinore për të Drejta të Njeriut. Ajo pastaj vazhdoi të punonte në Aba Roli – Asociacioni i Avokatëve Amerikan, ku u angazhua në një projekt që kishte për fokus reformimin e sistemit ligjor të Kosovës.

Pas angazhimit në projektet e USAID-it për gjyqësorin, Furtuna filloi punën për një firmë ligjore Sejdiu & Qerkini në Prishtinë, si specialiste e strategjisë së gjykimit. “E konsideroj veten si shumë fatlume që kam pasur mundësinë të punoj me njerëz më të cilët kam punuar. Kjo më ka mundësuar

të ngritem profesionalisht”, thekson Furtuna. Po ashtu, ajo edhe personalisht i ka meritat e saj, në moshën 23 vjeçare ajo paraqiti personalisht rastin e parë në Gjykatën Kushtetuese.

Padrejtësia dhe pabarazia e motivojnë Furtunën. Si një person që beson se shembulli i saj do të inkurajojë më shumë gra kosovare që ta ushtrojnë profesionin në fushën penale, ajo thotë: “të drejtat e barabarta gjinore do të thotë t'i pranojmë dhe respektojmë dallimet mes nesh, dhe vetëm atëherë një shoqëri mund të jetë me të vërtetë e barabartë”.

Sipas Sheremetit, sistemi i drejtësisë në Kosovë ka nevojë për një rishikim të rrënjësishëm. “Jo vetëm që duhet të punojmë më shumë por edhe puna jonë duhet të ri-drejtohet në tërësi. Reformat mbi reforma nuk na ndihmojnë,” thotë ajo, duke theksuar se gjyqësori i Kosovës nuk mund t'i përballojë reformat rrënjësore momentalisht, prandaj ne duhet ta bëjmë më të mirën e mundshme me atë çfarë kemi në dispozicion momentalisht.

“Unë personalisht mendoj se prokuroria ka nevojë urgjente për investime në njerëz dhe mjete. Gjithashtu, Ligji i ri për Gjykatat i cili ka hyrë në fuqi në janar 2013 përpos që ka vënë një barrë shtesë mbi gjyqësorin – ende nuk e ka përmirësuar situatën në terren”, theksoi Furtuna.

Megjithatë, sipas Fortunës, për ta përmirësuar gjyqësorin duhet të plotësohet një kusht themelor e ai është ç'rrënjësja e ndikimit politik. "Nëse një gjë e tillë nuk ndodh – arritja e përparimit do të jetë shumë e vështirë," përfundoi ajo.

Përpos drejtësisë, shkrimi ka qenë gjithmonë një pasion tjetër i Furtunës. "Unë gjithmonë kam menduar se do të bëhem shkrimtare ose gjuhëtare, mirëpo e kuptova se këto profesione nuk e plotësojnë nevojën time për eksplorim," shpjegon ajo. Opsioni i dytë për Furtunën ishte Astronomia. Gjithësia dhe e panjohura e kanë magjepsur dhe intriguar atë gjithmonë. Mirëpo, në fund ajo e zgjodhi opsionin e tretë - drejtësinë, të cilin ajo e kishte gjithherë në listë. "Besoj se e treta ishte e vërteta," thotë ajo duke qeshur. Por tani që ka kaluar pak kohë në këtë fushë ajo ndihet e lumtur për zgjedhjen që e ka bërë.

Me dy libra të botuara në biografinë e saj, nuk mund të thuhet se Furtuna ka hequr dorë nga shkrimi përgjithmonë. "Me pëlqen të shkruaj prozë letrare kohë pas kohe, me ndihmon t'i shpreh ndjenjat e mia dhe është e vetmja mënyrë që me bën të mos ulërij kohë pas kohë", thotë ajo.

Vdekja e babait të saj kur ajo ishte vetëm 5 vjeç, ndikoi që Furtuna t'i vlerësojë edhe gjërat më të vogla në jetën e saj. Nëna, motra dhe vëllai i saj u kujdesen që asaj të mos i mungonte asgjë – prandaj ajo e konsideron veten me shumë fat, përkundër të gjitha atyre gjërave nëpër të cilat ka kaluar.

Seminare të shumta, udhëtime rreth botës dhe kontaktet e krijuara kanë ndikuar që Furtuna të jetë ajo që është sot. Ajo është një grua që s'ka frikë nga asgjë dhe është e gatshme për t'u përballur me sfida.

"Nuk ka qenë e lehtë," thotë ajo kur e kujton ngritjen e saj në karrierë. "dhe nuk do të jetë e lehtë as në të ardhmen." Mirëpo me vendosmëri dhe punë të palodhshme – sfidat nuk bëhen më ndonjë faktor.

"Përkundër faktit se Kosova ende ka nevojë për përmirësime në fushën e drejtësisë, unë kam besim se gjërat do të ndryshojnë." Ajo beson fuqishëm se çdonjëri duhet ta këtë mundësinë që t'i jetësojë ëndrrat e veta pavarësisht rrugës së vështirë. "Mos i flakni tutje ëndrrat tuaja. Bëjini ato realitet. Vetëm atëherë do të jeni vetvetja, dhe kur ta arrini këtë – çdo gjë tjetër do të jetë shumë më e lehtë."



## Mbrojtja e komunitetit në veri - njoftohuni me Raymila Markova

Ajo është nga vendi ku kanë lindur Orfeu dhe Spartaku, një shtet me një histori të gjatë dhe magjepsëse. Kur Raymila Markova filloi punën në Drejtorinë e Policisë për Krime në Sofje, ajo u bë përgjegjëse për luftimin e trafikimit të artefakteve shumë të çmuara në gjithë Bullgarinë. Ajo punonte për të ruajtur nga shkatërrimi dhe vjedhja trashëgiminë e pasur kulturore në të cilën kishin lënë ndikimin e tyre Grekët, Skitët, Romakët, Bizantinët dhe Turqit.

Përderisa ishte në Bullgari, Raymila ishte përgjegjëse për pengimin e vjedhjeve të përhapura të pjesëve të artit dhe gërmimeve arkeologjike të kundërligjshme në gjithë vendin, ku për çdo vit, plaçkiteshin objektet me rëndësi kulturore dhe vlera të rëndësishme, e pastaj kontrabandoheshin nëpër botë, shpesh duke përfunduar si pjesë e koleksioneve private.

Në një çast, ajo i la të gjitha pas vetes, në mënyrë që t'i bashkohej njësisë policore plotësuese të Sektorit Ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Kjo ishte diçka krejt ndryshe nga bota e artit, të jesh në njësinë e parë policore që kishte për detyrë të patrollojë në veri të Kosovës.

Pas një viti, Raymila u bë këshilltare e stacionit në Sektorin e Fuqizimit në veri, duke e këshilluar shërbimin policor

vendës në katër komunitat në veri për policimin në komunitet dhe duke ndihmuar në rritjen e efikasitetit të tyre. Detyra më e rëndësishme për të dhe për Policinë e Kosovës është të krijoj raporte të afërta me komunitetin vendës të ndërtuara në besim, pranim dhe qëllime të përbashkëta, të nevojshme për ngritjen e standardeve të sigurisë.

“Për të qenë efektiv, policia duhet ta ketë pëlqimin nga komuniteti. Ne duhet të koncentrohemi në parandalimin e krimit dhe për këtë na nevojitet partneriteti me qytetarët”, thekson Raymila.

Një parim i rëndësishëm i policimit në komunitet në veri është që policia të kuptojë nevojat dhe kërkesat e shoqërisë ku ata jetojnë, thotë Raymila. Meqë policia ofron shërbim publik, ajo po ashtu duhet të shkojë një hap më larg për të identifikuar dhe zgjidhur problemet në mënyrë që të parandalohet krimi dhe konfliktet e ardhshme. Policia në komunitet, sipas Raymil-ës, mbanë llogaridhënie për veprimet e dhe vendimmarrjet e tyre për qytetarët të cilëve u shërbejnë. Policët në komunitet duhet të jenë frymëzim për popullatën vendëse që të jenë më proaktiv sesa pranues pasiv të shërbimeve të policisë. Me fjalë tjera, ata nuk janë aty për të dominuar, por për t'i shërbyer komunitetit.



Raymila punon bashkë me një ekip të vogël të fokusuar në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e homologëve të tyre vendës, në përpjekjet e tyre për avancimin e kapaciteteve operacionale të stacioneve policore në komunat veriore. Ata angazhohen në aktivitete ditore së bashku me kolegët e tyre duke ofruar këshilla dhe inspirim, nganjëherë duke i zgjidhur bashkërisht problemet dhe pengesat ditore.

Një kriter esencial i punës së saj, tregon Raymila, është një raport pune i fuqishëm me kolegët e saj të punës. “Më pëlqen fakti që ne mund të komunikojmë. Duke e pasur parasysh ngjashmërinë me gjuhën bullgare, unë mund të them se unë mund ta kuptojë gjuhën serbe. Unë po ashtu e kuptojë traditën dhe kulturën vendëse. Ne kemi një historik të ngjashëm dhe kjo më ndihmon në punën time të përditshme”. Raymila së fundi ka filluar të punojë në çështjet e dhunës në familje, në veri. Shqetësimi i saj kryesor është mbrojtja e viktimave në një komunitet të vogël ku “njerëzit ngurrojnë të tregojnë për problemet e tyre, meqë ata të gjithë e njohin njëri tjetrin dhe nuk duan të jenë të stigmatizuar”. Ajo ka njohuri për shkëputjen e cila ekziston në mes të institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile dhe është munduar të identifikojë zbrazëtirat, në mënyrë që të ketë më shumë mbrojtje për viktimat e dhunës në familje. Gjatë këtij procesi i cili është duke vazhduar, si kolegët nga PK dhe ajo vetë kanë mësuar shumë, thekson ajo.

“Ne i shkëmbejmë përvojat dhe mësimet e nxjerra, cilat janë të dyanshme. Unë fitoj njohuri nga kolegët e mi nga PK dhe ata poashtu mësojnë nga unë”, thotë Raymila. Raymila është police në komunitet me gjithë zemër. Qëllimi saj është të arrijë në komunitet tek ata që kanë nevojë

dhe dëshira e saj është që kolegët nga PK të jenë në gjendje për t’u përgjigjur në gjitha kërkesat e tyre: duke filluar nga mosmarrëveshjet e fqinjëve lidhur me sigurinë e fëmijëve, riparimi i një gypi të dëmtuar të kanalizimit që mund të lëndojë këmbësorët, e deri te një shoqëri ku nuk ka dhunë.

Në kuadër të punës së saj, Raymila viziton fshatin Stërnac i Epërm, një fshat i vogël e i thellë, i stolisur me një kishë të Shek. XIII, për të vlerësuar sigurinë, kryesisht të njerëzve të moshuar, të cilët jetojnë në një vend me një pamje të bukur. Ajo, poashtu rregullisht e viziton fshatin Çabër, ku përkujdeset për nevojat e popullsisë vendëse shqiptare.

Pas përfundimit të mandatit të saj në pjesën veriore të Kosovës, ajo do t’i kthehet punës saj të vjetër në Bullgari, duke i ndjekur personat të cilët përfitojnë nga trafikimi i objekteve kulturore. Megjithatë, ajo do të pikëllohet kur të largohet prej miqve dhe kolegëve të saj.

“Një forcë policore efektive me një bashkëpunim të ngushtë me komunën dhe në komunikim të vazhdueshëm me qytetarët e vet, mund të sjell një fuqizim të komunitetit vendës”, thekson Raymila, kur shpjegon dëshirat e saj për Kosovën veriore.

“Do të më vinte mirë, para se të largohem, të shoh njerëz të buzëqeshur, të preokupuar me të ardhmen e tyre, e me shqetësimet e lëna prapa”, thotë Raymila. “Atëherë do të kuptoja se vizita ime e shkurtër në Kosovë dhe përpjekjet e mia atje ia kanë vlejtur”, përfundon ajo.



## Të gjithë sytë tek ajo!

Hulumtuesit pohojnë që frika numër një të cilën e kanë pjesa më e madhe e njerëzve është frika e të folurit në publik por si duket Aishja nuk është e informuar për këtë. Kur flet me publikun ajo është thjeshtë e patrembur. Në të vërtetë, asaj i pëlqen kjo pa masë. Ajo përpiket t'ju ndihmojë njerëzve dhe gjyqësorit duke vepruar si urë lidhëse ndërmjet gjyqësorit dhe publikut përmes mediave dhe duke i mbajtur në këtë mënyrë kanalet e komunikimit të hapura në çdo kohë, në mënyrë që të gjithë aktorët të angazhohen në diskurs të shëndoshë.

Aishe Qorraj - Berisha është zëdhënëse e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK). Është detyrë e saj që të jetë aty, duke i menaxhuar marrëdhëniet e KGJK-së me mediat dhe publikun në përgjithësi.

Ajo është e përfshirë në prezantimin e punës dhe të aktiviteteve të tërë gjyqësorit në Kosovë, duke ofruar qasje dhe transparencë në punën e KGJK-së.

"Të punosh si zëdhënëse në sistemin e drejtësisë në Kosovë aktualisht është sfidë në vete," thotë Aishja. Sipas saj, është e rëndësishme që publiku të jetë i informuar për aktivitetet e gjyqësorit dhe t'i marrë sqarimet e nevojshme. "Për të gjithë ne, etika është hapi i parë i komunikimit institucional," thotë ajo.

Aishja ka shërbyer si zëdhënëse për Ministrinë e Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit dhe ajo ishte emëruar po ashtu si zëdhënëseja e parë e Qeverisë së Kosovës. Vite më parë, ajo po ashtu ka punuar si ligjëruese e gjuhës shqipe në shkollën fillore 'Elena Gjika' në Prishtinë. Duke jetuar në dinamikën e aktiviteteve, të punës pa orar, Aishja e bën këtë punë me pasion, përkushtim dhe dashuri. "Kjo punë më ka mësuar shumë për kulturën e punës ekipore, një përvojë të vlefshme në marrëdhëniet me mediat, dhe mbi të gjitha e ka forcuar karakterin tim edhe më shumë," thotë ajo.

Gjyqësori i pavarur është themel i çdo shoqërie demokratike. Problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet gjyqësori janë të shumta dhe komplekse dhe për t'i tejkaluar ato nevojitet përkushtim dhe investim i burimeve më të mëdha në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara.

"Gjyqësori është njëri nga institucionet në të cilin kemi më së shumti nevojë të investojmë," thotë Qorraj-Berisha. "Qëllimi ynë është që së bashku ta ndërtojmë një gjyqësor të pavarur. Përkushtimi, paanësia, profesionalizmi dhe përgjegjësia e lartë janë cilësi që duhet të reflektohen në arritjen e këtij qëllimi," shton ajo.

Kontrollimi i sistemit të drejtësisë nga ana e publikut vazhdon të rritet. Sipas Aishes njëra prej detyrave më të mëdha me të cilat përballet gjyqësori është kthimi i besimit të publikut.

“Vendimet gjyqësore ndikojnë tek njerëzit drejtpërdrejt, kështu që duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe profesional kur komunikojmë me publikun,” thotë Aishja, duke e theksuar gjithmonë rëndësinë e pavarësisë gjyqësore.

Është me rëndësi që gjyqësori të jetë i hapur ndaj mediave sepse gjyqësori është një organ që ofron shërbim publik dhe, si të gjitha institucionet publike, nga gjyqësori pritet të jetë i hapur, meqë njerëzit kanë interes në funksionimin e duhur dhe efektiv të gjyqësorit.

“Mediat dhe gjyqësori duhet ta respektojnë njëri tjetrin dhe të kujdesen që dialogu i sinqertë të mos kalojë në konflikte të hidhura”, thotë Qorraj-Berisha.

Drejtimi dhe Përgjegjësi për të Gjithë

Në gjyqësor duhet të ketë përgjegjësi dhe transparencë ashtu siç duhet të ketë edhe në media.

Duke ju falënderuar përqendrimit të mediave në dobësitë e sistemit të drejtësisë, publiku i përgjithshëm tani ka një pikëpamje të shtrembëruar të sistemit gjyqësor të Kosovës. Duke e pasur parasysh rolin e tyre të rëndësishëm në formësimin e qëndrimeve ndaj gjyqësorit dhe sistemit të drejtësisë, mediat kanë për detyrë t’i raportojnë seancat në mënyrë të saktë dhe të drejtë.

Qëllimi i Aishes mbetet gjyqësori transparent. “Për ta ushtruar profesionin e kam sakrifikuar jetën time private dhe vazhdojë ta sakrifikojë atë, kështu që përkushtimi ndaj punës, përgjegjësia,

besnikëria janë çelësi i suksesit tim në profesion,” thotë ajo.

Aishja e vlerëson shumë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare. “Ne e çmojmë profesionalizmin e tyre, në veçanti mbështetjen e vazhdueshme të cilën ia kanë dhënë sistemit të drejtësisë në Kosovë.” Sipas Aishes, kjo mbështetje ka çuar tek sistemi ndërkombëtar gjyqësor të cilin e ka Kosova sot.

Në jetën e saj private, Aishja është nënë e përkushtuar e tre djemve. Asaj i pëlqen ta kalojë kohën me familjen e saj dhe të shkruajë kurdo që ka rast. Deri tani ajo i ka botuar disa libra por ajo që ja ka pushtuar zemrën vërtetë është poezia dhe ajo ka fituar edhe shpërblime për të.

Aishja do të vazhdojë t’i shprehë shqetësimet, qëndrimet dhe pikëpamjet e KGJK-së, duke ndihmuar në ruajtjen e një imazhi pozitiv me publikun e përgjithshëm – një detyrë që nuk është gjithmonë e lehtë!



## Kur në gjykatë ndihesh si në shtëpi

Meqë ka punuar në sektorin e drejtësisë, ajo ka pasur fatin që të shkojë në aventura anembanë botës, të takohet me njerëz interesantë, të përjetojë kultura të ndryshme dhe të mësojë gjuhë të huaja – të gjitha këto duke e bërë atë që do. Ajo është personalitet tipik “njeri i punëve”, plot me energji dhe entuziazëm; duke punuar me njerëz, duke mbajtur gjallë marrëdhëniet, duke debatuar për politikat dhe vendimet dhe duke punuar që ta mbajë padrejtësinë sa më larg.

Elka Yordanova Filcheva-Ermenkova është figurë kryesore gjyqësore, kryesisht e përqendruar në zgjidhjen e kontesteve pronësore viteve të fundit. Ajo punon si gjyqtare në Panelin e Ankesave Pronësore të Kosovës (APK) në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Prej janarit 2012, Elka vendosë për kontestet pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999. “Thjeshtë ato janë raste kur njerëzit (kryesisht serbët) duhej t’i braktisnin pronat e tyre në atë periudhë dhe tani nuk janë në gjendje t’i ri-posedojnë ato sepse ato janë të uzurpuara nga dikush tjetër,” thotë ajo.

Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës është marrë me afërsisht 42 000 kërkesa të cilat janë dorëzuar më 2006 dhe 2007 dhe ende merret me to. Në rastet kur

ushtrohen ankesa kundër vendimeve, ato shkojnë në Gjykatën Supreme të Kosovës ku punon Elka.

Elka është po ashtu ushtruese e detyrës së zëvendëskryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it dhe prej janarit 2013 ajo është e lidhur me punën e Panelit Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut, si anëtare zëvendësuese e gjyqtarit të EULEX-it në panel.

Elka ka diplomuar në shkollën e drejtësisë më 1997. Karriera e saj profesionale ka filluar një vit më vonë si gjyqtare më e re. Pas kësaj, ajo ka qenë gjyqtare e shkallës së parë, kryetare e një gjykate të shkallës së parë dhe gjyqtare e gjykatës së shkallës së dytë (të apelit). Gjatë tërë këtyre viteve Elka është marrë me të gjitha llojet e lëndëve prej atyre civile, administrative dhe të drejtës penale por kanë mbizotëruar kontestet civile.

Katër vjet me radhë Elka ka punuar si këshilltare për sundimin e ligjit për PAKC (Planifikimin dhe Administrimin e Kapaciteteve Civile). Gjatë punës së saj, ajo ka shkuar në shumë misione në terren në zonat ku BE-ja kishte filluar operacionet për menaxhimin e krizës – në Palestinë, Bosnjë dhe Hercegovinë, RDK (Kongo, Kinshasa), në Guineja Bissau. “Çdo herë ka pasur “aventura”, tronditje të vogla kulturore dhe mësim të nxjerra dhe kam

kujtime të bukura, si të pikëlluara ashtu edhe të gëzuara nga këto misione," thotë ajo.

Elka e ka studiuar drejtësinë në universitetin e qytetit të saj të lindjes Blagoevgrad in Bullgari. Pas provimeve përfundimtare, asaj iu desh të bënte një vjet praktikë. "Në periudha të ndryshme ju kam ndihmuar hetuesve, prokurorëve ose gjyqtarëve," tregon ajo. "Kur isha në gjykatë ndihesha si në shtëpi. Më pëlqente ideja që unë isha ajo e cila gjoja do ta rregullojë atë që nuk ishte në rregull ..." thotë Elka. Çdo ditë tjetër, njeriu duhet t'i bëjë gjërat më mirë se një ditë më parë!

Sipas Elkas, Kosova tashmë ka njëfarë baze të mirë, Parlamenti ka krijuar shumë ligje themelore, megjithatë shumica prej tyre duket se janë shkruar me nxitim dhe tekstet shpesh shkaktojnë huti. "Vërtetë nuk i kuptoj teknikat legjislative që janë përdorur. Ka tradita dhe rregulla lidhur me mënyrën e të shkruarit të ligjeve ..." thotë ajo. "Në hartimet ligjore shoh një qasje të madhe të kopjimit. Nuk mundesh thjeshtë ta marrësh një ligj të vjetër apo një ligj të huaj dhe ta riemërtosh atë," shton Elka.

Problemet e hartimit të dobët të ligjeve deri në një shkallë do të mund të tejkaloheshin nëse keni juristë të mirë të cilët mund të gjejnë kuptim madje edhe në legjislacionin e shkruar shumë keq. Elka mendon që nëse juristët kanë përgatitje të mirë teorike, të doktrinës ata do të jenë të armatosur me mjete që të merren madje edhe me tekstet ligjore të cilat nuk janë të shkruara mire. "Pavarësisht nga cilësia e ligjeve dhe profesionalizmi i juristëve, faktori njeri është më i rëndësishmi. Madje edhe ligjet më të mira nuk do të kenë rëndësi nëse pushteti dhe paratë ndërhyjnë në rrugën e drejtësisë," përfundon Elka. \

Elka Ermenkova e vlerëson shumë bashkëpunimin e mirë me kolegët vendas. "Natyrisht që i kemi dallimet tona por kur punon me njerëz të arsyeshëm është gjë e mirë që e gjen një bazë me të cilën pajtohesh, madje edhe në rastet kur çështja që është në pyetje është shumë kundërtëne dhe e vështirë," thotë ajo. Për tërë gjeneratën e re që punon në sistemin e drejtësisë në Kosovë, Elka e ka një porosi: "Studioni, mendoni, punoni. Në çdo paraqitje të padrejtësisë, reagoni ashpër."

Elkas i pëlqen Kosova shumë, në veçanti fakti që ka kaq shumë të rinj këtu. Ka shumë energji në ajër. Asaj po ashtu i pëlqen ecja, alpinizmi, mbjellja e luleve, të mësuarit ... Po të mos ishte gjyqtare, do të ishte kopshtare shumë e mirë. Çfarëdo që mbjell ajo, rritet.



## Vendosja e themeleve të shëndosha për Kosovën

Përkushtimi i saj i palëkundur për zhvillimin e Kosovës dhe angazhimi i zellshëm i saj ndaj profesionalizmit e ka bërë atë pjesë vitale të përpjekjeve të pafund për ndërtimin e një shoqërie më të mirë. Ajo quhet Ariana Qosaj dhe momentalisht punon si Hulumtuese/Koordinatorë e lartë e programeve në Institutin Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave.

Ariana është pjesë e menaxhmentit të lartë të KIPRED-it, një institut vendas që ka për mandat bërjen e hulumtimeve, analizimin e politikave, përmbledhjeve dhe publikimeve të ndryshme për ta ndihmuar Kosovën në ndërtimin e institucioneve efektive në fushën e sundimit të ligjit, sigurisë, qeverisjes demokratike dhe zhvillimit. Ariana e udhëheq programin për Sundim të Ligjit dhe Qeverisje të Mirë.

Proceset e zhvillimit të politikave kanë qenë pjesë e aktiviteteve të Arianës për shumë vite. "Unë mendoj se përmes hulumtimit ne mund të ofrojmë fakte, informacione dhe ide për një zhvillim më të mirë të politikave," thotë Ariana.

Pasioni për temat siç janë sundimi i ligjit, të drejtat e grave dhe kryesisht besimi se një ditë Kosova do të behët shtet i fortë për të gjithë qytetarët e saj duke garantuar zbatimin e plotë të ligjeve, e

kanë shtyrë Arianën drejt punës që ajo e bën. "Ligjet nuk duhet hartuar ashtu që t'i plotësojnë nevojat e elitave të caktuara politike por t'i shërbejnë popullit," thotë ajo.

Ariana ka pasur një laramani të përvojës së punës dhe gjithmonë gjen diçka për të bërë. Ajo ka punuar si Drejtoreshë Ekzekutive e Fondit për Zhvillim të Komunitetit, një iniciativë e Bankës Botërore në Kosovë dhe një OJQ vendase për zhvillimin social dhe të infrastrukturës kryesore. Para kësaj ajo kishte punuar si Këshilltare Ligjore për Çështjet e Grave dhe Fëmijëve në misione ndërkombëtare siç është misioni i OSBE-s në Kosovë.

Për një vit e gjysmë, Ariana ka qenë e angazhuar si këshilltare për çështje ligjore tek Presidentja e Kosovës, nga fillimi i mandatit të saj. Puna e saj e parë ka qenë krijimi i një grupi punues për hartimin e Rregullores Presidenciale për Falje. "Me vjen mirë që kjo rregullore tani po përdoret për hartimin e ligjit të ri për faljen," shtoi ajo.

Gjatë kohës sa ka punuar me Presidenten, Ariana është krenare për shumë gjëra që ajo i ka arritur, një ndër të cilat që ia vlen të ceket është edhe praktika e krijuar për të mos ndikuar politikisht në emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. "Unë mendoj se ne shpesh irritohemi ngase

Kosova nuk është zhvilluar sa do të duhej pas pavarësisë. Më rininë dhe potencialin që e kemi ne kemi pritur që të lëvizim më shpejtë sesa jemi duke lëvizur tani”, thotë Qosaj. Ajo ndihet se proceset po shkojnë mbrapa dhe se duke pasur objektiva dhe pritje të mëdha kjo gjë nganjëherë bëhet sfiduese.

Kurrë mos u dorëzo!

Ariana vazhdimisht ka dëshirë që të avancohet në shkollim dhe trajtimin e sfidave, prandaj punon për ide të reja. Ajo nuk mendon se njerëzit duhet të qëndrojnë në zonën e tyre të sigurtë por gjithmonë motivim ta kenë arritjen e niveleve më të larta profesionale. “Asnjëherë nuk duhet të udhëhiqemi nga oportunitizmi ngase një gjë e tillë kurrë nuk do të sjellë ndryshimet dhe përparimin e nevojshëm për shoqërinë” thotë Ariana.

Momentalisht, gjyqësori i Kosovës përballlet me shumë sfida. Kryesisht në mungesë të mbështetjes me staf dhe buxhet, gjyqësori do të vazhdojë të përballët më vështirësi në ndarjen e drejtësisë. Sipas Arianës, Kosova ka shumë probleme në zbatimin e sundimit të ligjit, dhe se ajo është dashur që t’i ndjek modelet siç është ai i Uashington DC, ku Kongresi dhe Shtëpia e Bardhë gjithmonë e dinë sa pranë e kanë Gjykatën Supreme dhe se dikush gjithmonë është duke i mbikëqyrë ata. “Gjithashtu, dua të shtoj se mbetet shumë për t’u bërë dhe kjo nuk mund të përfshihet në disa fjali. Megjithatë, përderisa nuk kemi një elitë politike e cila më të vërtetë e kupton se politika duhet të qëndrojë larg nga gjyqësori, ne do ta kemi të vështirë që të kemi një sistem gjyqësor të fortë, të pavarur dhe efikas,” thekson ajo.

Ariana është po ashtu nënë e tri vajzave. Të qenit grua me karrierë dhe familje është gjithmonë një sfidë. Megjithatë, Qosaj thotë se njeriu duhet ta shfrytëzojë në mënyrën më të mirë përkrahjen e familjes, shoqërisë në punën që e bën në mënyrë që t’i balancojë të gjitha. Duke e pasur këtë parasysh, ekzistojnë shumë gra të mrekullueshme të cilat shpesh nuk i kanë as mundësitë e as përkrahjen e nevojshme dhe kështu mbesin në shtëpi. “Të gjithë duhet ta dimë se kjo gjë nuk do të jetë e lehtë, por gjithashtu do të thotë se ne nuk duhet të dorëzohemi aq shpejtë,” thekson ajo.

Ajo po ashtu ka një porosi për gratë e reja, të cilat përpiqen të ndjekin ëndrrën e tyre. “Asnjëherë mos i ndalni përpjekjet për realizimin e ëndrrave tuaja pavarësisht asaj çfarë thonë apo bëjnë të tjerët për të ju dekurajuar. Ju mundeni dhe duhet të bëni ndryshimin duke e bërë atë që e keni pasion.”

Ariana Qosaj momentalisht është kandidatë për Doktoratë në Fakultetin Juridik ‘Iustinianus Primus’ në Shkup, mirëpo çfarëdo që të jetë duke bërë, ajo do të vazhdojë të punojë dhe avokojë për të drejtat e grave dhe çështjet e sundimit të ligjit.



## E përkushtuar ndaj Kosovës – Joelle Vachter

Joelle Vachter është grua unike. Kolonele në Xhandarmërinë franceze, karriera e saj lulëzoi në një fushë në të cilën pak gra shkelin. Jo vetëm që e udhëhoqi Zyrën për Menaxhimin e Krizës të ministrit të brendshëm francez, por ajo, po ashtu u bë kolonelja e parë e ushtrisë franceze duke specializuar në kontrollin e turmës dhe të trazirave. Megjithatë, e ballafaquar me perspektivën që të avancohet në gradën e gjeneralit në vendin e saj ose ta paketojë valixhen e saj dhe të shkojë në një vend të panjohur dhe ta zbatojë ekspertizën e saj jashtë vendit, Joelle thotë se ajo vendosi lehtë.

“Për mua nuk ishte zgjidhje e vështirë sepse më pëlqen të punojë me njerëz të nacionaliteteve të ndryshme dhe me prejardhje të ndryshme kulturore”, thekson ajo duke sqaruar çka e nxiti të punojë jashtë vendit.

Para se t’i bashkohej EULEX-it si zëvendës-shefe e Misionit, Joelle punoi në disa misione anekënd botës duke ju ndihmuar vendeve në tranzicion dhe organizatave ndërkombëtare me ekspertizën e saj lidhur me sigurinë dhe çështjet policore.

E pajisur me diplomë të magjistraturës në Drejtësi dhe Administratë Publike nga Universiteti i Sorbonës dhe me vite të tëra të përvojës policore dhe ushtarake, Joelle punoi në Gjermani, Shqipëri,

në Bregun e Fildishtë dhe në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Megjithatë, destinacioni i saj më i rregullt për mision ishte Kosova, ku ka punuar në tri raste të ndara për UNMIK-un, KFOR-in dhe EULEX-in.

Kur erdhi në Kosovë për herë të parë në vitin 2000, ajo ishte tronditur nga shkatërrimi. “U preka në veçanti kur i pashë shtëpitë familjare të hapura krejt, pa kullm, me pjesë të orendive të lëna pas dhe me mure të rrënuara, kjo vërtetë e tregonte ndikimin e konfliktit në nivel individual”. Jam e lumtur të shohë që shumica prej tyre tani janë riparuar”, thotë ajo. Ajo me shpejtësi thekson se Kosova ka ndryshuar plotësisht prej fundit të konfliktit kur ajo e vizitoi për herë të parë.

Si zëvendës-shefe e Misionit EULEX, ajo e sheh rolin e saj si lehtësuese brenda misionit. “Unë merrem me çështjet që janë paraqitur që një kohë. Nëse kanë arritur në nivelin tim, zakonisht nënkupton që ato janë bllokuar. Unë përpiqem ta bëjë të mundur që rasti të vazhdojë në një bazë të re. Unë e marr këtë rol seriozisht”, thotë Joelle.

“Më së shumti më pëlqen të merrem me qeniet njerëzore. Kam pasur mundësi të merrem me drejtësi si juriste, por nuk kam dashur të rri e ulur pranë tavolinës



sime e mbuluar me një mori letrash. Kam dashur kontakt të drejtpërdrejtë me njerëz. Të përpiqem t'i kuptojë si ndihen ata në mjedisin e tyre të punës dhe t'ju ndihmojë t'i zgjidhin disa prej problemeve të tyre", thotë Joelle.

Motivi i saj kryesor gjatë punës në mision është që ta ndihmojë fuqizimin e institucioneve të Kosovës ta zbatojnë sundimin e ligjit anembanë Kosovës.

"Institucionet e fuqishme të bazuara në sundimin e ligjit janë bazë për çdo vend demokratik. Qëllimi ynë si mision është t'i përmirësojmë dhe t'i rrisim standardet këtu. T'ju ndihmojmë të gjitha institucioneve të Kosovës të bëhen pjesë e bashkësisë ndërkombëtare para se të shkojmë ne".

Ajo thotë që deri më tani është arritur shumë. Dy sektorët e EULEX-it, fuqizimi dhe ekzekutivi funksionojnë në harmoni reciproke në mënyrë që ta zhvillojnë dhe zbatojnë sundimin e ligjit në Kosovë. Ndërsa sektori i fuqizimit ofron mbështetje për sistemin e drejtësisë të Kosovës, për policinë dhe doganën, dega ekzekutive e EULEX-it i gjykon rastet e krimit të organizuar, të korrupsionit, të pronës, të privatizimit dhe rastet e krimeve të luftës.

Nga profesionalizmi i shtuar i Policisë së Kosovës, deri te ofrimi i ndihmës për mundësimin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave dhe hartimi ose shqyrtimi i më shumë se 110 ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve deri te vërtetimi i më shumë se 12,000 librave amë të kopjuar në Serbi, EULEX-i, sipas Joelle, ka bërë përpjekje të madhe për ta siguruar një kornizë të fuqishme legjislative dhe institucionale për sundimin e ligjit.

Duke ju referuar funksionit më të dukshëm të EULEX-it i cili merret me zbatimin e sundimit të ligjit, Joelle nënvizon që gjyqtarët e EULEX-it kanë nxjerrë mbi 500 aktvendime në rastet që kanë të bëjnë me korrupsionin, krimin e organizuar, pastrimi e parave, krimet e luftës dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Por kjo nuk është e tëra, thotë ajo: "Gjyqtarët e EULEX-it lënë aktgjykime të hollësishtme në rastet e rënda dhe ato janë në dispozicion të gjyqtarëve dhe prokurorëve aktualë të Kosovës"

Misioni po ashtu ka punuar për ta mbështetur normalizimin e raporteve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, në pajtim me dialogun e udhëhequr nga Brukseli.

"Deri më tani Kosova ka arritur përparim të madh. Megjithatë, mbetet edhe shumë për t'u bërë për të mirën e qytetarëve të saj. Po shkojmë në atë drejtim. EULEX-i është i gatshëm të ndihmojë dhe e dimë që kohën e kemi të kufizuar. Është me rëndësi që t'ju ndihmojmë institucioneve vendase që të arrijnë sa më shumë që munden para se ne të shkojmë", përfundon Joelle.

Si grua që ka arritur në botën e mbizotëruar nga meshkujt, Joelle është e lumtur të shohë që shumë prej homologeve të saj të Kosovës po ashtu marrin rol aktiv në jetën publike. Ajo thotë që Franca është goxha tradicionale lidhur me rolin e grave, duke imponuar kuota për përfaqësimin e grave në funksionet zyrtare. Joelle mendon që vetë gratë duke pasur një qasje efektive mund të bëjnë ndryshimin.

"Është me rëndësi që grave t'ju jepen të drejtat e njëjta, por edhe ato duhet ta gjejnë rrugën e tyre, të jenë më të

pavarura dhe të kenë më shumë besim në vete. Nganjëherë kuotat më duken shumë poshtëruese për neve gratë", thotë Joelle.

Pasi që 14 vjetët e fundit të jetës së saj i ka kaluar duke ardhur e vajtur në dhe nga Kosova, Joelle e ndjen një lidhje dhe përkushtim me përparimin e saj në të gjitha fushat, por në veçanti në sundimin e ligjit.

"Kam përkushtim të vërtetë ndaj Kosovës. Qëndrimi im këtu është përkushtimi im më i gjatë ndaj një vendi të cilin e kam bërë gjatë tërë jetës sime. Jam e lumtur që kam pasur mundësi ta jap madje edhe një kontribut të vogël për ndërtimin e një Kosove të re", thekson ajo.

Ajo është e sigurt që EULEX-i ka ofruar mbështetje të vërtetë për këtë vend të ri. "Nganjëherë harrojmë që kjo Kosovë e re ka vetëm gjashtë vjet. Shumë gjëra janë bërë dhe shumë gjëra kanë mbetur të bëhen. Megjithatë, para se të shkoj, dua ta kem ndjenjën që ne si mision kemi bërë më të mirën", përfundon Joelle.



## Të drejtat e njeriut nuk janë diçka me të cilat duhet të jemi të kënaqur – Njihuni me Magda Mierzewska

Amendoni se jeni keqtrajtuar gjatë zbatimit të funksioneve ekzekutive të EULEX-it në Kosovë? Kujt do t'i drejtoheshit? A është dikush që do të ishte i përgatitur t'ju dëgjojë dhe vërtetë të bëjë diçka lidhur me ankesën tuaj?

Njihuni me Magda Mierzewska, Kryesuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, PSHDNJ, i cili gjendet në zemër të Prishtinës. Ajo mund të jetë në gjendje t'iu ndihmojë. Paneli të cilin e kryeson ajo është një organ i pavarur, një lloj mbikëqyrësi i jashtëm. Paneli u krijua më 2010 në mënyrë që ta vlerësojë respektimin e normave dhe të standardeve të të drejtave ndërkombëtare të njeriut nga EULEX-i, gjatë ushtrimit të funksioneve ekzekutive të tij. Është hera e parë, për shkak të mandatit të tij ekzekutiv, që një Mision i Bashkimit Evropian i nënshtrohet një mekanizmi të tillë mbikëqyrës.

“Çdo person, organizatë ose grup mund të ushtrojë ankesë tek ne nëse mendojnë se EULEX-i ua ka shkelur të drejtat e tyre”, thotë Magda.

“Nëse një qytetar mendon që policia, zyrtarët doganorë apo prokurorët e EULEX-it ua kanë rrezikuar të drejtat e tyre, ne intervenojmë. Detyrë e panelit është t'i vërtetojë faktet, ta përcaktojë ekzistimin

e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe pastaj t'i rekomandojë veprimet e duhura që mund të zbatohen për ta zgjidhur problemin”, vazhdon Magda.

Sapo PSHDNJ ta përcaktojë apo ta vërtetojë se vërtetë ka ndodhur një shkelje, konkluzionet i dërgohen Shefit të Misionit, ankuesit dhe pastaj ato do të publikohen në faqen e internetit të panelit. Përveç kësaj, ato konkluzione mund të përfshijnë rekomandime jo-obliguese për veprim nga ana e Shefit të EULEX-it që t'i adresojë dhe t'i rregullojë shkeljet e vërtetuara të drejtave të njeriut. Ky është një zhvillim revolucionar në të drejtën ndërkombëtare – që përveç shteteve edhe organizatat ndërkombëtare të cilat kryejnë funksione ekzekutive mbahen përgjegjëse për ndonjë shkelje të drejtave të njeriut. Në këtë aspekt, paneli jo vetëm që i rregullon shkeljet e mundshme të drejtave të njeriut të ankuesve, por po ashtu e avancojnë transparencën dhe besueshmërinë e EULEX-it si organizatë ndërkombëtare e cila krahasohet me standardet e njëjta të cilat i promovon.

Megjithatë, PSHDNJ nuk mund t'i zgjidhë të gjitha problemet tuaja.

“Ne marrim shumë ankesa lidhur me kohëzgjatjen e lëndëve të cilat janë të pazgjidhura në gjykatat e Kosovës.

Përkundër parimit ligjor të cituar shumë (i cili i atribuohet Kryeministrit Britanik të shekullit 19 William Gladstone) 'Drejtësia e Vonuar është Drejtësi e Mohuar', ne nuk jemi të autorizuar që t'ju ndihmojmë qytetarëve në këtë aspekt, meqë paneli ynë nuk mund të ndërhyjë në procedurat gjyqësore", sqaron Magda. Ajo vazhdon të sqarojë që PSHDNJ nuk ka kompetenca ta kontrollojë punën e gjykatave të Kosovës ose të veprojë si gjykatë e apelit për arsye se gjykatat janë të pavarura. Megjithatë, nëse qytetarët mendojnë që institucionet e Kosovës ua kanë shkelur të drejtat e tyre, ata kanë të drejtë që ankesat e tyre t'i drejtojnë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

"Gjykata Kushtetuese e Kosovës i pranon ankesat kushtetuese individuale. Kjo është e mundur sepse Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut mbrohet në Kushtetutën e Kosovës. Shumë vende të botës nuk e kanë këtë mundësi", thekson Magda, duke shtuar se Gjykata Kushtetuese ka përvojë të dëshmuar të zbatimit të standardeve të të drejtave të njeriut në Kosovë.

"Avokati i Popullit i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese janë institucionet që merren me ankesat e qytetarëve për shkeljen e të drejtave të njeriut në rastet kur përfshihen institucionet vendase", sqaron ajo. "Kjo është rëndësishme meqë Kosova nuk e ka fituar statusin e shtetit të njohur në mënyrë universale dhe nuk është anëtare e Këshillit të Evropës. Kjo do të thotë që qytetarët e Kosovës nuk mund të ankohen në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

Magda ka punuar për vite të tëra në Strasburg si juriste e zyrës së regjistrimit për Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Aty ka pasur për detyrë ta bëjë hartimin dhe përgatitjen e aktgjyqimeve

dhe të aktvendimeve që shërbejnë si bazë për shqyrtimet gjyqësore të Gjykatës. Magda është njëra prej tre ekspertëve ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut që janë pjesë e PSHDNJ. Ajo vjen në Kosovë për seancat e rregullta të panelit disa herë në vit. Dy ekspertët tjerë të panelit janë z. Guénaël Mettraux dhe znj. Katja Dominic. "Unë kam ardhur në Kosovë për herë të parë më 2005. Më pëlqente të isha në Prishtinë dhe më ka fascinuar historia e Ballkanit. Disa vite më vonë u ktheva të punoj për Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut," thotë Magda, duke shtuar që ishte e natyrshme që ajo të vazhdonte në një cilësi të njëjtë në PSHDNJ.

Si dikush që punon për Gjykatën e Strasburgut, Magda thotë se ajo është e interesuar ta dijë se si zbatohen të drejtat e njeriut në botën e vërtetë. "Është tjetër të punosh për gjykatën më të lartë për të drejtat e njeriut në Evropë; ndërsa është krejt tjetër të shohësh si mund të zbatohet në praktikë Konventa Evropiane në mënyrë që ta përmirësojë jetën e qytetarëve të zakonshëm edhe këtu në Kosovë", thotë Magda.

Ajo i inkurajon fuqishëm juristët që të mos harrojnë kurrë se aspektet ligjore dhe teknike të punës së tyre mund të kenë ndikim të madh në jetët e njerëzve. Polonia, vendi prej nga vjen Magda, është një vend post-komunist që është përballur me sfidat e veta gjyqësore. Pas dyzet vjetësh të formësimit të gjithë shoqërisë së Polonisë nga ana e partisë komuniste, vendi i saj u transformua në demokraci funksionale shumë partiake.

"Unë kam hyrë në provimet e mia të drejtësisë gjatë periudhës së ligjit ushtarak në Poloni në fillim të viteve të tetëdhjeta, por ndjeva që nuk doja të bëhesha gjyqtare

në një sistem një-partiak. Në vend të kësaj jepja mësim në universitet. Kur më në fund ndodhi ndryshimi në vendin tim më 1989, unë isha e entuziazmuar pasi që isha në gjendje ta përjetoja lirinë", thotë Magda.

Megjithatë, në krahasim me tranzicionin paqësor të Polonisë, rruga e Kosovës drejt lirisë ishte mjaft dramatike. "Ishte përvojë tronditëse për tërë shoqërinë", thekson Magda.

Sipas Magdas, njerëzit e rajonit janë të entuziazmuar nga ndjenja e lirisë së fituar rishtazi. Por liria, thekson Magda, duhet të shkojë paralelisht me kufij të caktuar. Vlera e sundimit të ligjit qëndron në rolin e tij si rregullatori kryesor i këtyre lirive të gjetura rishtazi për të mirën e përbashkët të shoqërisë.

"Njerëzit mendojnë se liria nënkupton që çdo gjë duhet të lejohet, që në fakt kjo absolutisht nuk është kështu në një shoqëri demokratike. Është ligji ai që imponon kufij për qytetarët si edhe për autoritetet publike", thotë ajo.

Pas edhe një dite tjetër të ngarkuar në PSHDNJ, Magda po kthehet në Strasburg. Ajo do të kthehet në Prishtinë në pranverë për ta kryesuar edhe një seancë tjetër të PSHDNJ.



## Biljana Rexhiq – garanton realizimin e drejtësisë!

Nëse keni ndonjë lëndë në Gjykatën Themelore dhe nuk ju pëlqen vendimi i nxjerrë nga gjykata në fund, gjithmonë mundeni të mos pajtoheni me atë vendim... Mospajtimi është e drejtë themelore e njeriut! Sidoqoftë, vetëm mospajtimi me vendimin e gjykatës ndoshta nuk do të jetë i mjaftueshëm që ta ktheni vendimin në favor tuajin, përveç nëse filloni procesin e zakonshëm të apelit për ta ndrequr padrejtësinë. Këtu vjen në shprehje puna e Biljana Rexhiq. Ajo u ndihmon atyre që mund të mendojnë se ju është bërë padrejtësi nga gjyqësori në ndonjë rast gjyqësor në të cilën janë të përfshirë, si dhe ajo ju ndihmon në përpjekjet e tyre që gjykatat t'i rivlerësojnë vendimet e tyre të mëparshme.

Biljana Rexhiq është Udhëheqëse e Sektorit për Kundërvajtje dhe pjesë e panelit gjyqësor në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ajo gjithashtu punon edhe në ekipe të përziera në lëndë penale. Gjatë tri dekadave të kaluara, një numër i madh i femrave janë bërë pjesë e profesionit të drejtësisë dhe Biljana Rexhiq pa dyshim është një shembull i mirë i femrave të suksesshme në gjyqësor.

Ajo punon si gjyqtare që nga vitit 1980. Edhe pse ka diplomuar edhe në gazetari, atë e tërhiqte më shumë vënia e drejtësisë në vend. "Ishte shumë e natyrshme për mua që t'i ndjekë hapat e babait dhe të gjyshit tim të cilët ishin gjyqtarë," thotë ajo.

Sistemi i drejtësisë në Kosovë është i organizuar në tri nivele: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Gjykata e Apelit funksionon si gjykatë e shkallës së dytë që nënkupton se ajo merret me lëndët të cilat i ka pranuar pas ankesave nga njëra prej gjykatave themelore.

Sipas Biljanës, një sfidë e posaçme është numri i madh i lëndëve. "Në këto rrethana duhet të jesh vetja, profesionale, e pavarur dhe e paanshme, të varesh vetëm nga ligjet dhe respektimi i të drejtave të njeriut," sqaron ajo.

Ajo që e motivon atë janë njerëzit dhe pritjet e tyre për drejtësi. "Vërtetë është keq kur njerëzit e humbin besimin në sistemin e drejtësisë", thotë Rexhiq. "Ndoshta pritjet janë më të mëdha se sa kapacitetet tona, por nuk mund ta lëmë këtë të na dekurajojë. Vendimet tona ndikojnë drejtpërdrejt tek njerëzit dhe përkrah zbatimit të ligjit ne duhet të jemi të kujdesshëm edhe me afatin kohor. Çdo minutë vonesë është padrejtësi për palët", shton ajo.

Sipas parimit, nuk pendohem për vendimet e mia, edhe pse kërcënimet janë pjesë e punës sonë të përditshme", thotë ajo duke buzëqeshur.

“Lufto para se të heqësh dorë”

Qëllimi parësor i gjyqtarit duhet të jetë zbatimi i ligjit. Qëllimi personal i Biljanës është t’i shërbejë sistemit të drejtësisë me përkushtim dhe aq sa ka njohuri. “Është obligim yni ligjor dhe moral që ta vëmë njohurinë, përvojën, energjinë dhe kreativitetin tonë në shërbim të drejtësisë. Në këtë aspekt, unë nuk kursehem aspak”, thotë ajo.

Sidoqoftë, gjyqësorit të Kosovës i nevojitet mbështetja dhe përvoja e gjyqtarëve dhe e prokurorëve ndërkombëtarë në mënyrë që t’i arrijë standardet evropiane. “Këmbimi i përvojave dhe i njohurive me kolegët është shumë i rëndësishëm. Ne kemi bashkëpunim shumë të mirë me gjyqtarët e EULEX-it. Vërtetë e çmoj mbështetjen e tyre,” thotë Biljana.

Porosia e Biljanës për gjeneratat e reja është që ata duhet të jenë të pavarur, të moralshëm dhe të paanshëm. Ata duhet vazhdimisht të mësojnë dhe të studiojnë. “Unë jam gjithmonë në trajnime dhe vetë jam trajnuese në Institutin Gjyqësor të Kosovës”, shton ajo.

“Po të mos isha gjyqtare, atëherë përfundimisht do të isha diku në kategorinë e sundimit të ligjit. Gjithmonë do t’i shërbejë drejtësisë,” thotë ajo.

Biljana Rexhiq është pishtarë e shpresës për të gjithë ata që dëshirojnë të “luftojnë për drejtësi”. Përmes përkushtimit, punës së saj të madhe dhe angazhimit ajo është në gjendje të ndihmojë në sigurimin e realizimit të drejtësisë.



## Marina Toivonen, police me mission

“Në vendin tim kisha njohuri për njerëzit nga Kosova të cilët ishin vendosur në qytetin tim pas konfliktit në vendin e tyre – por nuk më ka shkuar mendja që një ditë do të vija të punoja këtu”, fillon rrëfimin Marina Toivonen, hetuese e EULEX-it e cila është duke specializuar në krimin e organizuar. Marina është nga Turku, një qytet antik në jugperëndim të Finlandës, i cili shtrihet i qetë përgjatë brigjeve të mrekullueshme të lumit Aura. E pozicionuar tri vjet më parë në Kosovë, Marina i nxjerr në pah arsyet kryesore që e nxitën ardhjen e saj këtu.

“Aplikova për këtë vend pune sepse Kosova është pjesë e Evropës sikurse Finlanda. Mandati i EULEX-it dukej shumë interesant dhe unë u preka nga njerëzit që kishin kërkuar strehim në vendin tim”, thotë Marina.

Marina punon në Njësinë e EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Organizuar, e cila përbëhet nga një ekip i detektivëve të cilët vijnë nga 20 shtete. Këta detektivë (hetues) janë dërguar në Kosovë për shkak të ekspertizës së tyre për hetimin e krimit të organizuar, të korrupsionit të nivelit të lartë dhe të terrorizmit. Si pjesë e këtij ekipi, Marina i heton të gjitha aspektet e krimit të organizuar duke u nisur nga korrupsioni, keqpërdorimi i pozitës zyrtare, zhvatja financiare deri te trafikimi i qenieve njerëzore. Aktualisht ekipi është duke i zhvilluar përafërsisht 27 hetime, duke i

përgjatur hetimet prokuroriale.

Marina bashkëpunon ngushtë me prokurorët e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK). Për dallim nga praktika e vendit të saj ku policia ka kompetenca të mëdha, për të punuar në Kosovë, Marinës i nevojitet të bëjë disa përshtatje. Derisa Policia e Kosovës mund t'i fillojë hetimet, kur është fjala për fillimin e procedurave penale është prokuroria ajo që udhëheq dhe ata i drejtojnë hetimet e policisë. Procedurat fillojnë, në pajtim me ligjin e Kosovës, pas ngritjes së dyshimit të bazuar që është kryer një krim.

Krimi i organizuar është kërcënim për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe kompleksiteti i tij në rritje nënkupton që ekzistojnë mënyra të panumërta për ta përshkruar atë. Sipas Marinës, në krim të organizuar në përgjithësi përfshihet një rrjet i njerëzve të cilët kryejnë aktivitete të fshehta kriminale për përfitim të rëndësishëm. Këto krime kanë pasoja të rënda për ekonominë dhe shoqërinë e një vendi.

“Bandat e krimit të organizuar punojnë larg syrit të publikut dhe veprojnë përtej kufijve. Kjo do të thotë që hetimet mund të jenë shumë të komplikuara. Sa herë që e mbushni makinën tuaj me karburant të futur me kontrabandë, sa herë që blini mallra të falsifikuara ose përpiqeni ta korruptoni një zyrtar, ju i mbushni xhepat

e kriminelëve dhe e dëmtoni komunitetin tuaj. Krimi i organizuar dhe korrupsioni i dëmtojnë qytetarët, bizneset dhe institucionet shtetërore”, thotë Marina.

Përkundër faktit që Finlanda mban vendin e tretë të respektuar në listën e perceptimit të korrupsionit nga 177 vende anembanë botës, realiteti është që edhe në vendin e Marinës policia po ashtu merret me raste të krimit të organizuar.

“Është me rëndësi të kuptohet që edhe në vendin tim ka krim të organizuar. Edhe ne i kemi problemet tona, siç është droga, mashtrimi financiar, evazioni fiskal dhe bandat e rrugës”, thotë Marina.

Në Njësinë për Hetimin e Krimit të Organizuar aktualisht janë 40 detektivë të cilët punojnë ngushtë me kolegët e Policisë së Kosovës për ndaljen e krimeve të rënda. Shumica e këtyre rasteve po drejtohen si hetime të përbashkëta. Këto hetime përbëhen nga një ekip i detektivëve të PK-së dhe të EULEX-it të cilët i ndajnë informatat dhe punojnë bashkë në partneritet nën drejtimin e një prokurori të PSRK-së. Ekipet e EULEX-it dhe të Policisë së Kosovë kanë punuar së bashku në disa arrestime të profilin të lartë të të dyshuarve për krim të organizuar, për vrasje, trafikim të drogës dhe trafikim të qenieve njerëzore. Disa prej këtyre rasteve kanë përmasa ndërkombëtare duke i përfshirë disa arrestime të njëkohshme anembanë Evropës.

“Jam e gëzuar që përfshirja jonë me policinë vendase në hetimet e përbashkëta po rritet nga dita në ditë. Ne nuk jemi këtu për vete, institucionet e Kosovës do ta marrin këtë përsipër një ditë. Mua posaçërisht më pëlqen bashkëpunimi ynë”, thotë Marina, duke shtuar që një aspekt i rëndësishëm i trashëgimisë së EULEX-it është t’ua ofrojë

autoriteteve të Kosovës mjetet të cilat mund të shfrytëzohen në përpjekjet e tyre të ardhshme për ndaljen e krimit të organizuar.

Marina do të shkojë së shpejti për t’i rifilluar detyrat e saj policore në vendlindjen e saj, duke e marrë një pjesë të Kosovës me vete. “Kosova është duke u përballur me sfida, por në përgjithësi mbizotëron një atmosferë optimiste! Njerëzit e bëjnë këtë vend shumë të posaçëm dhe unë po lë pas shumë miq të mirë. Në veçanti më bëjnë përshtypje kosovarët e rinj, të cilët sillen më mirë se gjetkë në Evropë. Vendet nordike kanë probleme me të rinjtë e tyre të cilët janë të prirë për të pirë dhe për vandalizëm. Këtu nuk ndodhin gjëra të tilla”.

Marina është e vetëdijshme që puna të cilën janë duke e kryer tani EULEX-i dhe Policia e Kosovës do të ndikojë tek gjeneratat e ardhshme.

“Kjo është arsyeja përse duhet t’i shtojmë përpjekjet tona si në Finlandë ashtu edhe në Kosovë në mënyrë që ta ndalim krimin e organizuar dhe korrupsionin. Dua që gjeneratat e reja të Kosovës dhe të Finlandës të kenë aspirata më të mëdha ndaj të ardhmes së tyre. Ne jemi këtu për t’iu ndihmuar atyre t’i realizojnë ëndrrat e tyre”, përfundon Marina.



## Jaroslava Novotna – Zonja Prokurore

Ishte dëshira për të ndihmuar në zhvillimin dhe implementimin e sundimit të ligjit që e solli Jaroslava Novotnën, zonjën e parë në mesin e gjithë prokurorëve, në Kosovë. Entuziazmi i saj që ndërtuar fuqimisht nga përpjekjet e Kosovës për krijimin e sistemit të prokurorisë sipas praktikave më të mira evropiane. Misioni saj i brendshëm ishte të ndihmojë në rritjen e kapaciteteve të prokurorisë vendëse.

Si Kryeprokurore e EULEX-it, Novotna është përgjegjëse për efektshmërinë dhe efikasitetin e prokurorëve ndërkombëtarë. Në rolin e saj, ajo po ashtu vepron edhe si homologe e drejtpërdrejtë me Kryeprokurorin e Shtetit, Ismet Kabashi. Së bashku me Asamblenë e Prokurorëve të EULEX-it, Novotna lehtëson përpjekjet për adresimin e mangësive institucionale dhe strukturore të sistemit gjyqësor të Kosovës.

Ajo ka menduar se përvoja e saj e punës në Kryeprokurorinë e Republikës Çeke për çështjet që kishin të bënin me krimin e organizuar, si dhe përfaqësimi i vendit prej saj në EUROJUST, një trup i themeluar nga shtetet anëtare të BE-së për bashkërendimin e hetimeve dhe ndjekjeve penale në mes tyre, do t'i ndihmonte shumë në rolin e saj të ri.

Në Pragë, ajo e filloi karrierën e saj në vitin 1978 në Çekosllovakia, duke qenë në radhë të parë dëshmitare e ndryshimeve ligjore substanciale në vend dhe duke

u ballafaquar me sfidën e kalimit prej sistemit një partiak në një demokraci dhe një treg të lirë plotësisht funksional, të etur për t'iu bashkuar Bashkimit Evropian. Për t'i komplikuar gjërat edhe më shumë, ky tranzicion ndodhi krahas me ndarjen paqësore me Sllovakinë në vitin 1993.

Si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve të thella, ligjvënësit çek ishin ngarkuar jo vetëm me detyrën kryesore të ndryshimit të kodit penal ekzistues, por edhe me rikodifikimin e ligjeve të reja dhe ligjeve të procedurës penale, ndërsa pothuajse krahas kësaj prej tyre kërkohet që të zbatonin procedurat e reja.

“Vendi im donte të bëhej pjesë e Evropës. Asokohe, ne duhej të merreshim jo vetëm me ndryshime rrënjësore të ligjeve të vendit tim – por edhe me zbatimin e tyre në mënyrë të shpejtë”, thotë Novotna, duke shtuar se “të implementosh këto ndryshime ishte shumë e vështirë”.

Sipas zj. Novotna, prokuroria paraqet boshtin kryesor të gjithë sistemit të drejtësisë së një vendi.

“Pa funksionimin efektiv të një prokurorie funksionale, e të aftë që të udhëheq me hetimet policore, nuk mund të ketë gjykim. Ndërsa pa gjykim, gjyqtarët nuk do të jenë në gjendje të kryejnë detyrën e tyre. E pa të gjitha këto – nuk mund të ketë drejtësi në një shoqëri”, konkludon zj. Novotna.



Këshilla e saj për prokurorët e Kosovës është që të jenë sa më profesionistë; ta njohin ligjin dhe të përdorin çdo rast për t'u arsimuar dhe avancuar. "Ju duhet të shfrytëzoni çdo mundësi për të mësuar për gjithë botën, dhe jo vetëm për profesionin tuaj. Ju duhet të jeni të hapur për interaksion me kolegët tuaj dhe të diskutoni për vështirësitë. Ju duhet të jeni të guximshëm në përpjekjet tuaja për ndryshimin e mjedisit, e jo të bini nën ndikimet negative", thekson ajo.

Sipas Novotnës, ajo është njohur me disa prokurorë të shkëlqyer në Kosovë. Ajo veçanërisht çmon kolegët e saj të rinj, të cilët angazhohen për një sistem gjyqësor efektiv, në të cilin asnjë krim nuk do të mbetet pa u ndëshkuar.

"Krimi në cilëndo shoqëri paraqet pengesë për zhvillimin e saj, një dukuri e cila e parandalon përparimin e demokracisë", thotë Novotna.

Gjatë hetimit, duhet të ketë një balancë në mes të drejtës së publikut për t'u informuar dhe për nevojën e mbrojtjes së të drejtave të personave të dyshuar.

"Duhet të kesh një arsye të mirë për të filluar hetimin, por kjo nuk duhet të jetë arsye që pastaj të zbulosh identitetin në publik të personave të përfshirë në hetim – përkundër vëmendjes së mediave. Gjithmonë ekziston rreziku i dëmtimit të reputacionit të një personi. Rregulla themelore e çdo kodi penal është se çdokush konsiderohet i pafajshëm derisa të dëshmohet fajësia e personit në një gjykatë të pavarur. Publiku dhe mediat duhet ta respektojnë këtë", këshillon Novotna.

Dëshirat dhe ëndrrat e saj për Kosovën, janë që Këshilli Prokurorial i Kosovës, KPC, të zhvillohet tutje dhe të kontribuojë për një prokurori më të fortë dhe më të dukshme, e

të lirë nga ndikimet negative duke formuar kështu një themel të fortë për gjeneratat e ardhshme.

EULEX-i e ka ndihmuar Kosovën me raste më komplekse, të cilat nuk kanë mundur të trajtohen nga gjyqësori i vendit, por njëkohësisht përmes bashkëpunimit me gjyqësorin e Kosovës, misioni ndihmoi në pasurimin e njohurive dhe shkathtësive të tyre. Mirëpo, procesi i të mësuarit nuk ishte i njëanshëm.

"Ne po ashtu kemi mësuar shumë nga kolegët tanë nga Kosova. Ju mendoni se drejtësia mund të arrihet vetëm përmes mjeteve tuaja dhe brenda ligjit të cilin jeni mësuar ta zbatoni. Interaksioni me kolegët tanë këtu nënkupton se ne e kemi mësuar një mënyrë të re të të menduarit. Njeriu fillon t'i sheh gjërat në një mënyrë tjetër – sipas mënyrës së Kosovës".



## Drejtësia përmes Ilupës!

Siç ka thënë dikur Theodore Roosevelt, çdo gjë që ia vlen të bëhet nuk do të mund të behet lehtë, dhe kjo është pikërisht mënyra se si jeton Sevdija. Ajo merr përsipër punë që do ta bënin çdokënd të ndihej jo rehat edhe në rastin më të mirë; ajo e investon energjinë e saj të pakufishme në zgjidhjen e rasteve penale të rënda, dhe sigurohet që t'i zë dora e ligjit gjegjësisht Sevdije Morina ata të cilët nuk i binden atij.

Morina është zëvendës Kryeprokurore e Prokurorisë Speciale të Kosovë (PSRK). Ajo e bashkërendon punën e kolegëve vendas në PSRK, u jep udhëzime prokurorëve vendas, si dhe punon në raste të ndryshme penale.

Që kur ishte studente, rastet penale e tërhiqnin më shumë. 'Pasi fillova të punoj në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, para tridhjetë vitesh, vetëm sa e vërtetova dëshirën time për të punuar më çështje penale. Aty vendosa t'i bashkëngjitem radhëve të prokurorëve,' thotë Sevdija. Dëshira për të krijuar një ambient më të sigurt për qytetarët e Kosovës dhe për t'ua bërë me dije kriminelëve se nuk do të mund të krijojnë përfitime të paligjshme është motivi kryesor që e bën Sevdijen të mos ndalet. Përderisa, sfidat më të mëdha gjatë punës së saj janë rastet ku vështirësitë burojnë nga procesi i shqyrtimit të tyre.

Sipas Sevdijes, sistem i drejtësisë në Kosovë, përkundër sfidave të shumta, faktikisht qëndron shumë më mirë se që ishte më parë. "Reformat strukturore dhe ndryshimet në ligjet themelore përkundër asaj që në fillim krijuan vështirësi, dolën të jenë të drejta dhe tani ne të gjithë i kemi kaluar vështirësitë e fillimit," thotë Sevdija. Megjithatë, çështje problematike mbetet mungesa e burimeve njerëzore. "Duhet ngritur numrin e pozitave në proporcion me numrin e popullatës, duke krijuar një numër më të madh të stafit të cilët do të bëheshin pjesë e sistemit dhe do të punonin së bashku me gjyqtarët dhe prokurorët më përvojë," shton ajo.

Gjëja me rëndësishme në drejtësi është që ju të jeni profesional, të drejtë dhe të paanshëm në punën që e bëni. "Puna ime si prokurore është që të ketë drejtësi. Ndërsa drejtësia ndodh atëherë kur dënohet fajtori dhe jo i pafajshmi."

Sevdija e çmon shumë bashkëpunimin me prokurorët ndërkombëtar. "Ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë, diskutojmë për çështje dhe raste të ndryshme dhe shkëmbejmë përvojat tona. Ne mund të mësojmë shumë nga njëri tjetri," thotë ajo. Porosia e Morinës për prokurorët e ardhshëm është që të punojnë shumë në ngritjen e tyre profesionale, ngase vetëm në këtë mënyrë do të jenë të suksesshëm në ndjekjen e krimineleve.

“Është e rëndësishme ta duash punën tënde, të marrësh parasysh të drejtat dhe liritë e njeriut gjatë kryerjes së hetimeve,” deklaroi Sevdija. “Prokurori duhet ta ketë për qëllim nxjerrjen e së vërtetës e jo që domosdoshmërisht ta fitojë rastin”.

Planeti e Sevdijes për të ardhmen janë që ta vazhdojë punën në sistemin prokurorial të Kosovës për të mirën e qytetarëve të Kosovës.

Ajo thotë se, po ta niste karrierën e saj nga fillimi, prap do ta zgjidhte fushën e drejtësisë.

Sevdija e sheh punën e prokurorit si një nga profesionet më të vështira, por kur e njëjta kryhet me përkushtim, ajo të ofron shumë kënaqësi. Qëllimi i saj kryesor mbetet sjellja e kryerësve të krimeve para drejtësisë. “Gjithashtu, është me rëndësi që porosia të dërgohet tek të gjithë të tjerët, se veprimet joligjore nuk do të tolerohen dhe se ekziston ligji dhe institucionet që do t’i ndalojnë ato veprime,” përfundoi Morina.



## Kada Bunjaku: Përhapja e drejtësisë pafund

Është e premtë pasdite vonë dhe zyra e Kryetares së Gjykatës Themelore të Mitrovicës gumëzhinë nga aktiviteti. Telefonat mbi tavolinë janë duke cingëruar vazhdimisht, gjyqtarët penalë janë duke i lëvizur sa andej këndeje grumbujt e letrave dhe palët kureshtarë janë duke i pritur me padurim lajmet për rastet e tyre. Sipas rregullave administrative, vetëm një ditë në javë kjo zyrë është e hapur për pyetjet e tilla, por sot nuk është ajo ditë. Sidoqoftë, për shkak të kërkesës së madhe për shërbime ligjore, gjyqtarët proaktivë ja dalin të gjejnë kohë dhe t’iu ndihmojnë palëve të interesuara.

Njoftohuni me Kada Bunjakun, Kryetare e Gjykatës Themelore të Mitrovicës [që tani ndodhet në Vushtrri] dhe gjyqtare e krimeve të rënda. Qëllimi i saj është të ndajë drejtësi në Kosovë dhe ajo punon shumë për ta arritur këtë qëllim. Kada punon ngushtë me ekipet vendore dhe ndërkombëtare të ekspertëve ligjorë për t’i tejkaluar vështirësitë e sistemit aktual të drejtësisë në Kosovë.

Megjithatë, përkundër vullnetit të mirë, punës së palodhshme dhe përkushtimit të gjyqtarëve, sistemi i drejtësisë i Kosovës prapë se prapë përballet me sfida të mëdha për çdo ditë. Kjo është arsyeja përse sistemi i drejtësisë po përipiqet të jetë më përgjegjës ndaj njerëzve; t’i trajtojë nevojat e viktimave në mënyrë më të përshtatshme;

t’i përmirësojë dënimet e mëparshme të gabueshme; të merret me krimin e organizuar dhe të sigurojë që institucionet për sundimin e ligjit i ndajnë informatat në mënyrë më efektive.

“Unë kam besim të plotë në sistemin e drejtësisë në Kosovë, por na duhen kushte të përmirësuara që na mundësojnë të kryejmë punët tona më mirë,” thotë Kada. Sipas saj, nevojiten më shumë resurse për t’i plotësuar nevojat e njerëzve që jetojnë veçanërisht në regjionin e Mitrovicës. “Një numër gjykimesh në këtë regjion janë vonuar thjeshtë për shkak të mungesës së gjyqtarëve” shtoi ajo. Shpesh rastet janë shtyrë edhe për shkak të mungesës së kushteve të duhura: “tani gjykimet po i mbajmë në kontejnerë pa pasur madje as kushte themelore të punës!”

Deri tani, përkundër të gjitha telasheve, Kada me sukses ka zgjidhur rreth një mijë raste në vit: “çdo rast ka vështirësitë e veta, po kur ato zgjidhen me sukses atëherë kjo gjë sjellë çlodhje për të gjithë!” pohoi Bunjaku.

Sipas Kadës, gjyqësori i ri i Kosovës ka nevojë për gjithë ndihmën e mundshme në mënyrë që të qëndrojë në këmbët e veta. “Ne vërtet kemi bashkëpunim të mirë me gjyqtarët e EULEX-it. Ne shkëmbejmë përvoja dhe e përshtojmë procesin që gjyqësori komunal të bëhet i vetë qëndrueshëm.”

Kada kujton një fjalë të urtë, që thotë, 'puna e gjyqtarit është si puna e minatorëve' sepse shumica e njerëzve i nënshtrohen punëve dhe kushteve të rënda të punës për të arritur sukses. Opinioni publik nuk i di vështirësitë nëpër të cilat kalon gjyqtari për të kompletuar punën e tij. Opinioni i përgjithshëm publik kryesisht për shkak vëmendjes së mediave në të metat e sistemit të drejtësisë, kanë një pasqyrë të shtrembëruar për sistemin e drejtësisë në Kosovë.

"Mediat zakonisht zgjedhin ndonjë rast që ka dështuar dhe fatkeqësisht nuk i përmendin mijëra raste të suksesshme në të cilat është arritur drejtësia," thotë Kada. Kur analizohen rezultatet e arritura si këto të gjyqtarës Kada, atëherë bëhet e qartë që zgjidhja e suksesshme e rasteve është një normë dhe jo një përjashtim në gjyqësorin e Kosovës – krejt ndryshe nga besimi i përhapur.

Ne do të punojmë shumë për të ngritur besimin e qytetarëve në punën tonë, thotë Kada "Unë vërtetë besoj që puna e gjyqtarëve është e drejtë, e paanshme dhe neutrale dhe se ata po zbatojnë ligjin."

Bunjaku është personalitet kyç në sistemin e drejtësisë në Mitrovicë. Njohuritë, përvoja dhe pasioni i saj shtyjnë përpara sistemin e drejtësisë në këtë regjion dhe ndihmojnë komunitetin juridik që të tejkalojë sfidat ekzistuese. Por, njëkohësisht edhe në regjionet tjera të Kosovës, qindra gjyqtarë të tjerë punojnë siç punon edhe ajo me zell për çdo ditë për të zgjidhur rastet penale të zonës së tyre. Por fare pak nga këto ndodhi i komunikohen popullatës përmes mediave.

Fatkeqësisht vetëm një në një mijë raste që nuk shkon për së mbari arrin të bëhet lajm, ndërsa për mijëra rastet e tjera që zgjidhen dinë vetëm ata në të cilët këto raste ndikojnë drejtpërdrejt.



## Nga Dyseldorfi në Mitrovicë: Katja Dominik – gjyqtare e EULEX-it

Ajo erdhi nga Dyseldorfi në Mitrovicë e vendosur “për ta bërë më të mirën që mundet” në mënyrë që t’i ndihmojë Kosovës ta ndërtojë një gjyqësor të pavarur dhe efikas. Meqë kishte investuar më parë në Ballkan, si studente, hulumtuese dhe vëzhguese e zgjedhjeve në Kroaci dhe në Bosnjë/Hercegovinë, znj. Katja Dominik ishte e bindur që kthimi në rajon për të punuar si gjyqtare e EULEX-it ishte “gjëja e duhur për të”.

Dominik, gjyqtare nga Gjykata e Qarkut e Dyseldorfit, ka ushtruar profesionin në kuadër të një kornize të së drejtës procedurale 130 vjeçare, që ofroi afat historik të mjaftueshëm kohor për t’i shlyer gabimet në kuadër të legjislacionit. Por kjo nuk nënkupton që gjërat ishin gjithmonë ideale për Gjermaninë. Erozioni ligjor gjatë Luftës së Dytë Botërore, dy sisteme të ndryshme ligjore brenda Gjermanisë pas vitit 1945 dhe sfidat e ribashkimit me Gjermaninë Lindore kërkonin vëmendjen dhe përshtatjen e ligjbërësve gjermanë në historinë e re.

“Këto ndryshime në vendin tim më kanë mundësuar të fitojë një ndjeshmëri të caktuar ndaj problemeve të vazhdueshme të gjyqësorit të Kosovës”, thotë gjyqtarja Dominik.

Në rolin e saj si gjyqtare ndërkombëtare në Gjykatën Themelore të Mitrovicës,

ajo ishte në gjendje të marrë pjesë dhe t’iu përgjigjej sfidave të kodit të ri të procedurës të aprovuar në Kosovë në janar të vitit 2013. Ajo punon në ekip me kolegët e saj vendas, ndihmën e të cilëve ajo e konsideron si jetike. Ajo shtoi që roli kryesor i gjyqtarit është të sigurojë gjykim të drejtë dhe neutral.

